

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
“Ditët e Naimit”

Biblioteka
MERIDIANE POETIKE

Përgatiti
Shaip EMËRLLAHU

Këshilli botues
Agron TUFA
Drazhen KATUNARIQ
Remzi SALIHU
Eduardo ESPINA
Niels HAV
Rami SAARI
Triin SOMETS
Biba ISMAIL
Artan ARSLANI

Përktheu
Silke Liria BLUMBACH

Ballina dhe pikturat
Shazim Mehmeti

www.ditetenaimit.org

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
“DITËT E NAIMIT”

Edicioni XII

SIMFONIA E QËNDRESËS



Ditët e Naimit
Tetovë, 2008

Fituesi i çmimit letrar "Naim Frashëri"
Abdellatif LAÂBI (Maroko)

DYMBËDHJETË HERË – MALL PËR KULTURËN BOTËRORE

*(Mbi Edicionin e XII të Festivalit
Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit")*

Një nga formulimet më interesante mbi rolin e traditave dhe shkollave poetike në shkëmbimin e përvojave dhe njohjen e ndërsjellë të tyre, e ka dhënë, sipas meje, poeti rus Osip Mandelshtam, i cili së bashku me Anna Ahmatovën përbëjnë emblemën e asaj shkolle poetike që njihet me emrin "Akmeizmi". Kur e pyetën Mandelshtamin se, çfarë është për ju "akmeizmi"?, ai u përgjigj: "mall për kulturën botërore".

Si shprehja më e lartë e shkallës së vetëdijes estetike e ontologjike të gjuhës, poezia është lloji që ka mbijetuar ndër kulturat e lashta të njerëzimit, duke shtegëtuar nga mijëvjeçari në mijëvjeçar, nga shekulli në shekull e nga epoka në epokë, dhe me një fshikje ringjallëse ka zgjuar ndër shpirtrat njerëzor frymën shtegëtuese të njeriut në të gjitha gjendjet e larmisë së tij përballë misterit, mahnisë, vdekjes, dashurisë e të gjitha problemeve të përjetshme metafizike.

Poezia, megjithë zhvillimet e arteve konkurruese, me gjithë shpikjet e realiteteve virtuale, megjithë përsosjen e teknologjive vizuale dhe auditive, mbetet siç ka qenë: nevojë e pashmangshme e një shpirti të uritur, e vetmja forcë që shquan "tej

nëntë perdesh", që krijon apologjinë e ngushëllimit, shpresës apo ngazëllimit individual mbi format e tjera të ekzistencës. Sepse, poezia ka një sekret gjenetik të jetëgjatësisë, në ndryshim nga recepti pasiv e audiovizual: poezia ka një origjinë që hapet pandërprerë në historinë e species tonë dhe rrënjët burimore të saj të çojnë pashmangshëm në Zanafillë, atëherë, kur kryesëpari poezia, në të gjitha versionet dhe popujt ka qenë Lutje. Këtë strukturë të lutjes, për veten, të afërmin, këtë lutje adresuar Zotave, Fatit, Fuqive përtej tij, poezia e ka trashëguar, qoftë në format e saj të drejtimit kah adresati konjret, qoftë drejtuar në vetvete, si rrëfim, si predikim, si shkarkim autorrrëfimor drejtuar alter egos së tij.

Bota e lashtë dhe e re, trazuar nga pasionet, zbulimet, shpikjet dhe utopitë, nuk ka mundur të sajojë një armë më rezistente e më të efektshme se sa poezia, këngëzimi në vetvete; janë shembur pa nishan mbretër e perandoria të tëra janë bërë pluhur e hi, por ka mundur të shpetojnë "bllaqe" shumë më të pavdekshme se muret ciklike të Mikenës, shumë më të pavdekshme se piramidat: ato janë bllaqet strofike apo strukturat e pashkatërrueshme nga koha e poetëve me poezitë e tyre. Kësisoj, njeriu i të gjitha kulturave ka jetuar, është ngjizur dhe formësuar nga alkimia e formulave kombëtare të vargjeve të veta, siç janë paraskicuar dhe profilet e veçanta kombëtare nën plazmën supersticioze të eposeve nacionale, në pajtim me embrionin utopike që kanë ato.

Komunikimi me poezinë mbetet sfida më e vështirë e njerëzimit të sotëm. Jo për shkak të vështirësisë. Përkundrazi. Lehtësia e sotme e komunikimit me poezinë është më e mundshme e më banale se kurrë. Por mbijetesa e një ndërtimi të qëndrueshëm komunikativ duhet kërkuar në situatën e krijuar që rëndohet gjithnjë e më fort në civilizimin e sotëm, me shock-un e llojeve të komunikimit, me llavën përmblytëse virtuale, me përtacinë dhe pasivitetin e ripërtypjes së informacionit. Ka ndodhur ajo që, Lyotard-i e ka konstatuar në "Gjendjen e Postmodernit: raport mbi dijen": "revolucioni teknologjiko-informativ e rrit së tepërmi vëllimin e kujtesës sociale, por e bjerr cilësinë e saj".

Por, nuk duhet të harrojmë se cilësia e njerëzimit varet nga cilësia thelbësore e dialogut që ndërton, nga cilësia e kuvendimit shpirtëror dhe frymor. Kur filozofi i lashtë grek Parmenidi thoshte se "Përlasja është babai i të gjitha sendeve (ideve)", ai me siguri, me këtë shprehje nuk ka patur parasysh përplasjen e

“kungujve”. Dialogu shpirtëror e frymor i përvojave poetike të popujve, nuk është rutina burokratike e një konference a simpoziumi të financuar nga interesa po aq komerciale anëkënd botës. Përkundrazi, ky lloj kuvendimi thelbësor është një nevojë e domosdoshme dhe risjell edhe njëherë në trajtë baladeske rinjohjen me ëndrrat, frikërat, dëshpërimin dhe shpresat e njeriut. Ky kuvendim është përcaktues për profilin e njeriut të epokës sonë, pasi aty pikëtakohet njësia individuale me aspiratat dhe ëndrrat e vetrealizimit në histori me shprehjen alegorike e të pavetëdijshme përmes imazheve dhe figurave të ëndrrave dhe aspiratave kolektive.

Poetët janë skicues të kontureve futurologjike, ata projektojnë dimensionin shpirtëror që na paraprin dhe ne, ashtu si në një shërbim sinoptik, mund të gjykojmë mbi simptomat (apo sindromat) e asaj se çfarë ardhmërie i hapet kulturës dhe vetëdijes njerëzore në shekullin tonë.

Një ndër misionet që e bën të mundshme realizimin e një interkomunikimi të tillë, janë padyshim, Festalet e ndryshme Ndërkombëtare, si mundësitë më ideale për të realizuar njohjet e ndërsjellta dhe për të shquar se çfarë na lëviz përpara, cilat vlera, cilat frikëra, cilat bukuri ndjellëse e fisnikëruese. Ndonëse, jashtë vëmendjes së merituar nga instancat shtetërore e polike, takimet e tilla, përveçse të dobishme e të domosdoshme, janë para së gjithash prekëse me ndjenjën e vetëdijshme të sakrificës.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit” që zhvillohet për të 12-ën herë në Tetovë, në këtë “Cep të lirisë Verilindore”, siç shprehej Mitrush Kuteli, është një prej këtyre sakrificave, të cilat vlejnë shumë e më shumë se sa të gjitha “lloqet” që tjerin tutorët shtetërorë me propagandat e tyre. Ky Festival i dymbëdhjetë, na flet me një gjuhë të njëkuptimtë, se Sakrificat kulturore bëhen pa bujë, me përunjësi, brishtësi dhe dashuri. Se, siç thotë në një poezi poetja Olga Sjedakova – “Vetëm dashuria është e brishtë, dhe vetëm brishtësia është e thellë”.

Prandaj, jo vetëm si poet shqiptar (si një ndër të shumtët) jam veçanërisht i gëzuar e krenar që për kulturën time kombëtare gjenden aty ku nuk priteshin “dalëzotës” dhe “dashnorë adhurues” të saj, që i mbajnë në këmbë shtyllat e Tempullit. Në një aspekt tjetër “gjeopoetik”, puna e palodhur dhe këmbëngulëse e këtij grupimi fisnik poetësh me emra konkretë – siç është veçanërisht puna qendrore e poetëve dhe artistëve të Drejtorisë së Festivalit, - është

një mësim dhe shembull praktik, është një model se si duhet të dalim nga rrethi vicioz i provincializmit dhe izolimit kulturor kombëtar. Mësim ky, që vjen jo nga qendra, por nga skajet e gjeokulturës sonë kombëtare – pikërisht aty ku Atdheu ynë gjuhësor e kulturor dhemb më shumë!

Me qëndrueshmërinë dhe me koherencën e dymbëdhjetë edicioneve, me shumën e performancave leximore në ditët e Festivalit, me antologjitë poetike përkatëse të pjesëmarrësve për çdo Festival apo me promovimet e një rradhe të pafundme librash poetikë – kolana të këtij Festivali, - unë mendoj se janë shfaqur përmasat e një misioni kulturor që e tejkalon Tetovën dhe çdo metropol tjetër të kulturës shqiptare. Gjykuar nga thellësia, përkushtimi, talenti dhe inteligjencia e krijuesve të Tetovës dhe gjithë arealit kulturor shqiptar në Maqedoni, gjykuar nga njohja ime e krijimtarisë dhe veprimtarisë së tyre kulturore, botuese, me revista e projekte ambicioze artistike, - kjo pjesë e gjeokulturës sonë, me një bashkëpunim edhe më të ngushtë e miqësor, mund të shndërrohet lehtë në një pol të kulturës sonë kombëtare që dikton dhe ndikon duke sjellë kontribute e vlera të paharrueshme në trashëgiminë letrare mbarëshqiptare, duke e pasuruar atë edhe me përvojat e kulturave të huaja poetike, por edhe me idolet e vetë poezisë shqipe: një Naim Frashër në tre metra bronz në mes të Tetovës, çka nuk gjendet në asnjë metropol shqiptar, as në Tiranë, as në Prishtinë. A nuk kanë qenë në fillim arbëreshët e Italisë që kanë ushtruar një ndikim të tillë në formësimin e kulturës kombëtare në kohën e De Radës?

Dr. Agron TUFA




Foto: L. Monier

Abdellatif LAÂBI (MAROKO)

Abdellatif Laâbi u lind më 1942 në Fes (Marok). Në vitin 1966 themelon revistën *Souffles*, që luan një rol të konsiderueshëm në ringjalljen e kulturës në Magreb. Lufta e tij si intelektual dhe opozitar çon deri te burgosja e tij nga viti 1972 deri 1980. Jeton në Francë prej vitit 1985.

Redaktor i revistës *Souffles*, politikisht aktiv, u arrestua, u torturua dhe u burgos më 1972 për "delikte opinioni". I adoptuar si i burgosur i ndërgjegjes nga Amnesty International, u shpërblye me Çmimin e Lirisë, PEN Club-i francez, dhe me Çmimin Ndërkombëtar të Poezisë nga Fondacioni i Arteve, Rotterdam, kur ishte ende në burg. U lirua më 1980 dhe tani jeton në Francë.

Abdellatif Laabi është shkrimtar i madh maroken frankofon i periudhës pas pavarësisë dhe njëri nga figurat më të mëdha letrare të shekullit XX të Magrebit. Përdorimi i frëngjishtes në vend të arabishtes nga ai është një vendim i qëllimshëm në përpjekjen e tij për të gjetur një gjuhë që mund të ç'tradicionalizojë, si dhe të shkolonizojë ndërgjegjen marokene. Shkrimi i Laâbit i referohet vazhdimisht traditës gojore të vendit të tij. Ai lëviz midis zhanreve në një stil të cilin e quan "itinerar", sepse vazhdimisht mundohet t'u shmangë mënyrave dhe përgjigjeve konvencionale. Ankthi i tij i përhershëm është të përmbytet nga afazia, që është trashëgimia e qëndrueshme e kolonializmit, të cilën e ka përjetësuar tirania në Marok. Arritja e tij është krijimi i një gjuhe të re letrare, që preokupohet papushim me natyrën e shkrimit; dështimi i tij është i pashmangshëm, duke pasur parasysh paradoksin e një shkrimtari të angazhuar revolucionar në një shoqëri analfabetësh.

Gjatë burgosjes së tij, krijimtaria e Laâbit u zhvillua në pjekurinë e plotë, duke lënë vetëm një gjurmë të surrealistit disi fallso të veprës së tij të hershme "L'Oeil et la nuit" (Syri dhe nata – 1969). Në "Le Règne de barbarie" (Sundimi i barbarisë – 1976), "Sous le baillon" (Nën tapën e gojës – 1981) dhe "L'Ecorché vif" (Tepër i ndjeshmi –

1986), vepra të quajtura prozoema, orvatet për një gjuhë që është e rafinuar, e kthjellët e mërziur dhe që është e lirë nga funksioni pseudomimetik i prozës, duke mos u druajtur të përfshijë material autentik, si letra për Mario de Andrade dhe për djalin e tij në "L'Ecorché vif". Në "Le Chemin des ordalies" (Udha e ordalive – 1982), Laâbi transformoi letrat e tij të burgut, të botuara më vonë si "Chroniques de la citadelle d'exil" (Kronikat e fortesës së mërgimit – 1983), në një poezi të kulluar proze, që është njëri nga raportet më të paharrueshme të burgimit që janë shkruar ndonjëherë.

Në intervistat, si në atë me Jacques Alessandrën të botuar, si "La Brulûre des interrogations" (Djegia e marrjeve në pyetje – 1985), Laâbi shqyrton me çiltërsi dhe me depërtim të madh historik dilemën e marrëdhënies midis intelektualit dhe shtetit, një dilemë me të cilën ballafaqohen të gjithë shkrimtarët në shoqëri të varfëra dhe despotike, dhe që shpesh shmanget ose minimizohet. Duke problematizuar vazhdimisht rolin e shkrimtarit, vepra e Laâbit ka mbajtur lart mundësinë e shfaqjes së një zëri të pakomprometuar letrar në Magreb; në këtë, ai zë vendin e dytë pas atij të shkrimtarit Kateb Yacine nga Algjeria.

Përveç një prodhimtarie të vazhdueshme poetike, ka botuar romane, pjesë teatri, ese si dhe vepra për rininë. Veprat e tij u përkthyen në disa gjuhë (anglisht, spanjisht, gjermanisht, holandisht, italisht, turqisht etj.). Përveç kësaj, ai ka përkthyer në frëngjisht shumë poetë arabë bashkëkohorë, duke përfshirë shkrimet e poetit irakian Abdelwahab Al Bayati, "Autobiographie du voleur de feu" (Autobiografia e vjedhësit të zjarrit - 1987). Veprat e tjera përfshijnë një pjesë teatrale, "Le Baptême chacaliste" (Pagëzimi i çakallit - 1987) dhe sekuencat e poezisë "Discours sur la colline arabe" (Fjalim mbi kodrën arabe – 1985) dhe "Histoire de sept crucifiés de l'espoir" (Historia e shtatë të kryqëzuarve të shpresës – 1980). Më 1980 u botua një përmbledhje esesh nga autorë dhe studiues të shquar si "Pour Laâbi" (Për Laâbin).

Me 1970, atij i jepet çmimi i Miqësisë franko-arabe, më 1979, fiton Çmimin Ndërkombëtar të Poezisë, nga Fondacioni Kombëtar i Arteve në Rotterdam, ndërsa më 1980 i jepet çmimi nga Pen Club francez, më 1981 e merr çmimin Albert Droin nga Shoqata e Njerëzve të Letrave të Francës, çmimin Fonlon Nichols nga Shoqata Afrikane për Letërsi (SHBA) i ndahet në vitin 1999. Po atë vit fiton edhe çmimin e Poezisë Valoni – Bruksel, më vitin 2002 është laureat i çmimit të Afrikës mesdhetare të ADELFI-t. Çmimin Alain-Bosquet për tërësinë e veprës së tij e merr më 2006, kurse sivjet fiton çmimin Robert-Ganzo të Poezisë. Dhe ja tani, Abdellatif Laabi është edhe laureat i çmimit tonë letrar "Naim Frashëri" të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" dhe i jepet titulli Anëtar Nderi i këtij Festivali. Më vitin 1998 është shpallur anëtar i Akademisë Mallarme, Komandant në Urdhërin e Arteve dhe Letrave nga Jack Lang, si dhe vitin e kaluar u shpall Profesor nderi i Universitetit Rennes 2 të Francës.

FRUTET E TRUPIT

(Editions de la Différence, 2003)

Në frutet e trupit
gjithçka është mirë
Lëkura
lëngu
mishi
Bile gurët
janë të shijshëm

Kush nuk provoi kurrë
të ndaluaren
le të më hedhë
mollën e parë

Hipokritët e shkretë
që ngjiteni në shtrat
me këmbën e djathtë
dhe i luteni emrit të Zotit
para se të ndërzeheni
Nga dera
që çon te kënaqësia
ju njihni vetëm
vrimën e verbër
të bravës

Kur teologët
me çallmë apo jo
merren me seks
kjo
më ndërpret oreksin

Më vjen vështirë të lexoj
traktatet e erotologjisë
Gjymnastika më mërzit
Po të mos ishte
dashuria
krijim
vepër personale
do të kisha braktisur shkollën e saj

Portret gruaje
me fëmijë
Ai është gjashtë vjeç
ndoshta shtatë
Dhe i shkon
për mrekulli

Fëmijët e mi
ndoshta besojnë
që nuk kam seks
Unë
kurrë s'kam dyshuar nga i tyri

Irida u shkri në iridë
Ç'po na ndodh?
Uria
nuk është më uri
Etja
nuk është më etje
Farë kanibalësh
bëjmë sikur
ta shtronim tryezën
Vetëm për t'u ngrënë me sytë?

Ti më jep derën
kjo quhet të japësh
Dhe ti di deri ku
shkon e imja
Do të merret së pari me
zverkun e satinuar
Do të zbresë për t'u ngatërruar
midis maleve dhe lugjeve
Pastaj do të niset
drejt perlës notuese
bivuak i endjeve të tua

Kur unë marr
iniciativën
vetëm të bindem ty
Atëherë më dikto
Ti di që jam
shkrues i mirë

Të lodhem
unë
t'i rezistoj punës së shenjtë ?
Jam punëtor-rob
që e kërkon përsëri

Kurrë s'jam përkulur
para diçkaje, për sa e fuqishme qoftë
Para teje
po
moj sovranja ime

Kemi gjithë kohën
 për të pikturuar këtë pëlhurë
 dhe për t'u veshur me të
 Të gdhendim këtë idhull
 dhe ta hamë
 Ta shkruajmë këtë vjershë
 dhe ta djegim

Pa u pastruar
 e kryej lutjen time
 krejt lakuriq
 Dhe më merr mendja
 që qielli e vlerëson

Në çfarëdo moshe
 në dashuri
 jemi të gjithë
 fillestarë

LE TË HAPIM SYRIN E ZEMRËS!

I

Letrat e mëdha më trembin
 I pres në dy
 për të shkruar
 gjysmë-poezi

Toka
 më trallis
 Ah, po të mund të ishte
 e palëvizshme dhe e sheshtë!

Nomadi ëndërron për një shtëpi
 I ndenjuri, për një kalë
 Ëndrra binjakësh siamezë

Dy endacakë takohen
 Mezi shikojnë njëri-tjetrin
 dhe kalojnë rrugën
 ku secili shtyn përpara vetes
 hijen e tjetrit
 Për t'u rigjetur
 duhet së pari të humbasësh

Kolovajzat
e mbërthyerë në yjet
janë më të ngurta

Sa i ngjajnë njëri-tjetrit vendet
dhe mërgimet, sa të ngjashme janë mes vetel!
Hapat e tu nuk janë prej këtyre hapave
që lënë gjurmë në rërë
Ti kalon pa kaluar

Ndonjë ditë do të duhet
t'i kërkojmë falje tokës
dhe të tërhiqemi
në majën e gishtave të këmbëve

||

Më shumë se një kuptim,
jetës
jepja konsistencë

E verdha pret të kaltrën
që vonohet me të gjelbrën
E bardha buzëqesh
për këtë skenë mediokre
zhgënjimi dashurie

Kjo dritë
nuk është për t'u përshkruar
Hahet ose pihet

Gjethja dridhet
ose nuk jeton

Ngrënia
është një festë pagane
kur t'i shikoni njëri tjetrit në sy
të dy sytë
Ç'është më e bukur
dera që hapet

apo sytë që mbyllen?

Ajo ç'është e bukur
është e bukur menjëherë
përgjithësisht

E pakufishmja është brenda nesh
Plus
ne jemi burimi i saj

Treni u humb
Transportonte një poet

III

Më thuaj pyetjet që të djegin
dhe do të të them kush je

Kush flet për ta ribërë botën?
Do të donim thjesht ta mbështesnim
me një degëz dinjiteti
në qoshen e buzëve

Vdekja zë pritë
Edhe jeta

Shpirti im më përket mua
Pse duhet ta japë?

O shira
po të ishit
lotët e qiellit
do të filloja të besoja

Edhe pse të pafajshëm
për gjakun e fqinjit tonë
na ndodh ta vrasim jetën
brenda nesh
disa herë
jo vetëm një

Janë dështimet
që na mësojnë
bujarinë

Të shpejtohemil!
Jeta nuk pret

Më thoni
drejt cilës asgjësi
rrjedh lumi i jetës
Kur
jeni larë në të
për herë të fundit?

Popujt e lumtur
nuk kanë poezi

Le të hapim syrin e zemrës!

LIBRI I RI

Një libër i ri
i ngrohtë ende
Ti nuk injoron asgjë prej tij
ndërsa të duket tashmë si i huaj
ky fëmijë
legjitim pa dyshim
Çfarë
do të ëndërroje për ndjekësin
e një bastardi
bjond
me sy të kaltër
të bërë me një zonjë gjuhë
qëllimisht hermetike
Një libër ku do të ishte i mbrojtur
nga arsenali
i pohimeve me kokë
të lexuesit ?

FATKEQËSITË E NJË ËNDËRRUESI TË NGARKUAR

Nuk është çështje supesh
as bicepsi
barra e botës
Ata që e mbajnë
janë shpesh më të brishtët
Edhe ata i nënshtrohen frikës
dyshimit
shkurajimit
dhe nganjëherë madje mallkojnë
Idenë ose Ëndrrën e shkëlqyer
që i ka vënë
në zjarrin e mundimit të ferrit
Por nëse palosen
nuk thyhen
dhe kur nga fatkeqësia e shpeshtë
priten dhe gjymtohen
këto xhunkthe njerëzore
dinë që trupat e tyre të shpuar
nga tradhtia
bëhen aq shumë fyej
që barinjët e zgjimit e ngrenë në buzët
për të kapur
dhe dërguar deri në yjet
simfoninë e qëndresës

VAKSINË

Paris Orly
Ti je në lozhën e parë
të qëllimit lëvizës
duke ruajtur valixhen e kuqe
që ke inauguruar gjatë këtij udhëtimi
Kur del pas pritjes së gjatë
me vështirësi e njeh
Është sikur të kishte kaluar
galeritë e një miniere qymyri
Veç kësaj është e prishur
Cilit inkuizitori i ka pëlqyer
ta kontrollojë pa komoditet
kurse ti kishe futur poezitë e tua
në mbrojtje në çantën tënde të dorës?
Hajde, ndal kinemanë tënde
ndërron mendimin

inkuizicioni i sotshëm vishet me dorëza
dhe përdor rreze
Ka çekiçë të tjerë në kokë
Ti ke rruar mjekrën më kohë
dhe nuk mendon më që revolucioni
është për nesër
Pasnesër ndoshta, nëse ia arrin
të realizosh
në laboratorin tënd sekret
një vaksinë kali
kundër budallallëkut triumfues

KATËR VJET

Do të jenë së shpejti katër vjet
më kanë shkëputur nga ti
nga shokët e mi
nga populli im
më kanë lidhur
mbyllur gojën
me sy të mbuluar
më kanë ndaluar poezitë
emrin tim
më kanë mërguar në një ishullth
prej betoni dhe ndryshku
u vendos një numër
mbi kurrizin e mungesës sime
më kanë ndaluar
librat që dua
lajmet
muzikën
dhe për të të parë
një çerek ore në javë
nëpër dy grila të ndara nga një korridor
ishin ende atje
duke pirë gjakun e fjalëve tona
një kronometër
në vend të trurit

FJALIM MBI KODRËN ARABE (1985)

Xhelati u zgjua
Pranë tij

gruaja e tij fle ende
Rrëshqet vjedhurazi nga shtrati
rivishet me uniformën e tij të xhunglës
dhe del
Në rrugën e dhomëzës
ku e presin veglat e tij
dhe viktimat e tij të ditës
mendon për gjërat e rëndomta të jetës
çmimet që ngrihen
shtëpia që do të jetë tepër e ngushtë
kur të vijë fëmija i pestë
shirat që vonohen prapë sivjet
rezultati i emisionit të fundit kulturor në televizion
I afrohet zyrës së hyrjeve
drejtohet për në dhomëz
e hap derën
Trupat janë strukur në gjysmë-hije
kollitje
kutërbim
Çohu horr!
bërtet
duke hedhur një shkelm
në pleksusin e të akuzuarit të parë
që gjen këmba e tij

TEPËR I NDJESHMI (1986)

Poeti arab
ulet para tryezës së tij boshe
përgatitet të hartojë testamentin e tij
por zbulon që ka humbur
zakonin e shkrimit
Ka harruar poezitë e veta
dhe poezitë e prejardhësve të tij
Dëshiron të qajë nga inati
por kupton
që ka humbur përdorimin e fjalës
Nga lufta e lodhshme
përgatitet të çohet
por ndien që ka humbur
përdorimin e gjymtyrëve të tij
Vdekja e ka paraprirë
atje ku do të duhej të hiqte dorë
përballë jetës

GJUHA E NËNËS SIME

Prej njëzet vjetësh nuk e pashë nënën time
E ka lënë veten të vdiste nga uria
Tregojnë që shpëstullte çdo mëngjes
shaminë e saj të kokës
dhe godiste shtatë herë dheun
duke mallkuar qiellin dhe tiranin
Unë isha në shpellë
atje ku i dënuari lexon në hijet
dhe vizaton mbi muret shtazët e së ardhshmes
Prej njëzet vjetësh nuk e pashë nënën time
Më ka lënë një takëm kinez kafeje
ku filxhanët thyhen një pas një
pa pendim nga ana ime se janë aq të shëmtuar
Por kafën e dua edhe më shumë
Sot, kur jam vetëm
huazoj zërin e nënës sime
ose më saktë, është ajo që flet në gojën time
me sharjet e saj, fjalët e saj të vrazhda dhe
mallkimet e saj
rruzarja e pagjetshme e shprehjeve të saj
zvogëluese
gjithë fara e kërcënuar nga fjalët e saj
Prej njëzet vjetësh nuk e pashë nënën time
por jam njeriu i fundit
që flet ende gjuhën e saj

DY ORË ME TREN

Në dy orë me tren
rikaloj filmin e jetës sime
Dy minuta në vit mesatarisht
Një gjysmë ore për fëmijërinë
tjetër për burgun
Dashuria, librat, bredhja
ndajnë pjesën e mbetur
Dora e shoqes sime
shkrihet dalëngadalë në timen
dhe koka e saj mbi supin tim
është aq e lehtë sa një pëllumb
Kur të arrijmë
do të kapërcej të pesëdhjetat
dhe do të më mbetet për të jetuar
një orë për afërsisht

SHKURTIM PËRJETËSIE

Mbi trapin do të ndez një qiri
dhe do të shpik lutjen time
Do t'ia lë valës së frymëzuar
kujdesin për të ngritur tempullin e saj
Do të vesh me pelerinën time
peshkun e parë
që do të fërkohej në rremat e mi
Kështu do të kaloj natën dhe detin
pa ushqim dhe pulëbardha
me një copë qiriri
dhe një fije lutjeje
Kështu do të iki
me fytyrën time të ndriçuari
dhe do t'i them vetes
o gjysmë njeriu, gëzohu
do të jetosh, nëse ende s'e jetove
një shkurtim përjetësie

Perktheu: Silke Liria Blumbach





Trine ANDERSEN (DANIMARKË)

Trine Andersen u lind më 1969. Diplomoi për letërsi në Universitetin Jugdaneze më 1996.

Është anëtare e bordit të Lidhjes së Shkrimtarëve Danezë 2000-2006.

Më 1995 debutoi si shkrimtare fikcioni me përmbledhjen e tregimeve të shkurtër *Hotel Malheureux*. Libri u shpërblye me çmimin Debutimi më i mirë

i vitit 1995. Më 1998 botoi romanin *Kompleks*. Ndërkaq, më vitin 2001, përmbledhjen e poezisë *Den nye verden* (Bota e re).

Më 2003 botoi romanin *Elinor marks fulde fem* (Pesë shqisat e Elinor Markut).

Përmbledhja e tregimeve të shkurtra *Anden kønslig omgang* (Përveç marrëdhënies seksuale). E pa dritën më 2005 sivjet ka botuar përmbledhjen me poezi *På den anden side* (Në anën tjetër).

Prej 1995 – 2008, ka botuar libra të ndryshëm për fëmijë, si dhe kontribute në disa antologji të ndryshme për fëmijë, të rinj dhe të rritur.

Si shkrimtare është marrë me të gjitha zhanret letrare: tregime të shkurtra, poezi dhe romane. Realizëm, surrealizëm. Nëse ka një qëllim të shkrimit të saj, është të bëjë çdo herë një libër të ri.

Mund të mos jetë i ri për historinë letrare, por i ri për të. Preferon të hulumtoj kufijtë midis zhanreve.

Në vitin 2006 udhëtoi nëpër Mozambik, Afrikë, për të bërë hulumtime për një roman të ri. Ishte një thirrje zgjimi të ballafaqohet me varfërinë shkatërruese atje. Prej asaj kohe ia ka kushtuar një pjesë të kohës themelimit të një shtëpie botuese në Malavi.

CHINATOËN 2

ka gjëra që nuk kam thënë
gjëra të tjera
përveç atyre që po ashtu nuk kam thënë
rënjesisht të ndryshme

kjo i shton një timbër, besoj
historisë së tërë, një shikim i shpejtë agonizues
prej drite të çuditshme dhe kështu
aq i rëndësishëm për t'u përfshirë

jemi të ulur prapa perdeve të rënda
madhërisht

me këmbë pulash në supën tonë
dhe perime të pidentifikuara

fytyra ime kalon nëpër dorën tënde
dashuria është të mos dish të gjitha
por përgjithësisht të besosh dhe prapë
të çuditësh

BENAJARAFE

ja ku jemi, pra
duke parë se si turistët mbarojnë sezonin
plazhe të shkretuara

befas zbulojmë afrikanët
e vdekur që u mbytën duke ikur nga uria
në anën tjetër
dhe u shpëlanë për në bregdet

duhet të bëjmë diçka
thonë eurokratët
dhe vendosin t'i dhurojnë më shumë para
patrullimit

sikur "guarda civil" të mos shfaqej
kërcënuese mbi ne si grenza
me brisqet e tyre rrotulluese
duke pritur gjethet e çara mbrojtëse

peshkatarët vendas i zvarrisin në plazh
lërin
i marrin pulëbardhat
(si ushqim i shpejtë me pak yndyrë ha ha ha)

veçanërisht sytë
duhet të jenë delikatessa
të mbushura me horizonte

VENDLINDJA

ka vende të tjera përveç këtij
nuk i njohim
periferia jonë e vogël implozive
ja ku gjendemi
qendra jonë e vogël tregtare
dritë nëpër xham
kanaçe njomëse me skumbri të konservuara

atje është Amerika, atje është Selaniku
dhe fantazia e fundit: Australia
jo për ne

ç'kemi bërë për të merituar këtë lumturi

(o skumbri
ti, ëndrra me shirita tigri
grabitqarësh në barishten e detit
në errësirën nën shtratin
pa mëshirë)

*Përkthim nga danishtja në anglisht nga Lars Bastholm,
nga anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach*





Ayman AGBARIA (PALESTINA)

Ayman Agbaria u lind në Umm Al-Fahm (Izrael) më 1968. Dr. Agbaria është autori i përmbledhjes arabe të poezive "I shpërndarë... Të lutem mos më mblidh" të botuar në Shfaamre (Izrael) më 1997. Shkroi edhe "The Bus", që u prodhua për festivalin "Acco" për Teatër Alternativ më 2003. Më 2004

shkroi dramën e tij të fundit, "E bardha e syrit", të prodhuar nga teatri "Almedan" në Haifa më 2005. Poezia e tij u përkthye në gjermanisht, hebraisht dhe anglisht. Është përfshirë në shumë antologji dhe është botuar në disa botime revista letrare. Dr. Agbaria ka qenë shkrimtar mysafir në disa institucione kulturore, mes tyre "Cove Park" në Skoci, "The Royal Court Theatre" në Londër dhe "The Valparaiso Foundation" në Spanjë.

Agbaria ka mbrojtur tezën e doktoraturës për teori pedagogjike, politike dhe pedagogji ndërkombëtare dhe krahasuese në Universitet Penn State. Dr. Agbaria ka dy diploma, një tërë në kriminologji nga Universiteti Hebre i Jerusalemit dhe tjetrën në zhvillim ndërkombëtar dhe ndryshim social nga Universiteti Clark. Ka punuar për Shoqërinë Izraelite për Qendra Kulturore dhe organizatën Shatil të Fondit të Izraelit të Ri. Ka themeluar dhe drejtuar edhe programin joformal arsimor për studentë arabë në Shkollën e Lartë Beit Berl. Pozita e tij e fundit ka qenë ajo e redaktorit bashkëmenaxhues në Revistën për Arsim të Krahasuar. Më 2006, Dr. Agbaria mori një bursë pasdoktorale nga Komiteti Izraelit për Financimin e Arsimit të Lartë (VATAT) dhe filloi së punuari për Universitetin e Haifës. Momentalisht jep mësim në Universitetin e Haifës dhe Shkollën e Lartë Beit Berl.

VETËM

Dy kapele e kurorëzojnë
 njëra e zezë, tjetra për të mbuluar sytë e saj.
 Dy shalle e mbulojnë,
 njëri i zi, tjetri për të fjetur në kurrizin e saj.
 Dy pallto e mbështjellin,
 njëri i zi, tjetri për të ngrohur vetminë e saj.
 Dy bluza e zbukurojnë,
 njëra e zezë, tjetra për të ndritur mallin e saj.
 Dy funde e fshehin,
 njëri i zi, tjetri një dhuratë prej tij.
 Dy palë çorapë shkelin për të,
 njëra e zezë, tjetra e lënë pas prej tij.
 Dy palë këpucësh ecin jashtë për të,
 të dy të zeza, të dy për rrugën,
 ku ajo gjendet në mes
 midis dy bankave,
 të dy të zeza, asnjëra për të.
 Varet si një kravatë
 që rrëshqiti prapa tij kur ai e braktisi.
 Ajo është e veshur për vdekje
 ose një prekje, po qe se do të vijë.

VETMI

Vetmi
 është ku nuk ka njeri për të të zgjatur një peshqir.
 Duhet të dalësh nga dushi i lagësht.
 Lakuriq ecën nëpër
 një qilim që të thith.
 Qarje pikojnë nga ti si qershi,
 si princa të mundur,
 ujë i lashtë.
 E shmang pasqyrën
 kështu që fati yt nuk të leh.
 Je i ulur në skajin e shtratit
 mbi një çarçaf të verbër.
 Kap një peshqir të njomë
 dhe than zemrën tënde.
 Shikon këmbët e tua:
 thonjtë e tu janë tepër të gjatë
 dhe askush nuk të tregoi
 përveç ziles së derës.

HERA - HERË

Ndonjëherë
një espresso në tavolinë është më e mirë se dhjetë
zogj në shkurre.

Nganjëherë
një karrige kundrejt murit mund një dritare nga deti

Hera-herë
një film aksioni tejkalon një poezi të vdekur

Ngandonjëherë
babai yt kishte të drejtë

Përktheu nga arabishtja në anglisht Antony Dunn,
ndërsa nga anglishtja në shqip Silke Liria Blumbach


ZOTI DHE ZEMRA IME

Zoti dhe zemra ime janë të dy vende të larta
si dollapi i ilaçeve,
të dy aq të paarritshme sa raftet
ku janë ulur librat fetarë.

Janë aq afër njëri-tjetrit sa syzet e mia dhe sytë e
mi;
janë të dy aq të bardhë sa çarçafët e shtratit tim,
të dy aq të ftohtë sa çdo gjë, të dy
aq të pastër sa një thikë e re fringo kuzhine.

*Përktheu nga arabishtja në anglisht W. N. Herbert,
ndërsa nga anglishtja në shqip Silke Liria Blumbach*





Mario BELLIZZI (ITALI)

Mario Bellici u lind në vitin 1957 në St. Basilio, një fshat i vjetër me origjinë shqiptare, i themeluar në Jugun e Italisë (Kalabri) nga refugjatë shqiptarë në shekullin XV. Ai është pedagog për matematikë dhe shkenca informatike në një institut teknik për topografë. Është thellësisht i lidhur me vendet e Mesdheut dhe Ballkanit; me një fjalë, e do Lindjen dhe Afrikën. Shkruan në një gjuhë

gojore, të çuditshme dhe magjike; një gjuhë të përcjellë gojarisht nga prindi në fëmijë, pa shkrim.

Ka botuar librat: "Antologji poetike: St. Basile" (1982); "Kristla" (Bar i keq) (1983), atëherë i ribotuar në revistën kosovare "Fjala"; "Nga e Bukura More stërgjyshore deri në të bukurën More të pavend" në Kongresin e II-të Ndërkombëtar për pakicat etnike dhe gjuhësi (1988), Piana degli Albanesi - Palermo (Itali); monografinë historike "St. Basilio Craterete" (1995) Castrovillari; është kujdesur për "Vallen e Zaravet" (Vallja e Zanave) (2000) Castrovillari, duke fituar Çmimin Ndërkombëtar "Nderim kulturës" për Villa S. Giovanni (Itali); librin me poezi "Kush jemi tani?" (1997) në Kosovë; librin me poezi "Dalja e fundit për të Bukurën More" (2003) Castrovillari (Itali); është kujdesur për "Jan di lula monosaqa" (Janë dy lule manushaqe) (2004) Trebisacce (Itali). Në Edicionin e IX të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" u shpërblye me çmimin letrar "Qiriu i Naimit".

TRE TRËNDAFILA

Bleva tre trëndafila të kuq
e i ngallosa brenda gotës së zakonshme.
I pari trëndafil është kushtuar muezinit
të mjerë, që në agim na pëshpëriti në veshë
nga maja e Gjithësisë
lutje për shpirtrat tanë të qëlluar.
Të dytin trëndafil e mbajta për sytë e mi të trishtuar
dhe të etur për të kuqin-ikonë.
Trëndafili i tretë ishte një uratë për ty
trup prej mjalti dhe papirusi
trup i ngjeshur me brumë ishujsh
kravela me trajtë petli.

KËTU HISTORIA ËSHTË TRANS

Në Tetovë, në mes një lulishte të gjelbër
 mbi një kërcell mermeri
 është kumbisur,
 me trajtë tregimi kryet e Naimit.
 Këtu përballohet ushtria për një statujë të çmendur
 që s'mendon më gjatë
 të shndërrohet në pëllumb dhe të fluturojë në Kumanovë.
 Kapen pas një kezë malesh
 një grumbull fshatra-ndërgjegje
 fshatra kuarci dhe gjaku
 vëzhgojnë tinëzar luginën
 për të diktuar Kod në dorë zakonet e vjetra.
 Në cipën e periferisë
 në Kohët e Kohave
 duar të mjerueshme shtrinë
 ndër varrezat pllaka me Rrota dhe Diej
 emra të vdekurish në luftat kundër fesë
 për lirinë ose dashurie.
 Sot sytë e tyre të zyrtë shikojnë
 puthjet e dashnorëve të gjalla
 këtë Rezistencë të jashtëzakonshme
 minaret, lumin dhe lulishtet me trëndafila
 akuarelet përrallorë që bujku paraqesi gjatë urave
 të holla.
 Argjendarë-ëndërrues krah për krah me kalldrëmet
 ndër dyqane të vogla nxjerrin lajle ari.
 karfica me pika të planetëve të Gjithësisë.
 Këtu historia është trans dhe nevon shumë kujdes.
 Thell syve të një lustraxhiu
 pashë që ndrinte krenaria e Lekës.

HIJE

Në nëntor
 Maqedonia është e tërë një shkëlqim
 pa dritë dhe pa afsh.
 Në Balkan
 jetohet në dyshimin më të tejmë
 ndër thyesat.
 Këtu asgjë është e tërë
 si thonte Pessoa rreth Portugalit të vet.
 Njëherë të mëdhenj
 Ilirët e Aleksandri
 në librat historie paraqiten sot me madhëri të kotë.
 Gjeografia është ëndërr e një sendi të bjerr.

BUKA ËSHTË DJERSË

E emëronin bukë
 e ne helb ish djersë
 shtëpia plotë bij s'ish tjetër
 veç se një vatër me hi të ftohtë.
 Qielli i nxivartur (derdhës) suvalash drite e
 dallëndyshe
 mbjatu në natë
 jo pas një shekulli
 mbushej me korrabaça (fantazma) e lakuriqë.
 Nani
 ka dyer të zgardallisura (hapëta)
 shoh djepa të zbrazëta, televizore pa zë,
 ferra gjer mbi qaramidhat (në çati), të vdekur e të
 sëmurë.
 Në kështu vete bota
 pragu i ditës u bëftë dhe kryqevotë (udhëkryqi)
 vohë kraveleje shtëpiake! U' pres.

DHIMITRI I RERES DHE KALI I SKËNDERBEUT

Përralla të dhimbëshme
 bota rrëfen nga ditë
 me fjalë të mësuara pëmendsh çë s'ndërron kot
 edhe kur harresa fshin veprat ose i largon.
 Historianët me ndërgjegje të qetë
 e me pak fjalë bëjnë, si mundëjnë,
 çmos të gjejnë dokumente në pluhurin e arkiveve
 data simetrike dhe shënime në fund të faqes
 sa të lajmërojnë të pranishmëve zbulimet e çastit
 udhëheqës të paqenë dhe prova të rreme.
 Me ndërgjegje të shqetësuar gjer në shekullin i XV
 bij kush e di të cileve nipa shqiptarë të arratisur
 të shpëtuar nga kërditë turke të përhershme
 fjalë për fjalë tregojnë të rrëmbyer
 urdhëresat e fundit që Skanderbeu i pafan, i smur
 dhe i zbetë,
 i dha stërgjyshërve e tanë.

"... ndë zallit detit,
 atje është një qiparis i hjeshtëm e lipëmadh;
 atje lidh ti kalin tim ...
 Mbi kalin, erëvet detit,
 ghapëni fjamurin tim;
 e ndë mest fjamurit lidh e lé mahjeren time.
 Kur t'frinj vorea e keqe

murxhari më ghingllisën
 fjamuri përghapjet
 e mahjerja trindëllisën ka i vrërti qiparis.
 Turku i gjegjën e, i trëmbur,
 tue kultuar vëdekjen çë fjë te mahjerja ime
 as ju pasën ngagha vât ”.

Edhe gurët dinë se veprat nuk qëndrojnë
 pse mërgimi dhe vdekja pluhur i bëjnë
 Il tempo porta via tutto, anche la memoria,
 (Omnia fert aetas, animum quoque)shkruan Virgilio,
 po fjalët e atyre tregimeve
 janë të stisur përjetë
 në vjershat e rapsodëve e në ankthet e të ikurve.
 Këtyre i përket të gërshetojnë ëndrra
 të tjerëvet Apologja e Historisë.

VOREJA

Poetët s’kanë dokumente, s’mbajnë arkive,
 flasin një gjuhë që nuk kuptohet mbjatu (gjithnjë)
 shumë herë s’dinë dhe ato që shkruajnë!
 Për këto është një gabim të ligjërojnë
 rreth kalit të Skanderbeut (gjok o karat?)
 mbi mahjerën e tij (e rëndë o e lehtë?)
 për ditën që mundën shqiptarët (e ënjte o e
 prëmtë?)
 për natyrën e Turqëve (ishin ujç?)
 e për atë t’Arbëreshëve (ishin qen?)
 Të lumtë, sot dimë si ish moti
 në Shqipëri në vitin 1468, 1469, 1470 e sa zëmra
 më ka ënda
 e kjo bën të rrëmbenj vorenë Poeti
 (vërtetë frynte në ata vite) e të shkruanj abonsina
 (pa të rreme)
 mbi murxharin (kalin) e Skënderbeut që tringëlliu
 mbi flamurin ç’u përhap, mbi cabjen që tringëlliu,
 qiparisin ç’u shkund,
 edhe se turqit e arbëreshët nuk qenë as luanë as lepuj
 dhe se prozë e tyre ish: Dhon Kishoti, Sanço Panca,
 Dulçinea,
 Xhiuljeta e Romeo, Kostantini e Jurendina, Ballabani,
 Karavaxhi me një ikonë nën sjetullë, Romanos Melodi,
 një prift anarkik edhe malli imi ...
 Popo çë fati i lig të humben meqënëse
 nuk frynte voreja!



Xhavit BEQIRI (KOSOVE)

Xhavit Beqiri u lind në Koliq të Prishtinës, më 21 gusht 1971. Aty mbaroi shkollimin fillor, kurse atë të mesëm e kreu në Prishtinë. Në vitin 1995 diplomoi në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filologjisë në Prishtinë. Po në këtë degë, i kreu edhe studimet pasdiplomike dhe mori gradën magjistër i shkencave të filologjisë.

Është asistent në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, si dhe Këshilltar për media dhe zëdhënës i Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu.

Xhavit Beqiri ka punuar gazetar i kulturës, përkatësisht redaktor në disa të përditshme shqipe, siç janë: "Bota sot", "Dardania", "Kosova sot" dhe "Pavarësia". Është njëri ndër nismëtarët e themelimit të shtëpisë botuese AKD (Asociacioni për Integritim Kulturor dhe Demografik), në të cilën kryen detyrën e redaktorit të botimeve.

Krijimet e tij poetike janë përfshirë në antologjinë "I kujt je Atdhe?" të përgatitur nga Ali Podrimja, të botuar më 2003 në Prishtinë, në antologjinë "Un alfabet al poeziei albaneze" (Një alfabet i poezisë shqipe), të botuar më 2003 në Bukuresht, me përkthim rumanisht dhe përzgjedhje të Ardian Kristian Kycykut, si dhe në antologjinë "Një gur i çarë", të botuar nga ShB "Rozafa", Prishtinë, 2005, e cila është botuar edhe në gjuhën angleze, me titullin "A Split Stone", më 2006.

Që nga viti 1994, kur u paraqit për herë të parë para opinionit letrar me librin "Lutje për njeriun" është vazhdimisht i pranishëm në letrar shqipe, qoftë me botime poetike, qoftë me vështrime, recensione dhe ese, në të cilat trajton fenomene të ndryshme (socio)linguistike dhe vepra të autorëve tanë e të huaj. Jeton në Prishtinë.

Xhavit Beqiri ka botuar këta libra: *Lutje për njeriun*, poezi, 1994, *Magjia e shtangies*, poezi, 1997, *Liria e leximit*, libër diskursiv, 2000, *Shën Vjeshta*, poezi, 2002, *Gjuha dhe Letrat*, libër diskursiv, 2005 dhe *Stili dhe gjuha e Martin Camaj*, studim, 2007

TRISHTIM

Kam me shkue
Një ditë
Te sh'pija e moçme
Krejt vetëm

Me i trishtue
Fushat e Bjeshkët

Tue i thirrë
T'gjallët e t'vdekunit

Le t'vajtojnë bashkë
Me mallin

S'mun e duroj ma
Durimin

ËNDRRA PËR IKJE

Një njeri i harruar
Nën qiellin e trëndafiltë
Lufton me zjarrin

Sulmon si Akili
Pa e ditur
Cili është Hektori

E kërkon gjithandej
Nëpër tokë e qiell
Një cak

Pa shpresë se do ta gjejë
Për t'ia dhënë ndonjëherë
Goditjen e fundit

Këputet në fushë
Pa frymë
Shpirti s'e braktis dot

Tutje është bota e madhe
Plot duf e jetë
O Zot

Të gjitha rrugët
Ajo ia hap
Njeriut të humbur

Nën shiun e hirtë
Ai mbyll sytë
Dhe e përqafo

Për të fundit herë
 Shpatën e pamundësisë
 E hedh përdhe

Lëshon grahmën e mortshme
 Të shpresës për ngadhënjim
 Ndaj vetvetes

Po e gënjen
 Ëndrra e kotë
 E harrimit

Mandej s'ndien më asgjë
 Veç pikave të hirta të shiut
 Mbi nurin e fytyrës plumb

(Prishtinë, 1, 2 maj 2005)

E VETMJA UDHË

Mbylli sytë ëndërromë
 Shtegtar humnerash

Mbylli sytë ëndërro vetveten
 Floçkë mes zanash

Ëndërro...

Një shtegtar shpirtvlarë
 Një hanë mes yjesh

Mbylli sytë sall një herë
 Me zemër më vështro

Larg ditëve me llum
 Larg netëve plumb

Ëndërro...

Sikur Titanic-u s'është fundosur kurrë
 Sikur Kullat binjake s'kanë rënë asnjëherë

Ëndërro...

Oh, veç një herë ëndërrooo...
 Si jemi shkrirë dikur me ëndrrat

Pastaj, do ta gjesh...
Udhën e vetme

Të vetmen udhë
Me m('u)ë kthye...

(Prishtinë, 16 dhjetor 2006)



Silke Liria BLUMBACH (GJERMANI)

Silke Liria BLUMBACH u lind më 13 dhjetor 1970 në Göttingen, Gjermani.

Në Heidelberg veproi në shoqatën letrare "LitOff" (Ofensiva letrare).

Shkruan poezi, tregime dhe ese.

Ka botuar dy vëllime me poezi: „Dyzet vdekje në Sarandë”, Naim Frashëri, Tiranë, 1999,

dhe "Karavela e fundosur", Ditët e Naimit, Tetovë, 2002.

Kam marrë pjesë në festivale letrare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Është bashkëpunatore e jashtme e FNP "Ditët e Naimit" në Tetovë, Maqedoni dhe anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Është lauruar me çmimin letrar "Qiriri i Naimit" të FNP "Ditët e Naimit", Tetovë, 2001, "Flaka e Janarit", Gjiljan, 2003, çmimin për krijimtari "Naji Naaman", Liban, 2005.

Shkruan në të gjitha gjuhët që flet, sidomos në shqip dhe gjermanisht.

Ka përkthyer poetin amerikan Craig Czuri, poeten jugkoreane Moon Chung Hee etj.

Ky është libri i tretë i saj.

NJËRA NGA BRESHKAT E NEMUNA

Ajo

Ajo që ngrihet e bie e ngrihet

Për të ngritur edhe të tjerët

Kristal në kohën e Atlantidës

Në erën e akullnajave, krizalidë

Ndërsa në kohën e sotshme zvarritet

Njëra nga Breshkat e Nemuna

Nga thellësia e maleve

Nga kurrizi i ujqërve

Për katër vite, si do t'ua mësojë vallen breshkave të vogla

Atyre që presin në rrugët e Maqedonisë që të shtypen nga makina

Edhe atyre që notojnë nëpër kënetat e Butrintit

Dhe breshkave që prehen dimrit nëpër frigoriferët e Gjermanisë

Katër vite vetëm për t'ua mësuar vallen

Derisa të mbarojë kalendari më i lashtë i rruzullit

Kur syri i tretë i falltares nuk sheh dot asgjë më

Atëherë Ajo, Njëra nga Breshkat e Nemuna
Do t'u ndriçojë vogëlushëve të saj
Me një fener të bardhë dhe një fener të zi
Dhe koracat e breshkave do kthehen
Në një trup prej drite.

BULQIZA II

Këtu
Në Bulqizë
Në këtë vend mes madhështisë dhe tmerrit
Mbledh copat munguese të gjëgjëzës së jetës sime
Hallkat prej kromi që i mungonin zinxhirit
Në minierë.

Ndërsa nga malet e panjohura në jug
Fryn një fllad i lehtë drejtësie
Si në përrallë, i pabesueshëm:
Shpërblehen të mirët. Dënohen të këqinjët.
Minatorët do të marrin rrogë të mirë
Dhe ndonjë ditë do ketë rrugë dhe dritë
Edhe këtu.

Bulqiza ime me dritë në ballë
Paradoksale dhe e dashur si vetë Shqipëria
Cilat mrekulli do t'i presin jetimët e tu
Në shpellat e kohës së ardhshme?
Rrugën magjepsëse drejt teje
Do ta gjejnë edhe guackat
Nga Danubi, nga Joni.

SHPELLAT DHE BOSHTET

Së shpejti
do të na errësojë
koha kur do të shuhen
mësimet.

Shpirtrat e ngatërruar do të enden
në jetë... në vdekje... në jetë...
shekuj
mijëvjeçarë
eone...

Ne jemi të fundit
që dimë.
Të vetmit

para se përherë të tretemi
në hapësirën e ndritshme pa fund.
Të vetmit me çelësin, që nuk duhet të tretet.

Do vijë koha e stuhive dhe ujqërve
kur s'do të mjaftojnë më as flakat
as petalet e lotusit
për t'i shpëtuar njerëzit
dhe mësimet.

Mësimet le t'i tërheqim, si të parët tanë gjahun,
në shpellat.
Njëmijë emrat e dhuruesit të fjalës
le t'i skalisim në muret e tyre!
Në shpellat e vocka prej betoni bunkerit!
Në ato të tuberkulozit dhe dinamitit,
mijëra metra nën shkëmbinjtë e Skënderbeut,
përreth eshtrave të vëllezërve tanë,
si gur të pazbulueshëm varri!

Varri mbaroftë të jetë djep, dhe djepi, varr...

Po njerëzit e verbër, me boshtet le t'i shpëtojmë,
si boshti i botës, por jo aq i shtrembër,
si ai i kurrizit, por jo i kërrusur!
Emrat dhe mësimet, mbi shtyllat, në Apolloni, në Butrint!
Për ju në Fier. Për ju në Sarandë. Për ju kudo.
Ne jemi vandalet e fjalës së shenjtë.
Mbi pesëmbëshjetëkatëshen! OXHAKËT NË ELBASAN!
Kullën e Babelit, shëmtinë e Jonit!

Ti, në qoftë se ua lexon fjalët,
nuk do të rilindësh në ferr.
As në botën e kafshëve. As në botën
e fantazmave të uritur.

Po t'i mos lexosh dot, mos u mërzi.
Mjafton që t'i shohësh. Nëse nuk i sheh,
mjafton që ua prekësh pluhurin. Por nëse as pluhurin
s'e arrin dot,
mjafton plotësisht që ty të prek hija.

Një fllad pluhuri, një kokrrizë hije –

do të gëlltitet dielli nga ulkonja
dhe fjalët do gllabërohen nga harresa,
por jo shpellat e boshtet, boshtet e shpellat,
mësimet dhe njerëzit, njerëzit dhe mësimet,
dhe ti, ti, ti dhe ti.





Ango BOJANOV (BULLGARIA)

Ango Bojanov u lind në vitin 1950 në qytetin Mellnik të Bullgarisë. Ka mbaruar Filologjinë bullgare në Universitetin "Kliment Ohridski" të Sofjes. Është poet, publicist, përkthyes, botues. Është autor i shtatë përmbledhjeve poetike, mes të cilave dhe "Kavaleri i hënës" etj., si dhe i disa filmave dokumentarë. Ka shkruar libra pub-

licistikë, ka marrë vlerësime të larta në Bullgari. Përkthen nga gjuha polake.

Për veprimtari botuese dhe afirmim të kuklturës nacionale ka marrë dy shpërblime shtetërore. Dy vite ka udhëhequr emisionin për letërsi në television. Ka qenë zëvendës kryetar i Shoqatës së shkrimatërve bullgarë.

Ango Bojanov vepron me mjetet personale në shtypin periodik, si dhe në atë elektronike. Gjashtë sezone periodike ka qenë udhëheqës i serisë emblematike "Me krijuesit drejpërdrejt" në pallatin Ncional të Kulturës, duke prezantuar portretet më të shquara të artit dhe krijimtarisë bullgare. Është themelues i formacionit " Muzika mesdhetare" "AngoBoy Cappella", ku merr pjesë si solist me mandolinë. Grupi ka botuar dy albume të pavarura sipas projektit të Ango Bojanovit "Muzika Mediterania".

MANDOLINA

Trupi i saj
nuk lejon të shëtisë
brenja nëpër të.

Trupi i saj
mahnit
shqisat e mia.

Trupi i saj
si dëshirë e argjentë
mbështetet,
madje m'i verbon sytë.

MANDOLINA

Trupi i saj
nuk lejon të shëtisë
brenga nëpër të.

Trupi i saj
mahnit
shqisat e mia.

Trupi i saj
si dëshirë e argjentë
mbështetet,
madje m'i verbon sytë.

Trupi i saj është
ruajtës
i dehjes.

Instrument
për fluturim dhe zhytje.
Vullkan nga erërat e lehta.
Deri në shkundjen e pluhurit.

QETËSIM

Shumë hapa duhet të bësh,
shumë këngë duhet të këndosh –
vetë mbi kullosë të zhveshur,
që një ditë të rritesh
edhe më pak se ajo...

POETËT E LASHTË

Drejt meje notojnë
fjalë të thëna
të poetëve të lashtë.
Si pëlhura anijesh
shkëlqejnë në largësi
metafora më të papritura.

Sepse ashtu mbështetur
pres në breg?

Sepse kuptimi për bregun
më bën frikë dhe luhatje?
Unë tanimë duhet të gëzohem
që bregu im rrënohet.

Ashtu më shpejt
do të shkël në ujëra,
atje ku,
poetët e shqetësuar
ashtu lirshëm notojnë.

SHKALLA

Vallë
oktavat e larta të shpirtit
janë për njerëz të vegjël?
Jonatyrore është
fëmija në ty
xhuxh të ngelë.

AKT

Shëndetshëm
tërheq pëlhurat e lundrë së lagur.
Për të satën herë –
kuptoj madje
se me ty
zhytja është fluturim.

Përktheu: Adem Abdullahu





Adisa BASIC - CECO
(BOSNJË-HERCEGOVINË)

Adisa Bashic - Ceco u lind më 1979 në Sarajevë. Është poete, kritike letrare dhe gazetare. Ka diplomuar në letërsinë komparative në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, kurse ka magjistruar në Qendrën për studime interdisiplinare në Bolonjë dhe Sarajevë. Duke shfrytëzuar bursën DAAD (dy semestra)

në Marburg të Gjermanisë ka studiuar gjermanishten dhe mediologjinë. Ka qëndruar tre muaj në SHBA si fituese e bursës speciale në Departamentin e Shtetit për një nga shkrimtarët e Bosnjë dhe Hercegovinës, Vietnamit, Ruandës dhe Irlandës. Poezitë e veta i ka lexuar në institucionet prestigjioze amerikane (Në shkollën Havard John F. Kennedy ne Boston, Poets House në Nju Jork, „Curbstoune Press“ Connecticut, „Wava Writers Workshop“ në qytetin Iowa. Ka botuar dy përmbledhje me poezi; Havine reçenice (1999) dhe Trauma market (2004), kurse poezija e saj është përfshirë në disa antologji dhe përzgjedhje. Për tregimin „Si ta përjetoj auto-stop-in“ ka fituar çmimin qëndror në konkursin e UNESKOS-s, kurse libri ku është përfshirë tregimi është përkthyer në anglisht, gjermanisht, bullgarisht ... Poezinë dhe kritikën për letërsinë e ka botuar në dhjetra revista në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe më gjerë. Prej vitit 2004, shkruan rregullisht kolumne të kritikës letrare në revistën „Slobodna Bosna“.

DREKË FAMILJARE

Motrat e mia të martuara lumturisht
fëmijët e tyre të lumtur, lumtur
vëllai im i lumtur i trashë
dhe Nëna në krye të tryezës.
Rrapëllitje enësh, e qeshur, e qarë qullashe...
dhe të gjithë ne, lumturisht, duke ngrënë këtë drekë -
por ti
(ende i papërmendur)
ushqen brenda meje
ndërsa Nëna thotë krenarisht
se asnjëri prej nesh ndonjëherë
s'e ka turpëruar.

POETE NË TROLEJBUS


Lakër, qumësht dhe bukë në dorë -
E varur, e lodhur, në tjetrën;
Dhe me të tretën, kodrat e largëta
E përkëdhelur, butësisht...

SPASTRIM ETNIK

e dëbuar në qytet
shpëtoi jetën e saj
dhe shtizat e çorapëve -
herët në mëngjes, pranë vendit të parkimit,
në një pikë shterpe me bar,
duke u kujdesur për kopenë e ëndërruar,
po thur – dhe i shqetëson
kalimtarët e akullt
me përsëritjet e saj shumë të ngrohta.

DITË E ZAKONSHME LUFTE

- të hapësh sytë. të çohesh.
- ta zgjosh atë.
- ta bësh gati për frontin.
- t'ia dhash një përsëritje rutinore, pa qarë.
- të sjellësh ujë.
- të lahesh.
- të brengosesh për periudhën që nuk vjen.
- të shkulësh vetullat.
- të lexosh të njëjtin libër për të pestën herë.
- të lodhësh veshët për të shtëna në drejtimin ku ai është rojë.
- të dalësh në kërkim të miellit.
- të ngutesh nëpër rrugët.
- të dëgjosh një shpërthim.
- të ndiesh goditjen e metalit apo gurit.
- të shtrihesh.
- të prekësh plagën tënde me gishtërinjtë.
- të lëpish gjak.
- të rrish shtrirë për një kohë të gjatë.
- të mos qash.
- të heqësh dorë.
- të hapësh sytë. të çohesh.



Khaled Ahmad DARWISH (PALESTINE)

Khaled Ahmad Darwish u lind më 1956 në një kamp refugjatësh palestinez afër Alepos, Siri. Khaled Darwish fitoi shpejt kuptimin e jetës së refugjatëve. Ballafaqonte jetesën e rëndë në kamp, por mbaroi gjimnazin me sukses më 1975.

Pastaj iku nga Alepo dhe u bë mësues për një bashkësi të vogël kurdësh, ku rritej njohuria e tij e njerëzve dhe vuajtjes së tyre.

Me 1977-78 u përfshi aktivisht në jetën kulturore në Siri. Botoi vepra poezie dhe materiale të tjera letrare në botime autoritative arabe. Me disa letrarë të tjerë mori pjesë në botimet ilegale të The Bulletin-it, gjë për të cilën kaloi dy muaj në burg. Më 1984 u diplomua për gazetari në Universitetin e Sofjes. Fitoi gradën "Master". Prej 1984-2004, punoi në një post korrespondenti për Palestinian Bissan Press. Vazhdoi të botonte vepra origjinale letrare në botime arabe dhe bullgare. Më 1994 u kthye në Palestinë me personelin e PLO-së si rezultat i marrëveshjes së lidhur në Washington midis PLO-së dhe qeverisë izraelite. Më vitin 1995 fitoi pozitën e këshilltarit për revistën javore Al-awda dhe më 1996-97 u bë anëtar i bordit redaksional të gazetës mujore letrare Masharef. Më 2005 u zgjodh anëtar i sekretarisë së përgjithshme të Lidhjes së Shkrimtarëve Palestinez. Momentalisht është drejtor i aktiviteteve kulturore për Lidhjen e Shkrimtarëve Palestineze.

Botoi këto velle me poezi: Mali, shb "Feker" - Beirut, 1979, Ngjarje, poezi, shb "Al-Thakafa"- Damask, 1981, Barriera, përkthimi i romanit të Pavel Vejnikovit, botuesi: Ministria e Kulturës, Damask 1983, Rrënjët e botës, përkthimi i poezisë së Ianis Ritsos-it, shb "Feker", Beirut 1984, Pasaporta, përkthimi i poezisë së Mahmud Darwish-it, "88", poezi, botuesi: Lidhja e Shkrimtarëve Palestineze, Jerusalim, 1997, "88", poezi, përkthyer nga arabishtja në bullgarisht, Sofje 1999.

DHJETË POEZI

1

Vetëm këndon ti
 Përgjatë shtegut të gjerë të gjelbër
 Në korridorët e ftohtë,
 Nëpër brigje zjarresh
 Dhe pranë kufomës gjaku i të cilit është tharë
 Vetëm këndon,
 Vetëm i pret engjëjt.

2

Në të gdhirë
 E lidhën me një trung peme,
 Dhunuan bravat e tij
 Dhe e ekzekutuan me varje
 Sepse nuk duket njëlloj

3

Natën
 Vjen djaloshi që kam qenë:
 Në dorën e tij, një kamp, një trëndafil para
 shpërthimit...
 Natën
 Vijnë zogjtë e parajsës
 Për të ngrënë shpirtin tim.

4

Vetëm eci
 Vetëm fle gjumë,
 Vetëm fus brenda hijet e mia të varura
 Mbështetem përtej murit të fqinjit,
 Vetëm digjem për ujë dhe për një agim
 Që ua jep bukën e tij njerëzve dhe erës
 Vetëm
 Shfletoj letrat e një shoku të vdekur
 Dhe vetëm vdes.

5

O Zot
 Ti më ofron zgjedhjen
 Midis skllavërisë së shkëmbit dhe
 Kaosit të erës.

6

Isha i ngopur me këtë muhabet
Për vdekje dhe liri;
Do të flas për kaçurrelat e tu të lagësht
Me mësymjen e një tetori të ngrohtë
Jam ngopur me pasqyra, libra dhe gjeografi
Do të të kap për dorë dhe të ecim
përgjatë udhëve nëpër pyjet
dhe për në lumë.

7

Natën, zemra ime dëgjon
Këngë femrash fshatare
Që zbresin maleve
Me trëndafila në buklat e tyre
Natën, zemra ime thyhet nga rënkimet
E një luftëtari në shtëpinë fqinje.

8

Po gruaja që dua nuk është toka,
Është qenie fizike në kërkim të qiejve,
"Iva" e ka emrin,
I ngjan nënës sime...
Ç'të them tjetër, miku im!
A dëshiron më shumë kafe?

9

I ri, e zgjas dorën për ta këputur lulen.
I vjetër, gjunjëzohem për erën e saj.
I ri, jam i humbur në qytet,
I vjetër, qyteti humbet në veten time.
I ri, i hap sytë për jetën,
I vjetër,
I hap sytë për vdekjen.

10

Premtimet e dështonin
Mërzitej me qarqet,
Asnjë hënë në qiell
Asnjë fëmijë në kopsht...
Kur ra në errësirën e korridorit,
Nuk kishte vdekje,
Jeta po vyshkej.





Shaip EMERLLAHU (MAQEDONI)

Shaip Emërllahu u lind më 13. IV. 1962 në fshatin Trebosh të Tetovës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërkaq Fakultetin Filologjik, Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe e kreu në Universitetin e Prishtinës.

Botoi vëllimet me poezi "Pagëzimi i viteve", Shtëpia botuese "Naim Frashëri",

Tiranë, 1994, "Projekti i thyer", Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë, Shkup, 1997. "Vdekja e paktë" në edicionin "Flaka", Shkup. 2001.

Më vitin 2001 "Akademia Orient - Oksident" në Bukuresht ia botoi në gjuhën shqipe dhe rumune vëllimin me poezi "Vdekja e paktë"- "Putina moarte". Në vitin 2004 PEN-i kroat dhe Shoqata e Shkrimtarëve Kroatë i botojnë vëllimin dygjuhësh kroatisht-shqip me titull "Poezi". Në vitin 2004, Shtëpia botuese "Feniks" nga Shkupi ia botoi librin me poezi të zgjedhura "Dvorski son". Në vitin 2000 në bashkautorësi botoi librin me dëshmi të masakrave në Kosovë "...edhe ne dëshmojmë / We witness", Sh.B. "Ditët e Naimit" (në gjuhën shqipe dhe atë angleze). Më 1999, në vazhdimë "Flaka" ia botoi monografinë "Sadudin Gjura, jeta dhe vepra" dhe monografinë Aktiviteti politik dhe kulturor i grupit atdhetar "Besa".

Poezitë e tij janë botuar në gjuhën frënge, angleze, hebraike, spanjolle, arabe, rumune, turke, polake, çeke, kroate, maqedone, vllehe etj.

Ka marrë pjesë në festivale poetike ndërkombëtare dhe ata vendore, si në Kolumbi, Irlandë, Tunis, Poloni, Kroaci, Rumani, Bullgari, Turqi, Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë etj.

Është nderuar me disa çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ka punuar gazetar në disa meda elektronike dhe të shkruara, brenda dhe jashtë vendit. Për disa vite ishte redaktor i rubrikës së kulturës në "Flaka".

Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit"- Tetovë.

BREZI IM

ende pa të pushuar
tamblit të të rrjedhë,
qimet e flokëve
filluan të të zbardhen

ç'fat paske
o Brezi im?!

NJË DITË

një ditë
do ta përqafojë Tetovën syhalë
e qeshura e shkullit të barkut
fytyrat e perënduara
do ta thonë një të kaluar
që i ka bërë të njohin veten
që i ka shtyrë të pyesin
pse vetëm shpezët ta kalojnë kufirin
e dy Dibrat në një kurt
të mos flasin mes vedi

kur Tetovës t'i bien brinjë
nga të qeshurat
Shkupit, Vardari a do t'ia përcjellë
apo do t'i ngrijë buzëqeshja
në cep të buzës

e ndiej
ardhjen e ditës së talljeve
të këtyreve viseve '91
nga qeshja

Dibër, 1991

MOLLËT E TETOVËS

nëpër koncerte shekujsh
i krasiste e ujiste Tetova
Mollët e veta

si kokë kripe
të vjen të pëlçasësh
kur i sheh tutje

si i grin dhëmbi i keq

fundja
hëngrën aq
sa t'u mpihen dhëmbët

Tetovë, 1989

ÇELJA E KUJTIMIT

në Qafë Thanë
kishte ngelur
hija e thyer e hënës pesëmbëdhjetë
vala e sertë e ikjes së anijes
dhe një tingëllim dhimbës
i një përshëndetjeje

tjetra me zemrën time
kishte çelur perden e kujtimit

Strugë, 2000

MAJAT E BARDHA

Panajot Xhebelikos

ende nuk u shkri
bora qindravjeçare
mbi Majat e Boçarit
Xhavellës
Katerinës

dielli e gaboi rrugën
jugu kur nuk fryu

prej se u ngritën këto Maja në Epir
zogjtë shtegtar vetëm qyqen dëgjonin

do të shkundet bora qindvjeçe
apo jo
ooo Oazat e Epirit

Janinë, tetor 1986

LULEPLUMBASH ÇELTE QIELLI

dy violina jete
para nesh u thyen nga plumbi
e tingullin ia vodhëm

e jeta
jeta e bukur ishte mbi Tetovë

ishte zoti vet

natën te frëngjia më ftonte

kur luleplumbash çelte qielli
njerëzve ç'sylirie u jepte

sylirie që i qorruam vetë

Tetovë, 15 mars 2001



Biba ISMAIL
(MAQEDONI)

Biba Ismail u lind në Shkup, ku kreu edhe shkollën e mesme ekonomike. Diplomoi në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke në Universitetin "Kiril e Metodi" në Shkup. Një kohë punoi gazetare në gazetën "Birlik". Në Universitetin e Venedikut në Itali ka punuar si lektore e gjuhës turke. Tani

është drejtore e një firme të huaj në Shkup.

Poezitë e saj janë botuar nëpër revista dhe gazeta të ndryshme në Maqedoni. Ato i janë botuar edhe në Rumuni, Turqi, Liban, Kosovë etj.

Më 1997, botoi vëllimin e parë me poezi "Dritarja që shikon kah vetmia".

Është pjesëmarrëse në festivale të ndryshme ndërkombëtare dhe ato të vendit.

Ajo është nderuar me çmime letrare në Liban dhe në Rumuni.

NORDIA

U përkas atyre
që janë ftuar në vetmi
por ventia në Nordi
është e pamundur të respektohet

Në një trazim erotik
në të gjitha nuancat
ngjyrat janë të pandërprera
deti, shkëmbinjë
drurët e zgjatur nga qielli
hijet e errëta...

A e keni soditur ndonjëherë
në Nordi
çastin e kalimit
të ditës në natë?

Sikur në të njëjtin çast
ngryset nata
sikur në të njëjtin çast
agon dita

Në horizont shembëllen si i tatuazhuar
ai top i bukur dhe i përhimtë
që nuk tretet kurrë

Përherë janë të tretur në njëri-tjetrin
agimi dhe muzgu
që njerëzit i aigëtojnë
me simfoninë e pafund
dhe të çuditshme të ngjyrave
pa dyshim ai është vallëzimi magjik
i diellit...

Duhet të shihet
të përjetohet Nordia
njëlloj si unë
kur të ndiej e të përjetoj ty.

• *Aludon në Nordlandin i cili kufizohet me të dy anë e Polin të Veriut të Norvegjisë*

LETËR TË DASHURIT TIM, DIELLIT

Dëshirë të vetme kisha të vallëzoja
duke mos lënë asnjë zbrazëtimë në mes
për mua edhe nëse është humbje çdo sukses i yti
dëshirë e vetme është që të mbetem pjesë e botës

“Paçka, jeta është një lojë e rëndomtë”, thoja unë,
përdalja – lojë e trupit
dashuria – lojë e vetëdijes”
ndaj më thoje se i shembëlleja Mesalinës... Sa
tërheqëse
vetëm të dashuruarit janë ata që na i plagosin
zemrat

Sa shumë vuajta, si në lashtësi
me dëshirën për t’u bërë subjekti e jo objekti yt
duke të ndier me të gjitha qelizat.

Dhe kur epshet janë shumë të fuqishme
ndarja nuk është befasuese
derisa nuk e gjen vendin tënd
në galerinë e kujtimeve të mia.

Në çastin kur përqafohemi me afsh
duke i ngjarë vallëzimit tango

e kuptova se obsesioni ishte i kapshëm;
desha që koha të ndalej.

Të vetmen dëshirë kisha të zgjohem pranë teje
madje edhe sikur të isha e ngujuar në letargji
por kot, nuk arrite dot të përshtatesh

Të paktën duhej ditur
se poetët janë sundimtarë
të fateve të tyre, i dashuri im...

*Gruaja e perandorit romak, Klaudit, e njohur për nga
shpirti i përdalë*

MISTERI I BUZËVE MBI STAMBOLL

Gjersa perëndon dielli
mbi Stamboll, qytetin misterioz dhe të lashtë
jemi vetëm ne nën shoqërimin
e simfonisë së erës së nxehtë
si trupi im që vjen me të katërta nga Bosfori
vetëm ne dhe butësia e buzëve tona.


...buzët, mbi njëra-tjetrën
buzët që s'rrinë të qeta asnjë çast
buzët që kërkojnë dhe e gjejnë hapësirën e butë
buzët që e shtojnë etjen sa më shumë që puthen

Në mes buzëve
majë e gjuhës aromatike
e bukur, fine, e lëvizshme
që fshikullon shpirtin

Vallëzimi i lagur i gjuhëve
të cilat kontrollohen midis tyre
është një ndijim tjetër
një kënaqësi tjetër që duhet shijuar

Sa ngacmuese janë
buzët që largohen
sa të përndezura
sa drithëruese
puthjet e çmendura
sa shumë të uritura
ëndrrat e trazuara
sa të zjarrra janë...

Pas përmbysjes
mbi Stamboll, mbajtja e
vibracioneve të lëkurës sime
në sipërfaqe të ndryshme
ta nxjerrë kënaqësinë e jetës
në një det të qetë
duhet të jetë e vetmja gjë
që mund të dëshirohet



ERIK LINDNER
(HOLANDE)

Erik Lindner u lind në vitin 1968 në Hagë, Holandë. Ka botuar tre libra me poezi: Tramontane (1996), Tong en trede (Gjuha dhe ecja, 2000) dhe Tafel (Tryezë, 2004). Jeton në Amsterdam dhe punon, si kritik poezie për javoren De Groene Amsterdammer.

Ka redaktuar një antologji franceze me poezi bashkëkohore

holandeze të përkthyer: Le verre est un liquide lent; 33 poètes néerlandais (Gota është një lëng i ngadalshëm; 33 poetë holandezë - Farrago, 2003). Poezia e tij u përkthye në frëngjisht nga Kim Andringa dhe Eric Suchère dhe u botua si Terrain (Terren - Centre International de Poésie Marseille / Spectres Familiaux, 2007). Ka marrë pjesë në Konferencën e Cambridges për Poezi Bashkëkohore (2000), Festivalin e Parë të Poezisë në Taipei (2001), në Poezine Ndërkombëtare në Rotterdam (2002) dhe ka bërë reportazhe për radion holandeze nga Montreal, Taipei dhe Tirana.

TRAMONTANA

Larg bregut, zhytësi mbetet në historinë e tij dhe rrallë vizaton shkëmbin prapa plazhit. Era pret historinë dhe mban dhe fërkon gjethet larg pemëve të rrafshinës – korniza e dritares.

Unë e kisha erën mbrapa për këtë histori. Udhëtimi tregoi për një burrë që ecte nëpër një mal dhe përralla zhytet poshtë në det. Era

sillet me varrin e tij si me një zotëri. Dhe zhytësi është zënë në mes të gurëve, ndihmësit shfaqen dhe era shtrydh gungën dhe detin.

Era pikturuese e zhytësit tërbon larg bregut. Shkëmbinj të lulëzojnë. Dhe varri është një hap drejt koralit në një shpellë në fund mbi gdhendja në ngjyrë të perdes prej lulesh.

*

Ka gjak në buzët e tua
dhe megjithatë era fërshëllin

megjithatë metroja gjëmon
nën tryezën aq shumë
saqë koka jote rrëzohet
dhe bile një fjalë e mekur
shpërthen në veshin tënd

flokët e tu janë derdhur
nëpër pëlhurën
por syri yt po hapet
dhe peshon në dritën e llambës
pluhurin që dridhet në ajër

dhe gjërat që ulen mbi ty
tepër të vogla për tryezën
tepër të holla për erën.

OSTEND

1. Një asht gjendet në rërën
e një ishulli që nuk ndalet

forma është e caktuar
historia e erës
shtyrja e palcës dhe gurit

era humbaset në det
asnjë dallgë nuk ka të njëjtat përmasa

ngjyra rëre të kuqe në diell
në pistën e garës ku pluhuri xhindoset
dhe thundrat godasin në ritmin e njëjtë
thundrat godasin rërë në fragmente

matanë një ishulli bredh era
dhe ripunon gjurmët e saj të mëparshme,
guri i palcës në plazh,
pista e garës në bregdet,
shiu në det.

2. Deti ka madhësinë e erës
dhe vërshon mbi gurin e palcës
të punuar nga era për detin

gurë janë të padukshëm për detin

një zog rëre ecën prapa erës
dhe me hapat e tij numëron
pjesëzat e liruara të rërës

dhe majat e dallgëve të fryra larg
dhe flokët e erës të fluturuara

pjesë rrokulisëse kacavjerrëse lëvizëse
të një ishulli ende për një çast
në skajin e detit

rëra sulmon palcën
thundrat shtrydhnin gurët
deti mbart ashtin në breg
rëra qetësohet në erë

flokët masin madhështinë
e një ishulli të përkohshëm të krijuar
poshtë hapave të zogut të rërës

jashtë erës
mbi detin.

*Përkthyer në anglisht nga Paul Vincent, nga anglishtja në
shqip nga Silke Liria Blumbach*





Viktoria IVANOVA
(BULLGARI)

Viktoria Ivanova është e lindur në vitin 1960. Jeton në Vracë, Bullgari. Është autore e shumë përmbledhjeve poetike, kurse ne po veçojmë këto:

1. "Krahë të imagjinuar", 1997.
2. "Natën", botoi Sh.B. "Zahari Stojanov", Sofje, 2001.
3. "Vetëm shi", botoi Sh.B. "Svetullka", 2003.

4. "Derdhma shikimin kafe të syve tu", Bllagoevgrad, 2006. (Ky libër i është botuar si libër më i mirë në Konkursin poetik "Gorçivo Vino" të Mbrëmjeve poetike të Mellnikut, në vitin 2004, në Bullgari.

Para disa ditësh i doli nga shtypi libri më i ri poetik "Gjithësia udhërrëfyese" në Sofje.

Autorja është fituese e më shumë çmimeve vendore dhe atyre nacionale. Poezitë e saj janë të botuara edhe në Maqedoni, në revistën "Sovremenost", 2005, Shkup.

Gjithçka është krejtësisht në vend të vet
që kur ai shkoi.

Gjithçka më mjafton
dhe fare nuk rrezikohem.

Ai "mirupafshim" nuk më tha.

Vetëm kokrrën e groshës
ma mori...

Si të dëshmoj tani,

që jam princezë e vërtetë?

MODUS VIVENDI

Verën, që shkëlqente
për ne të dy,

e piva vetë.

Kurse ti nuk je –

as telefonikisht, as gjallë...

Nuk guxon ta zgjosh

madje as ëndrrën time – nga frika,

se nuk do t'i mbijetosh
lumturisë nga goditja e butë.
(Ajo është flatrim fluturë
me krah të shkruar
dhe shumë shpej koha rrjedh.)
Ti pin Keracudën
tënde të tejdukshme.
Kurse unë timen.
Dhe kështu zbehtë jetojmë.

Kështu e prita Vitin e Ri –
e pa përkëdhelur dhe e pa puthur.
Në tryezë gjithçka kam.
Ajo është hiçgjë...Meqë të humba.
Ndeza qirinj, mbusha verë,
bredh ngrohës. Dhe thjesht u ngroha –
nga përjetimi i vitit të kaluar,
kujtimi i verës dhe ardhja zbatuar.
Shtëpia e mbushur – me festë. Dhe me mendime
për jetën time të panevojshme.
Bora mbush rrugën...
Dhe është e pastër.
Dhe është Viti i Ri... Pa ty.

ZEMËR

la ndalova zemrës time
të të dashurojë,
sepse dhemb –
kurse ajo mua më mohoi
para gjelave të parë.
Më dorëzoi në kryqin
e padallueshmërisë
dhe u bë magji tronditëse
me dëshirën të të dashuroj.
Meqë vetëm për një të vërtetë
tërë jetën synosh...
Mirë de, zemër, duaje pra!
Ta di për çfarë jetosh!

Uri i fundit i zjarrit
plasi dhe fjet i lodhur.
Damari i etshëm i kujtimit
zgjoi ndjenjë të fshehur.
Në natë nën kupolën e tejdukshme
kërceu tufë episodesh.
Në varësen e hënës rrumbullake
u varën...Sa mbrapshtë!
Pa mua.Unë përsëri ngela
e gjallë – mes shumë të ndjerëve.
Jeta nga fillimi më ngërtheu...
Mirupafshim, kujtime!
Këndoni lirisht.

Përktheu nga origjinali: Adem Abdullahu





Ledia DUSHI
(SHQIPERI)

Ledia Dushi u lind më 1978 në Tiranë. Ka kryer degën Gjuhë dhe Letërsi në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Tani është duke vijuar studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, dega Letërsi.

Ka botuar vëllimet poetike "Ave Maria bahet lot", 1997 dhe "Seancë dimnash", 1999.

Ka përkthyer "Pavdekësia dhe ese të tjera" (ese filozofike), Jorge Luis Borges, 2000, "Shembja e Burrit" (roman) Sandro Veronesi, 2006.

Është fituese e çmimit letrar «Migjeni» dhënë në konkursin poetik lokal organizuar në qytetin e Shkodrës, 1993, çmimi i gazetës "Zëri i Rinisë" për ciklin poetik më të mirë 1996, çmimin letrar '97 «Penda e Argjendtë» për Libër i Parë me vëllimin poetik "Ave Maria bahet lot", organizuar nga MKRS, 1998. Ka marrë pjesë nëpër aktivitete të ndryshme letrare, si dhe ka fituar bursën e veçantë si poete në Literarisches Colloqium Berlin, 2004, dhe bursën e veçantë si poete në Graz, Austri, 2005.

Poezia e saj është përkthyer në gjuhën gjermane, frënge, polake, maqedonase ...

Prej vitit 2002, punon si Drejtore e Zyrës së Kulturës pranë Bashkisë Shkodër, si dhe lektore pranë Katedrës Albanologjike të Fakulteti Filologjik në Universitetin e Beogradit.

kisha dashtë
vijën e purpurt
të qiellit
me e kalue nëpër fyt
e ma n`zemër
e ma n`krye
me i pështjellue
ujnat e përshkënditun
të kupës yjelëshue...
për ata që gjallojnë
(prej) heshtjeje
ditët janë
aromash e trishtimi

s`dihet çka asht e ujit
shpija mbetun mes gurësh
mugullimi i lëmyshkët
sytë e përmytun
janë
sende t`kafkullta uji
ankthi i bregut
thirrma e pulbardhave
hana e pathyeme
që zhvoshket veçse mbi gjak
cirka fjalësh t`langëzueme
n`gojë
ama e rrushit të shkelun me kambë
trup i shtypun me taft
ndër gra soset gjithshkafja
frymë
e vena mbërthyese
që rrëzohet në fund të barkut
çka përhumbet cijatje grash
çikërrima zogjsh shkapetje uji
ndër shkambije përmbas dallge
za fryme za tingulli s`dihet
ujana asht e mefshët e asgja s`thotë
për ishuj dhembjen që del nesh
e rrethon me tokë

ka me kenë mars
e bari ka me shndritë
ndër fije të lidhuna shiu
deri t`kryhet vezullimi
ka me u ba natë
për me dalë kryepështjellun
n`mjegull shtjellë humbimi
ballit me i lëshue andrra
përpos shtrojes së mbrame
me u këputë pendazhgulun
n`ndoj shtroje flijimi...
prej uji asgja s`vjen
heshtja na i heqë sytë
e nuk na len me pa
si rrëshqitet n`bar
kur don me kalue n`mars
e shtegu për atje
të ndih për kah Qielli
të ligë t`plas përtokë
tue të shti djegën
veç për ndoj Njeri

ksisoj asht dimni ma mirë nuk mundet
do t'ftohët shkula prej s'nalti qet
t'shtihet se gjithçka shtyhet edhe pemët
përpos pezmit erë e ndërkryeme n'liqe`...
"liqe` e erë" pështjellohet ndër ne
krejt ajri asht venë dhimbë shtaze asht
fryma lëshuese e burrit n`za ankues ndesh
kalamendjen ndër sende shëndritëse la...
kisha dashtë kso gjaje me m` tërbue vdekja
aty e marr ngujue krejt çka s`hahet
atë frymë lëshuese hurbi n`mushkëni t`hueja
ksi kohe ashtë dimni e ma mirë nuk bahet...
koha asht ajri që s`na len me pritë
shujta e qiellit që lidhun mban terret
prej lande t` zezë asht gjaku blirues
fije e trishtueme e sendeve

si plaset toka mjeseve herët kur drita asht në t`lindun
liqeni sjell veç mjegull e pemët pemët vishen e vishen
me frymë t`këndelluna e t`këndelluna
që kishin me këndue mos të ishte agim
tash sall frymë janë e frymë marrin
që kishin me dashtë sy mos të ishte agim
tash sall mushkëni t`ruajtuna n`dhë
ngjeshen drujve e barit lëshohen përpjetë
s`kanë qiell as tokë as agim shëlbimin
që kishte me qenë edhe sy edhe za
mos të ishte agim avujsh n'liqe`
çahet toka mjeseve herët
kur drita asht n`vezë e shpendi asht dihatje
agimit n`atë t`thyeme kohe
kur mundesh me gjetë shëlbim





Indrek HIRV (ESTONIA)

Indrek Hirv (u lind më 1956) është poet i vërtetë. Kjo dëshmohet me faktin që Hirv ndien që poezia është e vetmja mënyrë për të hyrë në kontakt me botën. Ka punuar edhe me qeramikë dhe ka filluar të ekspozonte punën e tij para më shumë se 12 vjetësh, por Hirv njihet më mirë si poet – si virtuoz.

Në skenën bashkëkohore letrare në Estoni, ku fjala mund të përfaqësojë mbajtësin e mesazhit, por në shumicën e rasteve fjala dhe mbajtësi i tij nuk janë të lidhur në mënyrë të pashkëputshme, Hirv është një përjashtim i rrallë. Mund të akuzohet që kapet pas traditës dhe ka prirje për manerizmin, por kjo nuk do të merrte parasysh faktin që poezia e Hirvit është qëllimisht dhe thellësisht e gërshetuar me poezinë europiane. Ai është një degë e brishtë dhe elastike e një peme të fuqishme, që është rritur nga filizat gërshetuese të Homerit dhe Solomonit. Hirv nuk ka fshehur kurrë këtë fakt duke plotësuar përmbledhjet e tij të poezisë me përkthime të poezisë nga François Villon, Charles Baudelaire, Arthur Rimbaud etj.

Vëmendja e jashtëzakonshme e Hirvit për teknikën e vargut, theksi i përkryer i rrokjes dhe rima kanë tërhequr edhe një lloj tjetër kritike – që përsosmëria e tij estetike shoqërohet nga errësira etike ose mungesa e plotë e etikës. Por bukuria a duhet gjithmonë të mbajë një mesazh me qartësi skulpturore? Vargu elegant i Hirvit rrezaton një mall dhe melankoli të rrallë, që nuk i drejtohet intelektit, por intuitës. Fjalët e Hirvit nuk i drejtohen as kohës as historisë. Udhëtimi i poetit filloi në vitin 1987 me përmbledhjen *Uneraev* (Zemërim ëndrre) dhe vazhdoi me një rrymë impresionuese librash, prej të cilëve i afrohet më shumë përkryerjes hirtiane ndoshta *Tähekerjus* (Lypësi i yllit, 1993). Poezitë e Hirvit mund të lëviznin lehtë nga njëri libër në tjetrin, sepse përmbledhje të reja përmbajnë zakonisht poezi të vjetra si dhe të reja.

Ndonëse vepra e Hirvit ka ndikuar një brez të tërë dhe ka gjeneruar më shumë se një trashëgimtar, në fund të viteve 1990, poezia e tij dukej të gufonte prapa njëfarë dige – formës i duhej risi, mesazhit i duhej sqarim. Një depërtim i papritur erdhi së fundi me përmbledhjen *Liblikate õhkkeerge veri* (Gjaku i fluturave i lehtë si ajri, 2001), që paraqet një Hirv të ri dhe të pamësuar. Rima është pakësuar në këtë përmbledhje, dhe mesazhi bëhet nganjëherë me aforizma. Mbeten malli dhe dashuria abstrakte, por megjithatë dhëse.

POEZI

*[nga: Surmapōletaja (Djegësi i vdekjes).
Tallinn 2006]*

bisha e muzgut më rrëfeu të vërtetën
që para vdekjeve të mia të para
qepeni i fëmijërisë tepër të bukur u hap një të çarë
dhe brava e mistereve nën urën e engjëjve
ra nga foleja e korbave

rrënojat nën retë gllabërojnë zogj papushim

një pëllumb i bardhë i çelur fluturon mbi vendin
e engjëjve
heziton për një çast
dhe zhduket në terrin e mureve duke shkelur sytë

*

ndokush hyri në heshtjen e madhe
edhe para mbarimit të tij
shpirti i lodhur nga gjërat e përditshme -
nuk thotë gjë

nëse goja hapet për një çast, vjen fjala
si nga një gjuhë tjetër
dhe me tinguj të çuditshëm
ngelet në kujtesë

*

di që ndërsa qiejt e fëmijërisë
janë mbuluar nga gargulli i mosbesimit
nga burgu i maktheve të mia
nuk arratiset asnjë zog

jeleku prej kadifeje i hënës
plot vrimave plumbash që ndriçojnë
fsheh ndoshta një trup të qelbur
nga e qeshura e diellit

kur e vërteta në pasqyrën e shtrembëruar nga hakmarrja
pasqyrohet si gënjeshtër
atëherë më e majta
prej dy duarve i zgjidh prangat

*

veshja e kësulës qesharake të pasionit tim
ka një vrimë – lidhja ime e fundit me botën
nga shikon nganjëherë vjedhurazi i vetmi skeleti im -
kështu e takoj syrin sy me sy

e ka shikimin të trishtuar – dhe thuajse nuk kam përgjigje -
jam kërpaç përballë artit të tij të madh
por shqetësimi është i madh – aq i madh por a pyet
vallë për këtë -
si shqetësimi i të birit të zotit në ullishtë

një vëlla është në qiell – ushtar i pajtuar ose shigjetar-
e shoh – fytyra e tij zbehet kur agon dita -
dhe mbi renë e trëndafiltë mërzitët bariu i mirë -
këndon gjeli – dhe miku e mohon mikun

*

Gjithë friggjediteti yt frikësues
do të mblidhet ndonjë ditë
në pejsazhet hënore të retinës sate me ngjyrimë
drite
për t'u ndezur

Shkëndija fluturuese si rruazat e kuqe të gjakut
do të rrahin kundër lenteve të syve të tua
derisa të thyhen këmbana të mëdha qelqi
dhe një shpërthim i aromës së dashurisë
pluskon brenda nëpër iridat e tua të çara në ashkla

Qindra gojë do të hapen
në mjegullat e buta të reve
fryma e tyre do të përzihet
me freskinë tënde pa erë
në shkëlqimin e zjarrit të madh
dhe qielli i flaktë xixëllues
do të të pëshpërisë fjalën e parë
të Librit të Pashkurtuar të Vetëmashtrimit

*Në anglisht nga George Kurman, nga anglishtja në shqip
nga Silke Liria Blumbach*

(Pöueoda) 1990

me ullinj thellë në xhepin tim të mesdimrit
unë fle gjumë ditën – qëndroj i zgjuar natën
një mështekën në shpirt – në shtëpi jam hardhi
në paqe dhe në shpejtësi – në të njëjtën kohë

ullinj thellë në xhepin tim të mesdimrit
mendja ime endet – çelik dhe xham përreth
ua vë veshin të vdekurve – me urdhrin e tyre
mbjell këmbët e mia vendosmërisht këtu në dhe
amëtar

(nga përllhall, f.64)

*Në anglisht nga Miriam McIlfatrick, nga anglishtja në
shqip nga Silke Liria Blumbach*



Sabit GECAJ (KOSOVE)

U lind më vitin 1962 në Mitrovicë të Kosovës. Shkolimin fillor dhe atë të mesëm i kreu në Mitrovicë dhe Skënderaj. Në Fakultetin e Filologjisë të Univesitetit të Prishtinës studioi Filozofinë dhe Sociologjinë. Gjatë studimeve shkroi për gazetën e studentëve "Bota e re". Më 1993 punoi si redaktor i revistës politike e kulturore

"Zëri" të Prishtinës, botimi për Evropë. Në të përditëshmën "Bota sot", punoi si redaktor për kulturë dhe qe bashkëpuntorë i revistës për kulturë "Fjala" të Prishtinës deri sa botohej. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Zvicrës dhe redaktor në shtëpinë botuese "AIKD" të Prishtinës.

Gecaj shkruan poezi, prozë dhe publicistikë kulturore. Është përzgjedhur në shumë antologji të poezisë shqipe, angleze, gjermane dhe rumune. Është shpërblyer me çmime të ndryshme letrare dhe është përkthyer në disa gjuhë të huaja, si në anglisht, gjermanisht dhe rumanisht. Deri me tani ka botuar dy përmbledhje me poezi. "Hijet e shiut" më 1998 nga shtëpia botuese "Rilindja" dhe "Në shtëpi shi" më 2006 nga "AIKD" e Prishtinës. Ai aktualisht jeton në Zvicër.

SHKUPI

me Arbërin në pritje
nën një qiell ëndërrues
sipër nesh jetohej
përball një AtDhe
pas nesh një tjetër

në histori tretjet e shterret
një vegim përrallash gjyshërisht

AtDheu ynë është krejt afër na mban pezull
futurimi ynë i përditshëm e prek atë në buzë
na dhemb pse rri në gjemba nate?

e ëndërrojme në çdo kohë
kur është mjegull
nuk shihet fillimi as fundi I rrugës sonë

koha përmbys çdo pasqyrë
kur qahet në buzët tona stuhia
gjaku ynë nuk pihet as për ilaç

buzëqeshim shqip
Shkupi ynë ridhet në zemër puthet Arbëria...

PEMA IME

një natë shiu në mua
buzëqeshja e vjedhur e stinës në ajër
rri varur koha

në heshtjen e idhujve thyhen perënditë e fluturave
pse shkruaj askush nuk e di pse flas me ngjyrat
pikturat pse më shikojnë vdekshëm flasin tinez

askush nuk e di

pse buzëkuqet nuk ma ndalin dhembjen
në asnjë shtrat
nuk vjen gjumi i vrarë buzëqeshja e hekurosur
është sall hije druri pa yje e ngjyrë

veç sonte je yll që nuk shndrit në hije pemësh
je kënga ime pa fund
melodia e heshtur e zemrës pafjetur
je era që kërkon dashuri në puthje njerëzish

koha na dhuron vdekje ëndrrash...

nga pema ime
asgjë veç mjegullës nuk shihet veç kohës
në shpirt frymëmarrja ngjyrë gri
gishtrinjët rrëshqasin mbi flokët tu rrjedh shiu
i drunjve lëkura ime digjet

heshtjen ta ndjej e bien gjethet e pemës
në ty zbadh vetëvritet në fluturim floku i shprishur
flen në plagë zgjohem e rriten në ty gjeth i syve
i ri jeta!

TREGIM FANTASTIK

shpirti
nuk hesht kurrë
as qielli nuk e sheh syrin kur bie te fle

buzët tua shtrihen mbi gjumë zgjuar

ti dhe zemra jeni të pavdekshme
flokut yt është hënë e kësaj stine resh

toka e mat zemrën tonë me hije
njerëzit ëndrrat e tyre i thurin për Zotin tonë
gjumi shkundet në përplasje thonjsh

diçka e shtrenjtë vdes bukur
në atmosferë sillet ajër i rëndë jeta dashuria

sonte
askush nuk u beson tregimeve fantastike as ty
se nuk je më e rëndë se shkrumbi i buzëve tua
as unë nuk jam më larg se dielli yt

sipër nesh qielli i zogut të zi...





Kristian GUTTESEN (ISLANDE)

Kristian Guttesen u lind më 1974. Është autor i shtatë librave me poezi. Librin e parë Fantazma e ka botuar më vitin 1995. Më pas botoi vëllimin Poezi hije (1998), Anno (1999), Ferrëgjatë (2003), Protestë nëpërmjet pjesëmarrjes (2004) etj.

Më vitin 2007, për përkthimin e romanit norvegjez Kodra (Skråninga, nga Carl-Frode Tiller) u nominua me Çmimin Islandez të Përkthimit. Momentalisht studion filozofi ne Universitetin e Islandës.

KRIMI NUMËR NËNTË

më kanë quajtur vjedhës dhe hajdut
kokë e kalbur ata qese llumi thonë poezitë e mia
janë keqdashëse dhe më akuzojnë për goditje
të pabazuara kundër qenieve inteligjente

a e di se ç'do të shkaktonte kjo?

diku në natë gjendet i shtrirë një poet që vdes
poezitë e të cilit e vrasin veten

brenga banon në butësinë e
syve të tu s'duhet të themi lamtumirë ashtu

bëhem rrugaç që të mund të mbijetoj si
poet dhe ia shpall luftën
vëllazërisë

vëllai im vrasësi pasi
u shtrive pranë meje dhe kap frymëmarrjen tënde unë
shpohem tejpërtej dhe ngul sytë ndoshta diku në
errësirën e skëtërrshme

ajo që mbetet nga jeta përparon
edhe një çast dhe kurse ti më vret
i pikëlluar mendoj që brenga banon në butësinë
e syve të tu s'duhet të themi lamtumirë ashtu

ESSE EST PERCIPI

Erëra
 i pamë
 qetë
 shkojmë

Erëra nisen për fluturimin...
 zhyten në ujë
 dikur tërbonte
 lufta bërthamore këtu në Tokë

Ka shumë kohë që e pamë njëri-tjetrin...
 esse est percipi
 unë jam një murg
 vëlla
 unë jam një baba

Udhëtim mbi liqene të qeta...
 unë e shoh në një dhomë të gjelbër
 përpiqem t'ia përshkruaj asaj
 këto dy bota që njohim

Kudo që shkojmë
 këto tri rezultate
 që mund të kishin qenë
 që kanë ndodhur secili...

Fetusi i lindur i vdekur
 vajza që jetoj
 vajza që u vra

si tri vijë në qiellin e natës
 të zi si katran

Erëra nisen për fluturimin
 ka shumë kohë që e pamë njëri-tjetrin
 udhëtim mbi liqene të qeta
 kudo që shkojmë

NJËBRIRËSHI

A dëshiron që të besoj sot në
vegimtarë të largët?
Është aq më e lehtë të
ma shesësh Krishtin.
Mund të fitoj një kuptim të një qenie
më të lartë, ekzistoftë apo jo.
Gjithçka që është objekt i
mendjes sonë:

Perceptime,
ndjesi,
shfaqje -
(ose diçka të ngjashme)

Ti thua që ajo që është në mes
të mendjes sonë, është ajo që ne mund
ta kuptojmë.

Ne nuk jemi vërtet të vetëdijshëm për diçka tjetër.

A dëshiron që ta shes
sot emrin tim?
Është për shitje, por ty të duhen
mori të asaj që ti vetë e di.

Unë jam njëbrirësh
i përbërë nga ideja dhe perceptimi.
Një përgjigje ndaj asaj
për të cilën më ke detyruar.

Po ç'është atëherë kjo dhembje?

Më pëlqen të dhunohem.

*nga Kristian Guttesen
përkthim nga danishtja në anglisht nga Jane Appleton,
nga anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach*





**Margus LATTIK
MATHURA
(ESTONI)**

Mathura (ose Margus Lattik) u lind në vitin 1973 në Tallinn, Estoni. Ka diplomën për filologji angleze nga Universiteti Tartu, ndonëse pseudonimi i tij letrar rrjedh nga interesi i tij i zgjatur për Lindjen. U paraqit në skenën letrare estoneze në fund të viteve 1990 bashkë me grupin letrar Erakkond (Shoqata e oshënarëve) dhe prej kësaj kohe ka botuar gjashtë përmbledhje me poezi. Poezia e tij frymëzohet nga një mori subjektesh dhe vendesh gjeografike; karakterizohet nga një përzgjedhje e mprehtë fjalësh dhe nga ndjeshmëri dhe është shpesh shprehja e një gjendjeje të veçantë shpirtërore ose një mënyrë ekzistence në vend të një shpërthimi emocionesh. Për këtë arsye poezia e tij është krahasuar nganjëherë me atë të Jaan Kaplinski, njërit nga poetët estonezë bashkëkohorë më të shquar. Në vitet e fundit, Mathura ka shkruar edhe shumë kritika dhe artikuj për filmin, letërsinë dhe kulturën dhe ka botuar një ese për piktorin francez Paul Gauguin. Mathura është edhe piktor dhe ka mbajtur ekspozita në galeri të ndryshme në Estoni. Më 2004 mori Çmimin Vjetor Rajonal të Ndihmës Kulturore të Estonisë dhe u nominua për disa çmime të tjera. Poezitë e tij u përkthyen në gjashtë gjuhë të tjera, dhe ai vetë ka përkthyer poezi nga anglishtja dhe indishtja.

NOSTALGJI

për Andrej Tarkovskin

mëmëdhe
lundra ime e prishur
kërkoj dritë
por vetëm të gjej ty
fusha me gurë
baltë të kuqe
një pemishtë bliri
si një gji plot me qumësht
erëmirë dhe lulëzues
më mban në prehrin e saj
ky çast
qenka ky çast
fëmija im blete
erëmirë dhe i lulëzuar
do të bëhesh një pranverë

dhe përgjatë rrugëve zhuritjeje
ta takosh errësirën
në një vend të largët
mor i dashur
nuk do të jesh
dëshmori im i përgjakur atje
do të jesh diçka tjetër
se flaka e një qiriu të bardhë
të jesh i sigurtë

por malli
brenda vetes sate
për të cilin të flasin
nuk ishte kurrë i vërtetë
dhe ne të gjithë dimë
se ç'mendon
por asnjëri prej nesh
s'ndien kurrë se
në të vërtetë
ne jemi
një shenjë e kohës
ne të gjithë jemi
koha
është gjithçka
dhe ne nuk kemi
kohë
prandaj
besojmë

në mosbesim
më shumë
se në veten tonë

GJIRI I BARDHË I DETIT

Era e kripës,
ngjyrat e shqisave që lodhin.
Hiqe më afrohen shpejt,
por po aq shpejt do të ikin.
Çfarëdo do të vë solemnisht
në rërën e bardhë gri,
shpëlahet ose fshihet
dhe do të jetë prishur
në dritën e parë të së nesërmes.

Llojeve të dashurisë
që kërkoj tani

atëherë do t'u mungojë kuptimi,
do t'u jetë humbur fuqia,
trupat tanë nuk pajtohen më
nga prekja dikur aq e butë
e shpirtit.

Vetëm rrjetet e peshkimit mbeten
të pandryshuara,
por rrjete peshkimi
për të zënë barra
jete të qetë dhe të ëmbël;
petalet e ferrëbardhave
mbeten në bregdet,
me ngjyrën vjollce të shpërndarë
nëpër tokë të shqyer
dhe lozonjare.

“Ç'bëhet nga e tëra
kur vrapon drejt një jete të mirë
që ne s'do ta përmirësojmë?”

*

Trungje aromatike dëllinje
poshtë strehëve me çati kallami
një kopsht plot zogj
dhe gështenja në lulëzim
një dritë e madhe e çelur
grumbullohet në majat e tyre
kur unë jam e shtrirë në dhe e shikoj
lart,
lart...

Në mbrëmje jam
përsëri bari i qiellit më të errët
Pres një ditë
të re dhe qartësi.
Para se të fle,
dielli duket befaz në flakërim
në retë e hirta.

Çdokush mbetet lakuriq
për një çast
para vetes.





Mohd MIGDADY (JORDANI)

Mohamad Ali Migdady u lind më vitin 1952 në Jordan. Është doktor për Ekonomi ndërkombëtare (SHBA) dhe Profesor në "Pacifik Western University" (SHBA). Është anëtar i Lidhjes së Përgjithshme Arabe të Shkrimtarëve dhe ka qenë sekretar i përgjithshëm i Shoqatës Jordaneze të Shkrimtarëve, Amman, Jordani 2005-2007,

kryetar i Shoqatës Jordaneze të Shkrimtarëve, Irbid, Jordani 2002-2006,

Kryetar i Shkrimtarëve Arabë Interneti – Jordani – 2006-2007.

Ka botuar 14 përmbledhje me poezi (Amman-Beirut-Damask) dhe tre libra për politikë dhe çështje ndërkombëtare. Është i lidhur me disa konferenca dhe festivale kombëtare arabe dhe ndërkombëtare

Shkruan për disa revista dhe gazeta në vende arabe.

(1)

E dashura ime,
Fle çdo natë
E qetë dhe paqësisht
Sepse
Ia ruaj sytë
Kundër vjedhësve dhe dashnorëve
Çohem si qiri pranë shtratit të saj
Duke u shkrirë... pikë pas pike
Mbi qerpiqët e saj
Ndonëse
Njoh përfundimin tim
Por insistoј të vazhdoј
Duke u venitur nga kënaqësia
Sepse duhet gjithmonë të shoh
Lule që lulëzojnë
Zogj që fluturojnë
Dhe të dashurën time
Që fle çdo natë
Në follenë e saj të gjelbër
E qetë dhe paqësisht

(2)

Asgjë më shumë do të humbet
 Se kur këngëtari humb zërin e tij!
 Dhe
 Kur trëndafili humbet
 Sikur të mos kishte më aromë!
 Dhe
 Drita... sikur të zhdukej dielli
 Ose të zhytej hëna
 Matanë reve të zeza
 Asgjë nuk do të humbet
 Në të dyja rastet...
 Në qoftë se ti vjen shpejt
 Ose...
 Në mungesë përgjithmonë!
 Prandaj nuk kam më pemë të egra
 Në fushat e mia të shkreta!
 Vetëm atë që posedoj
 Barëra të thatë dhe të dobët
 Që zvarriten mbi gjoksin tim të lodhur...!
 Kështu
 Shkretëtira nuk do të humbë gjë
 Edhe pse
 Perronj thahen
 Ose lumenj të çmendur
 Rrjedhin lart në qiell

(3)

Në mëngjes, herët
 Ne të dy do të pimë kafën tonë bashkë
 Do të ndezim dritat e agimit bashkë
 Do t'i gjuajmë ëndrrat
 E arratisura nga lutjet mbrëmë
 Dhe pastaj
 Secili do të kthehet mbrapa
 Nëpër rrugët e gjarpëruara
 Deri në vetminë e vet të thartë
 Me duar të zbrazëta
 Zemër të mbyllur
 Shpresa të plagosura
 Dhe habi të gjerë!!
 Asgjë për t'u zbuluar
 Por
 Një vijë e imtë skuqjeje
 gjendej në hirin e buzëve tona!!



Vehbi MIFTARI (KOSOVË)

Vehbi Miftari u lind më vitin 1971, në Dumnice të Vushtrrisë (Kosovë). Në vitin 2005 mbrojti temën e magjistraturës *Format dhe metodat e kritikës letrare – Konica, Maloki, Kuteli*, në Univesitetin e Prishtinës, ndërsa po ate vit iu lejua tema e doktoranturës: *Kritika letrare shqipe dhe moderniteti (Rrethi e individualiteti)*

në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Prishtinës. Ka kryer edhe disa specializime, në Itali, Austri, në Univesitetin Amerikan në Bullgari etj. Ka punuar si gazetar e redaktor në të përditshmet "Kosova sot", "Zëri" dhe "Bota sot", si dhe kryeredaktor i revistës për kulturë, art e letërsi "Fjala". Ka udhëhequr Sektorin e Bibliotekave dhe të Botimeve në Ministrinë e Kulturës të Kosovës, si dhe ka qenë ndihmës drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Prej dy vitesh është mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë (Dega e Gazetarisë) të Universitetit të Prishtinës, si dhe zëdhënës i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Flet rrjedhshëm disa gjuhë të huaja: anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht dhe serbokroatisht.

Deri tani ka botuar 12 libra autorialë, poezi, studime, kritikë letrare, publicistikë dhe bibliotekari, si dhe dy libra të përkthyer të autorit Umberto Eco, si dhe qindra artikuj për letërsinë dhe kulturën e identitetin shqiptar.

Ka botuar Mëngjes në pasqyrë- poezi, „Forum i krijesve të artit“, Prishtinë, 1995. Figura në rërë- poezi, „Rozafa“, Prishtinë, 2000. Teoria e objektit- teori dhe kritikë, „AIKD“, Prishtinë, 2001. Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata, BKUK, Prishtinë, 2004. Modeli kritik - Konica, Maloki, Kuteli, studim, „Buzuku“, Prishtinë, 2005. Libri i mallit (Poezia e Ernest Koliqit), studim, „Buzuku“, Prishtinë, 2005. Etika politike dhe Kosova (publicistikë), AIKD, Prishtinë, 2006. Maloki: Fryma nacionale në letërsi, „Shpresa“, Prishtinë, 2006. Rugova: Vizioni nacional, „AIKD“, 2007. Kritika e tekstit (Arshi Pipa), „Buzuku“, 2007. Muret nuk mjaftojnë, „Buzuku“, Prishtinë, 2008. Rugova: The symbol of independence, „AIKD“, Prishtinë, 2008.

SPROVA E PARË E ARTISTIT

derisa artisti e kryente sprovën e parë:

ia vinte zjarrin kasolles

për të provuar "efektin e shkrepës"

iu dëftua përjetësia: ofshama eposore e oqeanit

zhaurima e valëve duke u plakur në një enë të bakërt
dhe shtrati i akullt në një bregore

thonë
atë natë i ndërroi fytyra dhe gjithë ç'kishte:
sikur gruas që i pikë gjiri duke pritur në stacion
t'ia kthejnë të birin që ia morën ushtar

"e ndodhura është mungesë
ekziston një qëllim: sprovë për të papranishmen"

duke i kapërcyer nga dy shkallë përnjëherësh
ose duke i rrëzuar mështeknat nga sytë
përnjëherësh u shndërrua në zog të qiellit
që i përket vetmia dhe gjithë hapësira përreth

pastaj u ndal para hirit të shprishur të kasolles:
"ç'vepër e përkryer sprovë e njeriut!"

e hiri farfurinte në hapësirat e zbrazëta:
përreth kokave të tyre i krijonte unazat,
gërvishtjet dhe pasqyrat
dhe e shenjonte datën e sprovës së ardhshme

artisti do të kthehet rishtas në gjol
dhe do të bëjë sprovën:

numërimin e unazave të krijuara
nga largësia mes kokave dhe trupave të tyre

NË TEATËR

në fillim që ëndrra
pastaj ajo iu dëftua si zhaurimë uji
duke u derdhur e plakur nëpër shkëmbinj:

vehbiu shtrirë në një qoshe të skenës

drita verbuese e reflektorëve prozhmues
i depërton nëpër bebëzat e gurta
djegien ia kujton ferrin

"pas murit shkëlqyes të dritës duhet të jenë shikuesit
mëtonjësit e kleoptarës sime me gjinj qumështorë"

shikuesit e mi!

vrasësit e ndjenjave që më kujtojnë për fije kashte
e cila mund të ndizet çdo sekondë

kanë paguar me para (ku t'i kenë fituar se?)
dhe duan të shohin metamorfozën time në një insekt

tashmë çdo gjë ishte e gatshme për lojë
mbreti (mbreti?!) që duartrokiste pavetëdijsëm,
aktorët në skenë ponc pilati me rojet përreth

shikuesit që kërkonin zgjimin tim në një yll prej letre
ose vrasjen me gurë

qielli kaltërosh dhe dëshira ime për kryq

nuk di nëse e thashë
ose qenë aq të hollë sa e kuptuan vetiu

por sakaq
përdezja e tyre u shndërrua në urrejtje të mnershme
që m'i lidhi duar e këmbë e ije

pastaj
më gozhduan dhe më vunë në kryq

ç'privilegj: mbi kokat e tyre
ku ata nuk mund të shihnin më
e shpalosja kaltërsinë e qiellit lirinë time e të tyren

nga ëndrra më zgjoi currili i gjakut
që shpërvilej nëpër llërën e dorës së majtë
dhe m'i shëronte plagët

thonë
krejt rastësisht u gjenda në mes të skenës
gozhduar mbi kryq

ndonjëri nga ju mund ta zërë qoshen time
vendin tim nën hijen e aktorëve zulmëmëdhenj

derisa t'ju shpiejnë nën rrezet e para të diellit

SHKALLËT E SHTËPISË FSHEHIN DIÇKA NGA UNË

njëmijë vjet më parë ose pikërisht në ditën e sotme
u vërtetua profecia: më përpinë shkallët e shtëpisë

në atë kohë ashtu si sot
qe krijuar legjenda për muret dhe shkallët e shtëpisë
për ujkun mbi çati dhe për gjarprin me zile

e unë isha i sigurt se dikush banonte në mua

ecja rrugëve plot pluhur pa asnjë lule përreth
ku qindra ujë më shponin me vështirm
i frikohesha vetëm çastit kur duhej të mbërrija në shtëpi

në shkallë errësira mund ta fshehë katullaqë gjarprin

merimanga në qoshe të mureve
grafite kërcënuese dhe maska të zeza
të parapaguara një mijë vjet më parë

edhe sot pas një mijë vjetësh
kam frikë t'ua kthej fjalën shkallëve të shtëpisë
macet e zeza mund të jenë fshehur në njëllë gjaku

thonë ende ekziston një kënd i errët në tokë
shkallët e shtëpisë ende e ruajnë kujtimin
për vrasësit me pagesë

LIGJËRATË PARA FËMIJËVE GJAKOVARË

ju i keni ngulur sytë në mua
dhe më vështroni si belbëzoj para jush
se si edhe unë mund të isha njëri nga ta

mos u besoni fytyrave që shëmbëllejnë me pasqyrat
gërvishtjet nuk janë dhimbë e përjetshme

çkado që ju them është sharrë në asht
shembëlltyrë e ëndrrës që nuk do të duhej ta shihnit

sepse një herë moti i keni besuar pasqyrës
që ua ripërtërinte vazhdimisht fytyrën

ëndrrat s'mund ta shndërrojnë realitetin në parajsë

prandaj mos e kërkoni hirin në shkallët e drunjtja
që i mori me vete era

të dashurit e mi

parajsa është gjëgjëzë e madhe
që na përcjell deri në vdekje

unë jam para jush
dhe ju e besoni këtë

e pikërisht këtu lind mashtrimi

unë s'jam veçse pagjumësia juaj
që noton nëpër mjegull





Esteban MOORE (ARGJENTINE)

Esteban Moore u lind në Buenos Aires më 1952. Është poet dhe përkthyes. Momentalisht koordinon koleksionin Poetë bashkëkohorë argjentinas nga Fondi Kombëtar i Arteve. Si kronist qyteti ka bërë të njohura: Librari me vlerë trashëgimie në Buenos Aires (Drejtoria e Trashëgimisë, Sekretaria e Kulturës e Administratës së Qytetit

Buenos Aires, Buenos Aires, dhjetor 2003) dhe së fundi Piceri me vlerë trashëgimie në Buenos Aires, (Ministria e Kulturës e Qytetit Buenos Aires, Buenos Aires, qershor 2006);

Në poezi ka botuar: Nata në flaka (1982); Providenca tokësore (1983), Me Bogey në Casablanca (1987), Poezi 1982-1987 (1988), Kohët që kalojnë (1994), Fotografi çasti në fundshekullin (Montevideo, 1999, çmim nderi i Çmimit Komunal të Buenos Aires-it), pjesë minimale (Mar del Plata, 1999); Pjesë minimale dhe poezi të tjera (2003, çmimi i dytë i poezisë, Fondi Kombëtar i Arteve); Antologji poetike (2004, Koleksion Poetë bashkëkohorë argjentinas, Fondi Kombëtar i Arteve) dhe Avioni i zi dhe poezi të tjera (2007, Fondi Metropolitan i Arteve dhe Shkencave i qytetit Buenos Aires).

Ka përkthyer disa autorë anglishtfolës në spanjisht: Lawrence Ferlinghetti, Amerika e shkretuar dhe poezi të tjera, Koleksion Vepra reprezentative të UNESCO-s (Ediciones Graffiti/Unesco, Montevideo Uruguay, 1996); James Laughlin, Poezitë e dashurisë, (Editorial Martín, La Pecera, Mar del Plata, Argjentinë, 2001); Craig Czury, Teknologjia veriamerikane dhe poezi të tjera (Papel Tinta Ediciones, Buenos Aires, 2003); Charles Bukowsky, Njëra nga më djegëset dhe poezi të tjera (Ediciones Laberinto, Meksiko, 2004); Lawrence Ferlinghetti, Blues i pjelljes dhe poezi të tjera (Alción Editora Córdoba, Argjentinë, 2005), Lawrence Ferlinghetti, Jeta pa fund (Editorial Arquitrave, Bogotá, Kolombi, 2005), Sam Hamill, Sy shumë të hapur dhe poezi të tjera, (Dirección de Cultura, Universidad de Carabobo, Valencia, Venezuelë, 2006).

Ka përkthyer edhe poetët Joy Harjo, C.K. Stead, Liv Lundberg, Patricia Jabbeh Wesley dhe Chirag Bandel për edicionin e XVII-të të Festivalit të Poezisë në Medellín (2007) dhe për Freedom TV ka përkthyer poetët Nyamubaya, Nguyen Bao Chan, Bassem Al Meraiby, Joe Woods dhe Gulrokhshar Safi; bashkëpunoi edhe me edicionin e XVIII-të të Festivalit të Poezisë në Medellín (2008).

Si eseist ka botuar: Katalogu i parë i revistave kulturore të Argjentinës (Ediciones Revista Cultura, mbështetur nga Sekretaria e Kulturës e Kombit dhe Lidhja e Revistave

Iberoamerikane, Buenos Aires, janar 2001) dhe në revista dhe gazeta ka botuar shkrime për veprën e poetëve Alberto Girri, H.A. Murena, Horacio Salas, Lawrence Ferlinghetti, Allen Ginsberg dhe poezinë argjentinase bashkohore, të përmbledhura në *Versione* dhe përvetësime, për t'u botuar së shpejti.

Ka marrë pjesë në festivalet e poezisë në Medellín, Kolumbi (1995 dhe 2005); Montevideo, Uruguaj (1993); Rosario, Argjentinë (1994), Cali, Kolumbi (2005); Takimi i Shkrimit, Maldonado, Uruguaj (2006 y 2007), Java e letrave dhe leximit (Rosario, Argjentinë 2007), Takimi Ndërkombëtar i Poezisë në Valencia, Venezuelë (2006) dhe u ftua në shkollën e poezisë "The Jack Kerouac School of Disembodied Poetics" të themeluar nga Allen Ginsberg, ku filloi një projekt përkthimi, si dhe në "Schule für Dichtung in Wien", Vienë, Austri, ku ligjëroi për poezi dhe përkthim. Më 2005 udhëhoqi në Shkollën e IX-të të Poezisë në Medellín seminarin: Brezi "Beat" poetikët dhe trashëgimia.

Bashkëpunon me shtëpi botuese në Argjentinë dhe jashtë. Vepra e tij u përkthye pjesërisht në anglisht, italisht, gjermanisht, lituanisht dhe portugalisht dhe u përfshi në antologji të ndryshme.

ENGJËJ TË RËNË

*"qyteti i engjëjve të rënë" / pikturë muri /
Silver Lake / Los Anxhelos*

i dehur tapë
dhe i dëshpëruar
Dylan Thomas e tund natën me ulërimët e tij
Vallejo kollitet në një strehimore në Paris
Nata zgjatet nëpër hemisferat
në Meksikë Lowry
Fsheh vizionet e tij zoologjike
në gjuhët e ashpra mezkali
duke udhëtuar me kërcitjen e një treni mallrash
Kerouac këndon ngjirur të vjella pas të vjellash
virtytet e verës së thartë kalifornike
Bukowski rrëshqitet dhe bie
në kalldrëmin e Bulevardit shkëlqyes të Perëndimit
të Diellit natën
në dhomën e pasme të një farmacie
Carver hap një shishe të fshehur "Jack Daniels"
kurse në banak një plake
me një qenush qesharak
e pret recetën
që do të qetësojë demonët e saj
në këtë orë të natës
ndoshta dikush pyet
ç'po ndodh
ç'po ndodh
në shkëlqimin e lindjes së largët të hënës
në një kafaz të ndriçuar nga prozhektorë
Pound murmurin fjalë
që rojtarët e tij të burgut nuk kuptojnë dot
Michaux nën natën e errët të Cuernavacas
në një varrezë
ngrihet i ngarkuar deri në gushat
pa kuptuar magjinë e pejsazhit
në një qytet që e injoron
Julio Huasi
vendos të verifikojë
përqaftimin e errësirës me një plumb në tru
të tjerë nga goja e një shisheje alkoholi
vënë rrahjen e zemrës së tyre në gjumë
në një vend ku secili këndon bukurinë
e grave që lëkunden bashkë pranë detit
dikush duke buzëqeshur pi kaipiran e vet
duke thithur aromën e errët të sheqerit
perfumin e prishur sqetullash leshtore
aroma e imagjinuar e lules së saj

shije e dëshiruar plotësisht
në këtë çast
nga Montevideo shikojmë
qiellin e ngarkuar
këto motive ndryshuese shtrëngate
nuk kuptojnë se sa miqësore janë dëshirat e tua
shkojnë nga njëri vend në tjetrin
nëpër vargmalet
oqeanet rrafshinat
duke kaluar lindjen
duke gdhirë perëndimin
duke pushtuar këdo
që përpiqet t'u kontrollojë polet magnetike
duke i reduktuar në pyetjet e tyre
të përditshme të mendjengushta obsesive
Perlongher
në ditët e tij të fundit me sidën
udhëton në një makinë
që rrëshqitet
nëpër pjesë të degjeneruara qyteti
vrapoi në një kishëz
ku para altarit
në atë rreth energjie të dhuruar nga Zoti
para syve të qengjit të përgjakur të Zotit
një prift shpërndan shpresë
po dhe çfarë...
cilat fjalë tajit
në zhgënjimin e tij të dëshpëruar
në cilat ujëra ushqen ndreqjen e tij të shpejtë të besimit
Ati ynë...
që je në... lartësitë shumë të shenjta
fillon thirrja e kotë
i vetmi ngushëllimi i tij grykësia e Zotit
në erën matanë lumit
zëra të çuditshme
në lumin nën erën
shpirtra të refuzuar në dhembje
Oscar Wilde në Paris
në varfërinë e mërgimit
nën emrin Sebastian Melmoth
digjet për jetën e tij të kaluar
gruan e tij fëmijët e tij
atë botë në të cilën nuk mund të kthehet
e çuditshme
gati fëmijërore mënyra se si i kujtohet
rrumbullakësia e koleksionit të tij të porcelanit të hollë
ngjyrat e Londrës nën dritë vjeshte
shënon në librin e shënimeve:
Kam qetësinë e objekteve të humbura /

Jam një burrë që ka jetuar kohën e vet /
Në marrëdhënie simbolike me artin /
kurrë më s'do t'i vijë turpi

kur dikush në rrugë

pëshpërit prapa shpinës së tij
ose bërtet
Fingal O'Flahertie ooo oooo oooooohhhhhh
i thotë vetes butësisht në një zë të ulët
dhembja është një çast i zgjatur këmbëngulës
pa menduar kurrë se Joyce do ta thirrte
në Baladën e Persse O'Reilly-t
Fingal Mac Oskar Onesin Bargears Bonifac
kë do ta marrë mendja ndonjëherë për dikë të quajtur
Bythë-aq-e-madhe-sa-maunë Nën një fytyrë të bukur
projektimi gjeometrik hijesh
vazhdon
kush apo çfarë gërryen mbështjelljen e forcës
gdhend në histori
shenjët e virgjërisë së të tjerëve
a i kujtohet dikujt
eklipsi i hënës së Lu Tungut
perandorit që përfaqëson qiellin
shikimi i syve të tij
që zbehen në bukuri tokësore
hëna syri i natës i qiellit
e përparë nga goja e llahtarshme e diellit
dhe ç'mund të themi për të tmerrshmin
ekzekutim të këtij poeti që donte alegori
në vitin e 835-të të Zotit tonë
a s'ke gjë për t'u thënë
pyet një zë i huaj
motivet e shtrëngatës rrotullohen tani mbi boshtin e tyre
dritat e para të agimit
depërtojnë rrudha të thella të greminës
imazhet verbuese
përsëriten
prapë e prapë
në sipërfaqen e lustruar
ç'të thonë në Meksikë
në Buenos Aires në lagjen Wilkes
që nuk u këndua më parë në perëndim
në Venezuelë në Brazilin e rritur tepër
në lindjen e vdekur të humbur
ku magjistarët
shikojnë në firmament
për shkak të trajektores ndriçuese të një ylli
që do t'i derdhë kokrrat
Auden në mbrëmjen e Vitit të Ri

propozon një doli
 e ngre gotën duke thënë:
 në aromën e thartë të alkoholit
 mbaj peshën e planeteve
 ndryshueshmërinë e planeteve
 mos kërkonti në të kaluarën
 parajsa iluzore
 edhe më pak kërkonti fuqitë që janë
 siguria e hierarkisë
 shekulli do të na paraqesë
 rrënojat që imagjinuam
 Rimbaud do të zvarrisë gangrenën e tij të artë
 trupi i Alejandrës
 buzët e saj të errëta prej gjaku të qetë
 kurrë s'do t'ia mbyll gojën fjalës së fundit

MINIMA NATURAE 1-5

“strahlenwind deiner sprache” 1

era që fryn --- nga shkretëtira e kristaltë - aq
 e butë – sa një qiell i lëmuar – do të shpallë
 nga universi
 gjeometri të pakufi --- të panjohura / detajet
 më të vogla
 sundimet e një shkëlqimi të shtuar

“not things but minds” 2

akullnajat në Patagoninë e largët shtynë /
 madhësinë
 - e korpusit të tyre të mbledhur / ----- duke rikrijuar
 poshtë madhësinë e formave masive / dhe
 muzikën e ujërave

“confondant la nuit et le jour” 3

natyra e qyteteve / që shpalosen në
 rrafshinat e shkreta – ventilatorët e tyre qarkore /
 -- nuk
 do t'u përgjigjet kurrë -- vibracioni
 intim i zjarrit / - që rrezatohet - nga
 ky hi i kalcifikuar

“piedra como tú” 4

ky gur metali i fëlliqur / - me madhësinë e një

kumbulle nga Alto Valle
 që ndan me shkëmbin gri dhe shkurret e thata - /
 rërën e
 këtij terreni të shpërndarë në largësi para syve
 të tu - / nuk do të
 kujtojë zanafillën e tij --- - por kur goja jote shqipton
 fjalën meteor – do të shkrepet – nga plasat e thella
 --- të
 zërit tënd – yllësi të shumta

Alto Valle. Një luginë në Rio Negro, Patagoni.

“Aquí en el silencio, / oigo” 5

një fllad nate / fshin --- - nëpër fushat e pluguara
 trazon – gjethet e eukaliptit, gjethnajën e pasur të
 shkopinjve të bambusë / zëri i tyrë valësh -- fërkon
 butë rrotat e mëdha
 të traktorit të palëvizur

Të dhëna:

1-“strahlenwind deiner sprache” (era rrezesh e gjuhës sate) Paul
 Celan- Sprachgitter, 1959.

2-“Not things but minds” (jo gjëra, por mendje) John Cage,
 Themes & Variations, 1982.


3-“confondant la nuit et le jour” (duke ngatërruar natën e ditën)
 Jules Superville.

4- “Piedra como tú” (gur si ti) Leon Felipe

5- “Aquí en el silencio, oigo” (këtu në heshtje dëgjoj) Eugenio
 Guasta

Përktheu nga spanjishtja në anglisht Craig Czury,
 në shqip Silke Liria Blumbach





**Giuseppe
NAPOLITANO**
(ITALI)

Xhuzepe Napolitano u lind në Minturino (Itali) në vitin 1949. Tani jeton në Formia dhe punon si operator kulturor; gjithashtu, ka themeluar një koleksion libërthash: "La stanza del poeta" ("Dhoma e poetit"), kolanë në të cilën janë botuar në botime bilingue shumë poetë mesdhetarë.

Mes botimeve të fundit të Napolitanos, mund të përmendim: "Në brigjet e kohës" (poezi, 2005); "Kohë letrare" (ese, 2006); "Lodëve" (poezi, 2006); "Fluturo lart, fjalë" (poezi, 2007); "Via Crucis" (poezi, 2008); "Gaeta, kujtesa dhe e ardhmja" (histori, 2008); "Fjalët e të tjerëve" (ese, 2008). Veprat e tij janë përkthyer në frëngjisht, spanjisht, anglisht, greqisht dhe në gjuhë të tjera.

SA LEHTË RRJEDHIN FJALËT!

(12 maj; për tim atë)

Paqëndrueshmëria e butësisë
është një shkëmb i palëvizshëm
mbi gjurmët e lodhshme për t'u ndjekur
tekta i afroresh kreshtës
prej nga kaptohet furishëm kjo ngjijtje
e pikasur vetëmse në fund

Gjaku yt janë fjalët e mia
që lejove të rrjedhë në mua
guida jote e pashtershme
vetë palca e përvojës sime
u bë fjalë përtej një shenjës tënde
për të thënë se ç'mbaj brenda dhe e di

Është dita kur më ngjize dhe kur në mua
shpresa ndeze për brigje të tjera
duke notuar në detin e furtunshëm
të ekzistencës shtegtare: një blatim i ri
i ndrequr rrezikshëm brenda gjurmës
nga dhimbja e lashtë shenjuar

Në fjalët thuajse të gjalla
pinjolle të një jetese të humbur
do t'u kisha borxh ëndrrave:
trashëgiminë e panjohur që m'ishte dhënë dikur

PËRGJIGJA, BIJA IME

Po nuk pyeti ende Bobi sa kohë
edhe sa kohë duhet për t'u bërë burrë
nuk e ke gati përgjigjen dhe nuk është e vërtetë
se e mori era – e ke humbur
kur ende mund ta kishe pasur kohën tënde
për të ndjekur edhe erën e ta bësh tënden
(tani provo të joshësh fatin tënd)

*

Përjetë e re gjersa të të kem në krah
do të ndjek stazhin e viteve të tu
dhe herët a vonë do të jem gati të të dhuroj
horizontin që nuk të përgjigjet ende

tamam si një grua, o bijë
ta dish se nuk është e lehtë: joshjet e tua
nuk e ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve

nëse para syve të ty prej fëmije që rritet
shpërfaqet një botë armiqësore
ajo duhet vetëm të presë
ajo duhet vetëm të besojë - në vetvete

QË E NESËRMJA TË MOS E DIJË PËR TË NESËRMEN

Tim vëllai për kujtim

How many years - edhe sa kohë akoma
do të fajësoj veten se u rrita
më pak nga sa duhej
për t'u quajtur burrë: nëse ky është burrë -
sa mënyra ka për të qenë i tillë dhe për
ta dëgjuar këtë fjalë - por e rëndësishme akoma
më shumë është të mbetesh mes burrash
duke i besuar një gjurmë - ndoshta

duke ecur së mbrapshti brenda gjurmës
gjerkur të mbërrij (hic optime manebimus)
atje ku kopshti i qershive është përherë në lulëzim

- i pamërituari eden i rigjetur
të cilit më në fund do t'ia njoh të paktën
një moment para se të gaboj
sa gabim i pabesueshëm po të besoja
se mund të matesha pa u ndëshkuar
me gjenezën e një ideali të ri

- por ti shenjon hapat e tu në erë
dhe je zëri i reve që qajnë

Përktheu nga italishtja: Elvana ZAIMI





Iskra PENEVA
(SERBIA)

Iskra Peneva është e lindur në Beograd, ku edhe jeton. Është absolvente e Fakultetit të Matematikës.

Ka botuar tri përmbledhje poezish: "Kutia me nëntë faqe" (2002), "Zjarri dhe flutura" (2004) dhe "Rrugët e pastajme" (2006, libër poetik koautorësh).

Është e përfaqësuar në disa përmbledhje antologjike të letërsisë serbe dhe maqedonase: Solemnitete shpirtërore – antologjia e poezisë e maqedonasve në Serbi dhe Mal të Zi, Nociione ndriçuese – antologji e poezisë së poetëve nga pakicat nacionale në Serbi e Mal të Zi, Vallja e miqve – antologji e poezisë për fëmijë, Poezinë do ta shkruajnë të gjithë 2 – antologji dygjuhëshe serbe-suedeze.

Është laureate e më shumë mirënjohjeve dhe shpërblimeve, pos të tjerash edhe për poezinë më të mirë të festivalit "Shtigjet poetike" të poetëve të rinj të SMZ në Kikindë.

Boton poezi në periodikë dhe përmbledhje në Serbi, Maqedoni, BeH dhe Republika Serpska.

Poezitë i janë përkthyer në maqedonisht, bullgarisht, shqip, anglisht, suedisht etj.

Është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë.

DJALOSHI DHE DIELLI

Djaloshi me të djegura në shpinë
Vendosmërisht doli të ngadhënjë mbi diellin

Lëkura e tij e djegur
E vrazhdë nga vuajtjet
U shndërrua në një helmetë të hekurt
I zbukuruar me pluhurin laraman të shkretëtirës
E humbur në poret

Shputat e tij
Duke bartur peshën e rëndë
Lënë gjurmë të kuqe në
Bërthamën e sjellë nga era

I ndihmon syrit që ta kuptojë lajthitjen
Dhe ta njohë rrethin
Që e mbështjellë Tokën dy herë

Cilën rrugë do ta zgjedhë
E atij do të jetë

Në tentimin që t'i kërcënohet
Hijes së vet
Djaloshi i mbylli sytë
Dhe filloi rrethin e dytë

GRUAJA VDEKJE

Vishem me të zezë
Kundruall dukurisë për gruan
Të emërtuar Vdekje

Atë ditë që do të më vish
Ndalun pranë supit tim
Me krenari të hedhur
Si ushtarët që e përshëndesin
Shkuarjen

Më shiko drejt
Me syrin që vret
Më shtrëngo dorën
Dhe heshtë

Më puth tri herë
Në faqet

Më përqafo
Më ngroh me prekje

Teshat tuaja janë të kuqe

ZHGJËNDRRA

Nga kraharori i vet
E shkaputi zemrën

E mbështolli bukur
Në letrën dekorative
Të ditëlindjes

E shtroi në tavolinë
Pranë mikroskopit

Njeriu jetonte

Zgjohej me agimet
Punonte
Përfytyronte
Meditonte
Krijonte
Hante
Flinte
Dhe ëndërroi ëndërr

Nga tavolina
Mori zemrën
Dhuroi
Bashkë me
Beharin e pjeshkës
(Ishte fatlumë)

U zgjua
Buzëqeshi
Shpejtonte
Që ta sendërtojë ëndrrën

DY HIJE

Për një Diell
Kishte dy hije
E vetja
Dhe e huaja
Bukur e formësuar
Me një errësirë jo aq të qartë
Të cilën duhej ta zbulojë
Ta formojë dhe ngjyrosë





Viktor RADONJIQ
(SERBI)

Viktor Radonjiq u lind më 1973 në Beograd. Ka botuar librat e poezisë: "Përparim" (2002), "Errësirë dhe argjend" (2004), "Ekologjia e një fjalie" (2005). Poezia e tij u botua në revistën ndërkombëtare "Signal". Jeton në Beograd (Serbi).

THJESHTËSI BRUTALE

Në tepricë
Një kërkesë
Si bujari
Me gjithë
Kohën
Dhe kalbësira të tjera
Në gjirin
E thjeshtësisë brutale
Guxim
Kotësi e lavdishme
Për kamën e kompromisit
Mund të mbetet
Një lavdëri
Për stilin shkurtabiq
Sapo të të lëshojë
Kuleta prej letre
Dhe karnavali i heshtjeve
Në bllokun
E shekullit të fundit
Është vështirë ta thuash
Atë
Si "të dua"
Kurse ha kokoshka
Dhe qesh
Me lavjerrësin
E këmbanës së kishës

PAK GISHTËRINJ

Duke kërcitur nga kujdestaria
 Me damarë
 Një skllav
 Nga mungesë helmi
 Vodhi fjalët
 E krimeve të parëndësishme
 Kjo është shenja e aftësisë
 Lyp
 Për monedha
 Për lëkurën tënde
 Madhështi rrudhash
 Duke brohoritur
 Për ngjitje të vetmuar
 Dridhet nga vesa
 Këta gishtërinj të paktë
 Për të filluar afërsinë
 Me trazirë
 Époque nate
 Thirrje për mesnatë
 Qeshja e dengut
 Të kujtuar të ngrohtë
 Mbi çatinë rrëshqitëse
 Me buzë të ashpra
 Që ngjethen në flladin
 E fërkimit të kthyer të verdhë
 Mbi plasaritjet
 E fermentimit të refuzuar
 Mengenja admiron
 Pritjen e shpinës
 Prandaj
 Prekja
 Që zbeh
 Në baladën
 E kuakjes së bashkuar

DREJTSHKRIMI PËR TITUJT

Kalibrimi i silicit
Dikush u pengua
Duke ngadalësuar nëntitullin
Britmë e paqëndrueshme
Mbi tavanin
Thithe
të çaluara neoni
Gazra stomaku
I shurdhri
Pëshpëriti
Uria lakmitare
Fillon
Pas
Zukatjes
Drejtshkrim për titujt
Rapsodia
Përfytyron
Romanin e fundjavës
Të vizatuar blu
Togën e Erosit
Parketi pa pluhur
I burgosur i ëndrrave të gjakut
Pa erë
Lyp
Së paku për një vdekje ngjithëse
Ikën nga ekrani





Diti RONEN (IZRAEL)

Diti Ronen u lind më 1952 në Tel Aviv. Është autorja e dy librave me poezi – Hënë e brendshme, bllok shënimesh (Hakibbutz Hame'uhad, 2002) dhe Kur shihen brekët (Gvanim, 1999).

Poezitë e saj studiohen në institucione akademike dhe disa prej tyre u vunë në muzikë, u përshtatën për skenën, u përk-

thyen në gjuhë të huaja dhe u botuan në SHBA e gjetiu. Ftohet rregullisht të bisedojë për poezitë e saj në Universitetin Bar-Ilan dhe në vende të tjera.

Dr. Diti Ronen u diplomua në Repartin e Arteve Teatrale, Shkolla e Arteve Vizuale dhe Interpretuese, Universiteti i Tel Avivit. Prej vitit 1999 – 2006 ishte kryetarja e Reparteve të Teatrit dhe Letërsisë në Ministrinë e Kulturës të Izraelit.

Momentalisht Ronen jep mësimë dhe këshillon për politikën e kulturës dhe administrimin e arteve. Është duke punuar edhe për librin e saj të tretë me poezi, që synohet të botohet në vitin 2009.

ÇEREKU I TRETË: NGRËNIA E HËNËS

Cila është largësia e saktë
midis burimit të dritës
dhe brengës së saj.

Në këtë zonë, luftimi trup me trup
midis nesh po
bëhet i dendur.

Reze të ndërthurura lazeri
skanojnë të dhënat e çdo fyerjeje
dhe orbitën e saj, duke gjetur edhe ato bishtnuese
dhe të ndyra.

Jemi si flokë hekuri në një fushë
paralizuese magnetike, të rreshtuar
sipas urdhrave të mëparshëm.

Në zvogëlimin absolut
pikat e lindjes dhe vdekjes
bëhen njësh.

ORA POLICORE, VARIACIONI NR. 5

Koha që kalon këtu luhartet mbi veten e parë, veten e dytë, diell, re, hënë, rutinë kalitëse. Si ndreq dhembja? Një frymëmarrje e rrëmbyer, një pushim i shkurtër midis errësirës dhe dritës, dremitje e detyruar, ulje e papritur e kokës, dridhje çelur dhe fikur, dhe më vonë atje.

Gjithë mëngjesin shiu turpëron pemët dhe mua, turpërimin tonë, që rrjedh drejt tokës, i rëndë dhe i lagësht. Një shtrat është një ishull, thithë gjiri, një përdredhje pëlhure në kërkim të përhershëm për zgavrën dhe ngrohtësinë e trupit. Shtriqem për të plotësuar zvogëlimin, por dhembja ka rregullat e veta. Frenimi i lëvizjeve dhe mungesa e kalimit të lirë fiksojnë një fundosje, një mjegull të thellë.

Natën, nën sipërfaqen, një lumë të gjerë ndërgjegjeje shpërthen, vozit vetvetiu, ndriçon udhën e vetë. Bllokime janë pengesa të përkoshme, si rrugët e tërthorta të bëra qull me baltë, dhe këmbët – qofshin të dëgjueshme – pengojnë nganjëherë nga frika.

Jashtë është e premtë. Aroma e mansaf-it të fqinjit ngurron në strehën e larjes së rrobave. Përpiqem të kuptoj se cila ditë është brenda, por drita është i njëjti terr. Së shpejti dridhja do të ndalë, dhe zjarri dhe ndëshkimi i errët do të zhduken në një heshtje ndreqjeje.

RËNIA, VARIACIONI NR. 6

Si fillon një valle.
 Me përqëndrim. Me depërtim.
 Një dritë e papritur dridhet në pikën e kontrollit.
 Një zhurmë shkrepet. Thirrje urgjence.
 Me një fishkëllimë.
 Hyn? Del?
 Vendi im? I saj?
 Me një shtrëngatë.
 Duke filluar në gju. Me një britmë.
 Që mugullon dhe ngritet deri në legen
 duke u rrotulluar

nga qendra në skajet
pa zë.
Duke filluar në kokë. Me një goditje.
Me zvarritje.
Në gjunjë. Me zvarritje.
Duke filluar në bërryl. Me një pickim.
Me një dridhje. Me hezitim, me tërheqje.
Pa zhurmë. Po ku tani.
Zhurmë mbi zhurmë që hallakatet nëpër hapësirë
Zona A, Zona B,
një pikë e vetme.
Një ndahen.
Duke u penguar.
Duke u ngritur. Duke u penguar.
Duke u ngritur. Një palosje në të majtë
duke rënë në të djathtë
e përkulur. Duke kërkuar.
Strehë a mbulesë. Evakuim i menjëhershëm.
Duke rënë sa gjatë gjerë. Me një goditje direkte.
O Zot, krahu im!
Me heshtje.

*Përkthyer në anglisht nga Rachel Tzvia Back, nga
anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach*





Françoise ROY (KANADA)

Françoise Roy u lind në vitin 1959, në Québec, Kanada. Është gjeografe dhe mban një diplomë për studime latinoamerikane (Universiteti i Floridës, M.A., 1983). Ka botuar gjashtë vëllime dhe një librezë me poezi, dy romane në frëngjisht dhe spanjisht. Ka përkthyer më shumë se 25 libra dhe një pjesë teatri nga

Fernando Del Paso. Më 2005 botoi romanin "Si tu traversais le seuil" (Po ta kapërceje pragun; L'instant même, Québec), për të cilin mori vitin tjetër çmimin "Jacqueline Déry-Mochon". Më 1997 mori Çmimin e dytë Kombëtar për novela "Victoria de las Mercedes" (Meksikë). Më 2000 mori diplomën e përkthimit nga O.M.T. Më 2002 themeloi revistën mujore arti dhe kulture Tragaluz, të cilën e ka redaktuar deri në përfundimin e revistës më 2007. Më 2005 ishte finaliste e çmimit Acento de cuento breve. Më 2006 mori një çmim nderi për Séptimo Certamen Literario de Cuento "Sobre rieleles" nga Shtëpia e Kulturës në Nuevo León. Ka qenë dy herë bursiste e Programit për Mbështetjen e Krijimit Artistik të Ministrisë së Kulturës në Jalisco. Në vitin 2007 mori Çmimin Kombëtar të Poezisë "Alonso Vidal" për librin e saj "Todo lo que está aquí, está en otra parte" (Gjithçka që është këtu, është gjetiu) të botuar nga Instituti Komunal i Kulturës dhe Arteve në Hermosillo, Sonora. Prej vitit 1992 jeton në Guadalajara, Meksikë.

ARMËPUSHIM

Ja ku jam, me duar të zbrazëta, kamën, kamxhikun, çekiçin e drurit, thikën në dysheme, këpucët e mia të shpërndara përreth. Kërcej gruri presin që të vijë kapësi i kërcejve.

Engjëlli (krahë të zbehtë albatrosi të zi) nuk duket si dikush që do të përdorte armë me teh. Duket si çfarëdo tjetër përveç një vrasësi të blerë.

Mbështetet përpara me kaq elegancë (o Zot, një pikturë Botiçeli me një Madonë shikimëmbël) që mendoj spontanisht: do të mbledhë një tufë me lule, një duzinë krizantemash do të mbijnë menjëherë në dyshemenë prej tjegullash, dhe ai, meqë ka shikimin profetik, do të parashikojë këtë lulëzim të mrekullueshëm.

Por jo: me gjestin e një magjistari, ai hap pëllëmbët e tij mbi objektet e dhunës të shpërndara pranë këmbëve të mia, dhe bën një deng nga to sikur të ishin një grumbull shpargu ose një tufë lulëshqerrash ose bile një vandak druri zjarri.

Këtë mund ta shoh se si i hedh në hurdhë, si dikush që pas një krimi dëshiron të fshijë gjurmë gishtërinjsh nga një doreze pushke. Kur shoh që m'i zgjat duart mua me pëllëmbë lart, kthehem mbrapsht.

Dashuri, mjegull, aq shumë gjëra pluskojnë përreth. Ai më shikon pa kthyer një qime.

Një palcë dritë bën një prerje të pastër në faqen e tij të djathtë.

KRIJIM PEJSAZHI

Një fushë e tërë e mbjellur me shkronja.

Shkronjat janë pasqyra e fjalëve.

(zanore dhe bashkëtingëllore, të mëdha dhe të vogla, që presin cenzurën)

Një kopsht fjalësh para se të mbijnë,
një stinë e tërë para drithës së pjekur.

(Topografi mat madhësinë e faqes,
ja ku vjen, i armatosur me një masë; i sistemon
në çifte, në një çdo taban: dashuri, trumcak,
vetëtimë,

vdekje, engjëll, ylber, asnjëra nuk peshon sa tjetra)

Dimri ka tundur shaminë e tij të qëndisur nga
ngrica,

patat e Kepit Tourment kanë fluturuar në jug dhe
prapë

në veri, një lidhëse gjelbërimi përhapet si pëlhurë
merimenge

mbi këtë labirint gurësh dhe dheu që bëhet i gjallë.

Dhe befas, të mbjellur si njëmijë direkë

në këtë gungë gjelbërimi dhe okri, klorofili dhe
argjile,

dordolecat.

Një ushtri e tërë dordolecash,

ballë qymyri të kthyer drejt diellit në muzg

që bie butësisht mbi fushat

(drita e tij, flaka e një qiriri që vdes).

Pas pesëmijë vjetësh, dikush do ta gjejë:
 ushtrinë e varrosur të një Xiani të ardhshëm,
 regjimente të radhitura përsosmërisht
 prej dordolecash të paarmatosura.
 (koha tret shtiza dhe shqyta;
 acidi klorhidrik i shekujve që kalojnë
 bën shkrumb gjithçka, o farët
 e zemrës
 që zien në ujthin plot lëng të mendjes).

NIÇE DHE PLATONI DUKE U SHËTITUR NËPËR PARKUN KOMBËTAR MAURICIE

Danielit dhe Williamit

Dalëngadalë pylli i thellë merrte frymë, qiell i
 lulëzuar, vjeshta e kapur në degë, skeletet e tyre të
 mëdha celuloze lëshonin vetat e tyre bimore mbi
 tri palë shkallësh, që shponin si bizë pëlhurën e
 gjallë të heshtjes. Vër re madhështinë e diellit – një
 e verdhë veze shumë lart, një xhevahir zjarri në
 vendbanimet më të pastra të së kaltrës, një zemër e
 qetë në këtë rrafshinë të zbehtë, ku pelegrinazhi i
 yjeve merr fund! Ç'mund të them për përkëdheljen e
 butë që dora kadifeje e erës na valëvit – pothuajse
 një shuplakë në fytyrë -, rreze dielli presin si kama
 nëpër gjethnajë me ndërkalje kërmëze. I inokulluar
 nga pija e lisave dhe pishave, William thotë:
 sipas Niçes, njeriu është një hibrid nga pema
 dhe fantazma. Kush ishim ne atëherë, një treshe
 jetëshkurtër që shëtiteshin nën filigran të artë dhe
 të përgjakshëm? (gjethet kanë humbur gjakun duke
 u zbrazur nga ujthi që mbante rrahjen e algave të
 tyre klepsidra, blijtë dhe soje të tjera të ëmbëlsuara
 janë shpupluar nga këmbanat e tyre tingëlluese)
 Cili sekretar i së padukshmes do të dinte se ç'ishim
 në atë ditë duke u mishëruar në të gdhirë dhe duke
 vdekur në muzg? Aq shpejt kthehemi në zyrat
 kirurgjike të gjendjes civile të kujtesës, kur ora e
 qiejve nate thërret hënën në armë me dymbëdhjetë
 goditje të një këmbane. Ç'ishim ne atje, gjysma
 bimore – mështekna me lëkurë dhe gishta – ose
 përndryshe (me të braktisur kudhrën e trupave
 tanë), gjysma fantazmagorike? (vetëm Niçe do ta
 dinte, por Niçe ka vdekur, varri ka ngrënë fjalët e
 tij, kë të pyesim tani?): ndoshta Williamin, që ia vuri

Niçes në gojën venitëse vargjet vijuese: Një perëndi vdes në mes të një opali zjarri ngjyre muzgu / Një engjëll vdes mbi akullnajën më të bardhë / Një zog vdes në një pyll prej resh / Një kupolë vdes e rrënuar nga flutura. Dhe po të ishim vetëm tre pelegrinë mbi një qilim ngjyre alle, mësymja e pyllit nga valët që plluqurisin nëpër një natyrë në ulluk. Si u bëmë në atë mbasdite mysafirë mbretërorë të një qetësie të gjelbër-verdhë që ngjyrohet në gjak? Në këtë vend të mbjellur me njëmijë pyje dhe liqene, një poet shkroi njëherë: Kush ankohet për të vdekur në vetmi? Cili fëmijë lind? Cila gjyshe, gjysmë e mbuluar nga vdekja, i pëshpërit në vesh se e ka shpirtin të pavdekshëm? Dhe liqeni që rrihte si zemër në mes të pyllit, që shponte fasada zjarri, dukej sikur të ishte bërë nga metali. Mendoj që e pashë pezull në gjoksin e Danielit, pa peshë, aq i brishtë sa një planet prej letre. Dhe meqë ra fjala (çështje ngritjeje në ajër, shkresurina jete dhe vdekjeje, eliksirë shpirtrash dhe poezish), duhet të them se nga ne të tre, ai me shenjë e Peshqve kupton më mirë pluskimin, tregtinë e padepërtueshme me qiellin – më shumë nga një oqean kundër të gjitha eventualiteteve. Ishim të ulur nën vështrimin mirëdashës të yjeve të ditës (dritë mbi dritë, e bardhë mbi të bardhë) bëmë fotografi, plluquritjet e errëta të sipërfaqes u kthyen prapë në vendin e tyre të prehjes në këndin e rrotullimit të Tokës. Duke u shtrirë mbi këtë qilim prej ngjyrave që përziheshin, i rrethuar nga njëmijë gjethe të thata, William dukej si një kryeengjëll që kishte ndërruar fustanin e tij të bardhë me këmishë dhe pantallona, një qenie e ajrit që kishte humbur rrugën lumturisht, jo duke u ngritur, por duke u drejtuar për një rënie (vetëm kështu mund të na prekte, të ledhatonte vatrat tona, të derdhte një a dy lotë pranë atyre pa krahë fluturimi). Por ç'mund të dija unë për kryeengjëj, e mbyllur që isha në kullën më të ulët të mishit, e lidhur me fill të dyfishtë me nevojat e përlura të gjërave të rëna? Apo a ishte William një Krisht i kryqëzuar, që dalëngadalë kapërcente ajrin mbi një cohë mozaiku në granat dhe shafran, kermes dhe korint, të kuqërremtë dhe purpur, një det pergamenë të qelibartë? Qoftë Krisht, qoftë engjëll, pasi u çua nga shtrati i tij prej klorofili, tha që gjethet qenkan një provë e fortë që Zoti ekziston: dikush duhet të jetë i ngarkuar me numërimin e tyre, me mbajtjen e shënimeve të gjithësecilës prej qelizave që përbëjnë afreskën e porsapikturuar të

kësaj pemëtarie të madhe. Daniel kishte shkëputur disa gjethe nga parakrahu i një panje për t'i futur si shenjë në libra (vetëm një poet mund të jetë fajtor i një vjedhjeje të tillë; zona pyjore nuk zmbrahet, e këputur butësisht nga këto duar të bëra për të shkruar vjersha). Zotit – me librin e tij të mbajtjes së llogarisë në prehër – do t'i mungojnë shtatë gjethe kur bie nata dhe ndarja e përditshme e botëve kryhet në një të çelur-të errët në rritje. Di që Venera po shëtitej qetësisht pranë nesh, dy hapa mbrapa, një kujdestar i paefektshëm dhe memec, që nuk do të dinte se si t'i parandalonte gjërat (ajo s'ka kamxhik as nuk ka një gjuhë për të paralajmëruar dhe për të qortuar dhe asgjë përveç duarve për të ledhatuar), duke na bërë të dehur me ilaçin më të lartë të Bukurisë.

Bukuria: Platoni kishte të drejtë, ka në të vërtetë një vend shumë lart ku lëvizin ide të pastra, ndonëse dy mijëvjeçarë e gjysëm më vonë ende nuk dinë se si, të dobët dhe të butë, janë mishëruar në këto pyje të bekuara me tapicerinë e vjeshtës.





Remzi SALIHU (MAQEDONI)

Remzi Salihu u lind më 28.IV.1955 në Gajre të Tetovës. Arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në Tetovë, kurse Fakultetin Filozofik – Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe në Prishtinë. Pos poezisë, shkruan edhe kritikë dhe përthën nga gjuha gjermane. Ka përkthyer poezi prej Erih Fridit, Paul Celanit, Roze Auslanderit,

H. M. Eczenzbergerit, Ula Hanit, Myhael Krygerit etj.

Në vitin 1987, fitoi në konkursin letrar „Goranova prolet“ në Zagreb, ku si shpërblim “Rilindja” ia botoi librin „Fluturimi i largët“.

Më 1992, botoi librin me poezi „Sheshi i shtrigave“, ndërsa më 1993, „Flaka e vëllazërimit“ ia botoi librin e tij të tretë „Gjurmë malli“.

Ka punuar në arsim dhe një kohë të gjatë në mërgim (Zvicër), ku ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme letrare dhe ka qenë anëtar i shoqatës së shkrimtarëve dhe artistëve.

Është themelues i shtëpisë botuese “ORA-R” në Tetovë. Jeton si krijues i lirë.

ME NJË SHKËNDIJË MALLI

Jetoj
Midis tokës dhe qiellit
Jetoj midis peshës së rënies dhe ngritjes
Një yll më mban për flokësh
M’i shkul mendimet një nga një
Një pemë e lartë varet për mua
Frytet i hanë të vdekurit
Kometë e zgjatur midis dy atmosferave
Tokë e Qiell më buçasin në kokë
Jetoj i tërhequr në vete zvarrë
Herë lartë e here poshtë i gjallë
Me një shkëndijë malli në zemër
Që më ndriçon në ball
E më djeg si zjarr
Jetoj

NËNAT E DËSHMORËVE

Lumenj lotësh dhimbjet e nënave
Në buzët e tyre harta të mavijosura klithjesh
Të dënuara në mall pritjesh
Për pranverat e vonuara
Nënat e dëshmorëve janë
Udhëtime të anuluar të jetës
Thika të mprehta mallëngjimesh
Që presin shpresën e ëndrrave
Me brengat e tyre të mëdha
Luftojnë për çdo ditë
Me mendimet e plagosura në kohë
Mbeten të vetmuara me lirinë
E burgosur në shpirt
Nënat janë perla të arta të popullit
Që ujisin atdheun me yje

E mos i gënjeni nënat e dëshmorëve
Se kanë plagët e dhimbjes si dëshmi

BESIMI

Mbete e shtangur
Në verandën e jetës


Nuk të pash më
As fjalët as trupin
Se shpalove nga hijet

Je diku e fshehur
Në klithje, në haresë
Para pasqyrës së vetes
Madhështia nuk duket

Unë mbeta pa të njohur zemrën
Si mund të të besoj

KOPSHTI I BABAIT NË GRAVURË

Ike ti
Dhe me ikjen tënde
Ikën zogjtë e pëllumbat
Hardhitë e shartuara
Nga duart tua të palodhshme
Nuk i shoh më në këtë imazh mendimi
Tani në kopsht çdo gjë ka ndryshuar
Qershinë që mbolle ti
E ka prerë hija e betonit
Kur ike ti baba
Gjithçka humbi gjelbrimin
U plastifikuan pemët dhe lulet
Aroma u tjetërsua nëpër kopsht
Zërat neve na u mplakën
Filluam të zvaritemi pas hijes tënde
Por nuk e kapëm dot
Vetëm polem malli shëtitë nëpër oborr
Për të gjetur gjelbrimin e ikur
Por duart na u përgjakën nën doreza të lëkurta
Nga kërkimet e pareshtura
Të gërvishteve të brezave të njëri pas tjetri
Nëpër beton e armature
Ndoshta nesër ata që do të vijnë pas nesh
Tërë kopshtin dota futin në gravurë





Salajdin SALIHU (MAQEDONI)

Salajdin Salihu, lindur më 26 maj 1970, Tetovë.

Ka botuar librat me poezi dhe tregime:

"Vdes pas gjërave të imëta", (Aza Se&SOFT- Tetovë 1996)

"Nata e parë e pushtimit", (Klubi letrar - Tetovë 1998)

dhe librat me ese

"Panteoni i utopisë", ("Shkupi 1997)

"Gjurmë", (Flaka-Shkup 2000)

Poezitë e tij janë përkthyer në anglisht, frëngjisht, maqedonisht, sllovenisht dhe rumanisht. Është përfshirë në disa antologji.

Është fitues i disa çmimeve letrare.

Një kohë ka qene gazetar dhe redaktor i disa medimeve në Maqedoni. Aktualisht është shef i katedrës së Gjuhës dhe letërsisë shqipe në UT.

IKJA NGA MËKATI ËSHTË GËNJESHTËR

Valët e Liqenit janë këngë të lashta
A i dëgjon e dashur
Lirës i bie dashuria
Besomë
Oj e bukura e Strigharit
Natën e shpikur për dehje që të pashë
Ah! Të lutem mos thuaj asgjë
Duhet të heshtim patjetër
Apo jo. Le të flasim trupat tanë të shtrirë në ekstazë
Shiko qiellin lutju si një ikone të mëkatarit
Uratat leri për një kohë tjetër,
janë marrëzi të klerikëve
Ruaju mallkimit të zemrës sate
Ikja jote s'është zgjidhje
As shpëtim nga gabimi që duhet bërë patjetër
Ikja nga mëkati është gënjeshtrë
Mashtrim i bukur
E asgjë tjetër.
* * *

Vetëm një klithje është jeta, më tha
Pastaj u bë mjegull
Që atëherë dal të më lagë shiu...

NDEZ CIGARET REND SI ZHAK PREVERI

I ndez cigaret rend si Zhak Preveri
 Ti nuk je në dhomën e zbrazur
 Brenda më ngulfat vetmia
 Dritaret kaheër i kam mbyllur
 Dhe dyert ku mund të hyjë marria
 Notoj nëpër tymin e vjellë në ajër
 Në saksi vyshken lulet...
 Ca gjethe të vdekura në një peisazh vjeshte
 Era e kujtimeve i mbart
 Si në poezitë e Zhak Preverit
 Ca gjethe të lehta si një puthje në stacion
 Ku të përcjell trishtimi dhe të pret
 Siç i pret i burgosuri festat
 Puthje të lehta si vdekja
 Ndez cigaret rend si Zhak Preveri
 Dhe nuk e rrëfej jetën time
 Dhe nuk e rrëfej jetën time...

DHOMA E POETIT

Mund të ketë një tavolinë pune ku shkruan poezi
 Sirtarë me libra që kurrë s'i ka lexuar
 Një filxhan me kafe të idhtë si dita
 Një shpuzore plot cigare të djegura nga zhgënjimi
 Fletë të shkaravitura ëndrra të zbehura
 Krrokama që përplasen në qelq mendimi
 Mund të ketë ditë të lodhura nga vetmia
 Të mbështjella me tis kotësie
 Shekuj të djegur nga utopia
 Ëndrra të ngrira pamje që s'i zbeh harrimi
 Mund të ketë peisazh vjeshte dhe gjethe të vdekura
 Lumenj shprese dritë terr ferr e tmerr
 Mefistofel Hamlet Jago kolonel
 Santjago derr të vuajtur dhe Sokrat - derr
 Mund të ketë meteorë mendimesh që digjen
 dhe shuhen befaz në univers qenësie
 Diku në zonat e errëta të njeriut
 Nocionet lart poshtë djathtas majtas
 Mund të humbin kuptimin
 Koha mbrapsht të rrjedh në klepsidër jete
 Mundet që aty të mos jetë fare poeti...
 Të ketë shkuar larg
 Me shpresën e kthimit në sy
 Dhe mund të kthehet sërish në atë dhomë
 E ta gjejë trupin e vet - kufomë
 Gjithçka mund të ndodhë në atë dhomë...

AQ SA PREKET E PUSHTOHET TYMI

I mbështjellë me heshtjen e kësaj mbrëmje
 Këndo një këngë për një vashë sy ulliri
 Drini Zi i heshtur si mendimtar
 Rrjedh mes për mes qytetit me shumë ura
 Nga kutia e cigareve plot numra telefoni
 Nxjerr një mikeshë dhe e thith dashurisht
 Në tymin dredha - dredha shfaqet imazhi saj
 Dua ta prek ta ndiej ta puth ta pushtoj...
 E prek e ndiej e puth e pushtoj...
 Aq sa preket ndjehet puthet pushtohet ty mi...

SËRISH SHFAQESH NË KËTË QYTET

Më ngjan si numër telefoni
 I fshehur në skutat e kujtesës
 Si biletë udhëtimi më ngjan
 Fshehur në xhep harrimi
 Me të cilën kam udhëtuar dikur
 Përtej kotësisë
 A jemi të njëjtit e dashur, apo jo
 Apo kemi ndryshuar
 Jo...





Rami SAARI (IZRAEL)

Rami Saari u lind më 17 shtator 1963 në Petah Tikva, Izrael. Është poet, përkthyes, gjuhëtar dhe kritik letrar. Ka studiuar dhe dhënë mësimë për gjuhësi semitike dhe urallike në universitetet e Helsinkit, Budapestit dhe Jerusalemit dhe ka mbrojtur doktoraturën e vet në Universitetin Hebraik të Jerusalemit (2003). Prej vitit

2003, Saari ndan kohën e vet mes Jerusalemit dhe Athinës. Deri në shkurt 2006, Saari ka botuar gjashtë libra me poezi dhe ka përkthyer më shumë se tridhjetepesë libra, prozë si dhe në poezi, nga shqipja, estonishtja, finlandishtja, greqishtja, hungarishtja, portugalishtja dhe spanjishtja. Nga shqipja ka përkthyer poetet dhe shkrimtarët shqiptarë Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Ali Podrimja, Nasi Lera, Visar Zhiti, Lindita Arapi, Shaip Emërllahu, Blendi Fevziu, Lindita Karadaku, Mira Meksi, Betim Muço dhe Dhimitër Pojanaku. Poezinë e Saarit e kanë përkthyer në shqip Natasha Lushaj, Silke Liria Blumbach dhe Andi Kosta. Poezi të veçantë e Saarit janë botuar në shqip, katalanisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, japonisht, maqedonisht, rusisht dhe spanjisht. Prej vitit 2002, Saari ka qenë redaktori kombëtar i faqave të Izraelit në web-faqen e poezisë. Në vitet 1996 dhe 2003 u shpërblye me Çmimin e Kryeministrit për Letërsi dhe në vitin 2006 u shpërblye me Çmimin Çernikhovsky për përkthimet e tij.

KOSTANDINI I NISËT RRUGËS

Para se të ikësh,
as bir, as vëlla,
as shok, as dashnor, por
më shumë se një prekje prej tyre -
mbaje dorën time të fortë
në dorën tënde të hollë, që njohu kënaqësi
dhe hidhërim dhe netë të stuhishme.
E tëra ime, më shumë se çdo gjë tjetër, do
(e tëra ime, jo përsëri) të të mbajë ngushtë,
për një çast çast
të jemi një mish e gjak
dhe një farë dhe të gjitha gjërat që janë një,
Megjithatë, po, megjithatë
i marr duart e tua të mira në të miam

dhe të çoj te dera,
 të dërgoj si një pëllumb, Kostandin,
 në botën e gjerë.
 Në stuhitë që do të takosh,
 në hidhërimin dhe gëzimin që do të mbash,
 vëllai dhe i biri im, miku dhe dashnori im,
 dhembshuria ime do të të përcjellë përherë,
 e papastër ndoshta nganjëherë,
 por e lumtur për gëzimin që do të gjesh.
 Të ndihmofshin qiejt, të mbrofshin,
 burrë, deri në fund të rrugës.

LISA MIDIS VERMONTIT DHE LINIT

Jeta është larg vendit
 që zgjedh për pushimet,
 ndonëse je në të vërtetë
 një person praktik. Në fakt,
 me gjithë interesin tënd në poezi,
 ke arritur moshën e mesme pa
 një librin tënd në çantën tënde,
 me integritetin aq të ulur sa Deti i Vdekur.

Prandaj nuk mund të pretendoj
 që e ke kokën në retë,
 ndonëse shumë fluturuake
 kur nuk lidhesh me zinxhirin e semestrave
 në kalanë e studiuësve
 në majë të Malit Skopus.
 Unë jam i lirë nga këto detyra -
 s'kam nevojë t'u privohem festivaleve poezie
 gjatë vitit shkollor -
 por gjithsesi nuk ka fluturime
 për vendet që më tërheqin.
 Arrin atje, po që se arrin,
 me autobus, me kalë,
 me tren ose më këmbë.

Tani je e ulur me mua
 në këtë restaurant shqiptar,
 me mjaft para në xhepin tim
 për të të blerë 200 filxhanë kafe.
 A është varfëria më tërheq këtu
 apo dëshira për të kaluar netët e mia
 në mes të mjeshtrave të pashëm të zanateve
 që prej kohësh janë zhdukur nga bota -
 policë që ecin me ritëm,

regjës gëzofesh,
bujq pronarë toke
dhe shërues me shushunja?

Nuk e di as nuk di ti.
Ne të dy në mes të jetës,
të ngecur dhe tani të lirë
për t'u ulur në skaj të liqenit
në zemër të asnjë vendi,
të zhytur në soditje të thellë
në rrugën e asgjekundit.

Pogradec, tetor 2005

TUALETA NË SHKRETËTIRË

Këto nuk janë veç guaska në plazh,
Këmbalka në këmbët e tua,
Eshtra të thyer fosilesh
Dhe tualeta në shkretëtirë.

Nuk u mbet pothuajse asgjë
Nga ajo që ishte madhështore dhe që iku,
Nuk ka asgjë përveç shiut
Në zemrën e thatë dhe të mërzitshme,
Aq të qetë dhe të lodhur sa një kufomë që nuk sheh.

Dhe dashuria
Jeton tutje
Në këtë vend të largët:
Hapësira e vulosur
Ku lindin fjalët.





Indrit SINANAJ (SHQIPERI)

Indrit Sinanaj u lind më 1980 në Fier. Aktivizohet në rrethin letrar që u ndërtua rreth librarisë EPër7shme, Poetët e të Mërkurës, dhe në 2007 nxjerr librin e parë me poezi "okul defteri" (botim EZE, Instituti i Kontakteve Kulturore). Aktualisht jeton në Tiranë.

ASGJË TJETËR

Është vetëm Dashuri.
Jo tjetër gjë, ky kamzhik rraskapitës
që të shfleton shpinën,
Kapitujt e rinj të fshikujve bëjnë pentagrame
mbi shpatulla.
muzikën e Natës së Fundme
mbërthyer dendur me kthetra harabelësh
në Murin e Vajtimeve.
Rrugë e gjatë dashuria për ty,
Solfezh hemorragjije, o Nazaren, poetika
e vetullave, e ballit.
Historia thosh se kish dymijë bukë pikëllimi
e mrekulli në pesëmijë peshq pluskues të mallit.
Thuaju, Ti, të lutem, të shërohen e shtroji
në dyshemenë e vetes sime të fle me to dhe të.
Nuk ka ndodhur ndonjë gjë e re.
Gjithë kjo muzikë është Dashuri.
E jo tjetër gjë.

ATDHEU ËSHTË FJALË INTIME

Atdheu është grumbuj dhe kujtime
përbëra njerëzishëm nga sende e aroma
ësh' emri me shkronja shtypi tek dera, nën zile.
Atdhe është fjalë intime
që ilustron larg e larg dëshirën për mbiemër
për sua e farë, e fëmijë, shumë fëmijë,
familje,
atdhe do të thotë shpërfillje
për kujtesën afatshkurtër të seksit kryer
ditën,

në këmbë,
atdhe ësh' dora e nënës
mbi varrin e gjyshes sime.
Dora mbillte manna, shegë e përralla
ish grua e bukur gjyshja, e donin burrat
Kështu, ma dha babën, lexo: AtDheun
Një mëngjes,
hapa hartën si gazetën
në faqen e fundit për të parë fatin.
U përhap i gjithi si njollë në të
u hapën linjat e turbullta të kufijve si geto
grash dhe mendova
sa mirë është kur nuk je vetëm
sa mirë është kur ke AtDhe.
Atdhe prej vërteti siç e ka gjithë bota
rreshta kufijsh, flamujsh e stemash.
T'u kthesh kujtimeve emra
e t'u japësh kuptimeve vend në tru
me gulçimin lokal të bonjakëve
(fjala bie: njerëz)
të mbledhur rreth Flamurit,
më saktë,
hushtës
si veshkat rreth shtyllës
e të tjerë q'i mësojnë t'i venë numrin
bluzës
a fanellës në ngjyrën e legjendës
me yje vezullues, pa kllapa pa thonjza
e portierë policorë që ndrijnë kufinë
Që ta dinë,
shteti im i varfër rrethohet me Greqinë
Maqedoninë,
Në kohë të lirë me veten e tij.
Këtu (përkthejmë një shigjetë në cep të hartës)
është atdheu, i atit, i dheut.
Në hartën memece ka ngjyra shtetesh:
Racizëm i përmbajtur
pas fasada pushtetesh.
Atdhenë e dallon nga tjerët veç ngjyra.
Ngjyra e negrit, e djersës, me tollona dhjami
e atij që punon tokën e huaj me parmendë
kangjellash a direktësh nga ku varen shpresat
si shpezët e nëntëdhjeteshtatës
e njerëzit,
njerëzit ulërijnë si detaje nga telajo e hartës
ulërin atdheu i kujtimeve
nga dhomat e ftohta të paraburgimeve
nga fry'marrjet e ankthit të solistëve, rrethimeve
të rrugëve të pista të ngushta me plagë.

Unë kam Atdhe kujtimet.
 ku rrek të fusë vetvetet si në ndonjë shportë
 në hartën memece.
 Atdheu im pafajshëm i kuq, si Kësulkuqe
 të cilin e udhëtoj pa dëshirë drejt ujkut a gjyshes
 nën gji përmbi xhaketë,
 si Bibël bullet-proof.
 Atdheu është kopja e karbonit për bukën.
 Korja e saj në dorë, bërë me marmaladë sh'pie
 Është vargu i gjatë i korbave në tel
 i hidhur si ata dhe i zi, duke pritur vizë për përtej.
 Dyer automatike është Atdheu
 kujtime stinore që i hapin kahjet e kraharorit
 në anë të kundërta, dhe dhembin
 dhembin pa zhurmë, vetëm vaj vaj vaj
 i hidhur si benzinë dhe avuj
 kujtime që të lidhin me këtë tokë të panjohur
 është pikërisht ai, Atdheu;
 Atdheu i rruazave të kuqe si tabela ndalim
 parkimi.
 parullash të mpiksura - trombozë shtetit!
 Atdheu është grumbuj dhe kujtime
 përbëra njerëzishëm nga sende e aroma
 ësh' emri me shkronja shtypi tek dera, nën zile.
 Atdhe është fjalë intime.

LEDDA THOTË

Ledda thotë –
 Krih flokët,
 para se të ikësh.
 Merr kokën tënde
 Kohën,
 Jo të gjithën
 E muskujt e buzëve lyeji
 Me të kuq.
 Rrathëve të shikimit vëru
 Pudër.
 Varja vetes me ojna të qeta
 Pa zarar
 Urdhër.
 Leeda thotë –
 Nuk di ti.
 Je keq
 E keqe.
 Fëmijë.
 Fatzi.

Ledda thotë – Të mbroj
Ledda thotë – Të dua.
Dashuria e saj ftomë që më djersit
kurmin.
Ajo di. Thotë se di
me saktësinë e egër
të parashikimit
të motit.
Ledda thotë
qetë e pa ironi –
“Mos u rraskapit.”
Më zgjedh seriozisht
fustanin,
këpucët dhe barnat
e gjumit,
të shkojnë me njëra tjetrën.
Këpucë e tableta
të verdha, të kuqe
harrimi
shtjellohen në gurmazin tim
haptas
trishtimi
i ndarjes së tyre me trakenë,
trafik
qarkullimi
në mushkëritë e mia dhe gjakun
që ushqen mendjen time
(si epruvetë qelqi veshur me azbest)
anësitë e mia, faqet dhe qafën,
mësymje kimike mbi këta
sinorë të keqkuptuar lirie,
që më humbën pashort njëherësh.
Është gjarpër që më sillet,
Ledda
Ndërsa unë,
Simbol i gjallë farmacie.
Mos ji kaq e ashpër o Ledda,
të lutem,
më braktis ndonjëherë.
Ekuilibrat e mi jonikë vënë bast në çdo kohë
Me fizikën, gjenetikën dhe veterinarinë.
Mendimet e mia fajtojnë i shoh
Që lahen vjedhurazi nën dushin tënd
Dhe i shquaj lakuriq nga xhamat.
Turbull.
Mos i quaj fajtojnë mendimet e mia
Se ti jeton kaq pak me mua
Kurse, veten e jeton përherë.
A e kupton të paktën
që nuk ka drejtësi fare, në gjithë këtë?



Anni Sumari (FINLANDE)

Anni Sumari u lind në Helsinki, Finlandë, në vitin 1965 dhe studioi letërsi dhe shkencat e mediave/komunikimit në Universitetin e Helsinkit. Është autorja e dhjetë librave me poezi dhe prozë duke përfshirë *Poezi të përzgjedhura* (2006), *Vitet mbi ujërat* (2003), *Lojë treni* (2001), *Sinerian* (2000) dhe *Masa dhe sasia* (1998), libri

për të cilin fitoi Çmimin e Radiotelevizionit Kombëtar Finlandez „Ari vallëzues“ për librin më të mirë të vitit me poezi. Mori edhe një bursë artistike nga Ministria Finlandeze e Kulturës për vitet 2004-2006. Duke qenë ajo aktive në përkthim dhe redaktim, veprat e saj u përkthyen në shumë gjuhë duke përfshirë anglisht, gjermanisht, frëngjisht, bjellorusisht, serbisht, sllovenisht dhe hebraisht. Është anëtare e Bordit të Qendrës Finlandeze PEN. Mori së fundi një bursë artistike nga Ministria Finlandeze e Kulturës për vitet 2007-2011 dhe ka redaktuar e përkthyer librin „Kali i Odinit: Mitet skandinave“, që sapo ka dalë në finlandisht.

Është mëngjes, skifterët gjuajnë.

Frikësuese janë ato forma të tjera të jetës
që nuk shohin vlerë në njerëzim:

pylli i errët, kafshët grabitqare, mafia, lëvizjet
ekstremiste për qytetarë modestë, armiqtë për të gjithë,
faqinjtë, Satanai i Madh.

Në rrugë nga bari në shtëpi ke frikë nga fantazmat,
shkurret frikacake, kjo nuk është Shakespeare.

Ke frikë nga vendi, atdheu për të cilin njerëzimi yt
nuk ka vlerë. Nga një yll i verdhë apo rozë.

Nga të gjitha yjet e emërtuara, emërtimi
nuk i zbut, ndonëse zbut nëndërgjegjen tënde.

Nga zëri i zonjës mizore të Kashtës së Kumtrit.

Mos besoj se gjithçka është lidhur
me gjithçka tjetër, meqë bie fjala, kam njohur njerëz
që e besonin dhe që mendonin që ishte më mirë
ta vrisnin veten. Unë nuk

kam frikë nga ti as nuk më mungon, por të dua,
vetëm vazhdo të ekzistosh, të jesh ylli i Zotit,
ji në sipërfaqen e ujit, ji në qiell për hir të Perëndisë,
kur shikoj lart atje, fatmirësisht nuk i njoh
yjet, i emërtoj prapë të gjithë

pas teje dhe fëmijës të cilin të lejohet ta takosh një herë në muaj dhe nënës sate që vdes dhe shokëve të tu të vetmuar dhe të kaluarës sate të thyer. Ledhatoj kokën tënde si një kanë të plasarit, a thua akoma nuk ka alternativë. Gjithsesi falënderit që mendon që jam njeri i mirë

ZOTËRIU I SIPANIT

Në të djathtën e Zotëriut të Sipanit adjutanti i tij është i varrosur, si vëlla krah për krah me të, dhe në të majtën e tij një adjutant tjetër me fytyrën në drejtim të kundërt, këmbët e tij në një nivel me veshët e Zotëriut të Sipanit, sikur gishtat e këmbëve dëgjonin njëri-tjetrin në atë varr të heshtur. Në këmbën e shtratit të Zotëriut të Sipanit është një vajzë 17 vjeçare me një model të shkëlqyer flokësh, në krye dy më shumë, njëri mbi tjetrin, këmba e majtë e njërit që ndodhet më sipër është prerë. Në një shtresë dheu disa metra më tej është i shtrirë një ushtar, që mallkoi fatin edhe më shumë: të dy këmbët e tij fatkeqësisht duhet të thyheshin në nyjet e këmbës, ai bërtiti, shau, u pi, shfryu, tha disa fjalë të vërteta, por nuk u largua dot me zvarritje kur e vërteta erdhi.

Këtu përreth sot: pika ngjyre në turmën që shiu e bën të kruspulluar azale dhe karafila, një çantë dhe karkaleca të gjallë deti të zënë për flijim, të larguar jashtë arritjes së perëndisë së lumit, në drejtimin tjetër. Krijesat zvarritëse, duhet t'i dëgjosh si bërtasin, jermojnë, mallkojnë qeniet e larta duke pohuar që sistemi kundërmon

Rrëshqasim mbi tabakanë e mesditës,
bëjmë ski, bëjmë slalom mbi zgjerimin e reve.
Mbi krahun e avionit thuhet: Mos shkel
jashtë kësaj zone,
kurrë s'do ta bëja as në ëndërr, ta premtoj,
gjithsesi është ftohtë atje jashtë, -65°C.
Qurra rrjedh, çfarë gëzimi
kur mund të këputësh një mostër antraksi
nga hunda, më merr malli për ty! edhe
në ngricën e thellë nuk mund të
përqëndrohëm në atë që është,
të jem ajo që jam.
Ne jemi

pa dyshim në një lartësi
prej së paku 11.880 metrash.
Kjo re është e madhe
për moshën e saj, flokët në kurorën e saj
prekin engjëjt e parajsës. Pra
natën është qielli me yje,
duhet të jesh mirënjohës për të,
po qe se, përveç gjithçkaje tjetër, njeriu s'do të ishte
mirënjohës, ç'do të ndodhte atëherë?
Europa gjendet nën një jorgan me pupla
e lodhur nga ato gjëra që vijjnë
nga qielli, nga kaltërsia, llozet
brinjët e reve që përplasen poshtë
në komedinë hyjnore.

Ji e qetë, ji e qetë, enciklopedi.
Konceptet djegin veshët e tu
sepse nuk di ç'është prapa tyre,
mirënjohje, liri, dashuri. Pafajësia
është një shtëpi e bardhë dhe një shishe e zbrazët,
a je më i urtë tani. Nga lart pejsazhi fshatar
është një pallto e grisur kamoshi
një renë e balsamuar e ngrënë nga mola, ç'tjetër
mungon nga ky imazh. Hijet e
gjurmëve të aeroplanëve reaktive që bëjnë tik-tak
mbi të.

Fytyra e tokës ishte gjithmonë e fshehur nga bimët
dhe e praruar me guaska të dyfishta. A është për t'u

habitur
që disa prej tyre janë ruajtur, të përjetësuar
në gur apo rrëshirë, mermer, butësi.
Por a është e mundur
që vetëm një porcion spagetash bolonjezë
do të ruhet në çfarëdo rrethanash?
Maleve u rritet lëkurë ari,
pastaj kthehen në shkrumb,
plazhet romantike fosilizohen,
mesazhet zhduken nga autopërgjegjësi,
por më e rastësishmja nga gjërat më të dhimbsura
ruan formën e vet, mbetet, lëviz mendje,
vihet në ekran, merr vlerën e saj rastësisht,
një bërthamë kuptimi.

Graniti dridhet.
Një njeri dëshiron të dijë
vendndodhjen e tij të saktë,
përafërsisht
themelin, dhe për sa kohë
mund të mbahet një gisht në flakën e qiririt
para se të digjet -
dhe në qoftë se ka gur poshtë
a ka gur edhe sipër? dhe cili
meteor do të më binte
në kokë, po të jetoja mjaft gjatë? dhe
a kam jetuar tashmë përtej çastit kur
duhet të kisha vdekur?
dhe a do të shtyj kokën time
nëpër granitin gri
edhe në varrezë.

Por këtu ka një sipërfaqe
që nuk do të çahet: horizonti.
Mund të zgjedhësh lirisht
një pikë arbitrare
diku në glob,
dhe do të vësh re që të gjitha
shikimet më në fund kthehen këtu.
Mirëpo, para kësaj kryejnë
një valle figurative jashtëzakonisht komplekse
në dimensionin e katërt
të sistemit të koordinateve.

Nga dritarja vezake
shoh se si ia arrijmë qëllimin tonë.

Unë nuk jam e prekur fare.
Në dritën e diellit të parë nga lart,
qytetet janë pasqyra të thyera
në të cilat kujtimet e tua
shtrembërohen në pasqyrim.
Ti e bën dorën grusht
e ledhaton zbrazëtinë.
Të vdekurit do të bënin mirë
të qanin për të gjallët
dhe jo anasjelltas

*(përkthim në anglisht nga David McDuff, nga anglishtja
në shqip nga Silke Liria Blumbach)*





Kujtim M. SHALA (KOSOVE)

Kujtim M. Shala u lind më 28 shkurt 1974, në Loxhë të Pejës (Kosovë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pejë. Studimet themelore i ka kryer në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, më 1996. Ka ndjekur studimet postdiplome, kurset e teorive letrare, të

formave letrare e të estetikës. Më 2001 ka mbrojtur temën e magjistraturës, në fushën e teorive letrare. Ka doktoruar më 2002, po në fushën e teorive letrare. Pas kësaj, ka ndjekur studimet postdoktorale në Universitetin e Bolonjës (Itali) - Fakulteti i Letërsisë dhe i Filozofisë; ka ndjekur kurset e filozofisë së letërsisë e të teorive letrare (teoritë poststrukturaliste). Shala është profesor i Estetikës dhe i Formave letrare në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ai është një ndër studiuesit më produktivë të brezit të tij në fushën e kërkimeve letrare. Deri më tash ka botuar disa libra studimorë e monografikë. Fushë e parë e kërkimeve të tij është letërsia shqipe, e lexuar nga pozicioni i teorive letrare moderne. Kërkimet e tij së bashku japin një pamje të letërsisë shqipe, me parabazë retorikën-semiotikën. Kujtim M. Shala është edhe autor i katër librave poetikë. Është përfshirë në disa antologji në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera. Në vitin 2002 ka fituar çmimin "Pena e artë" për poezinë më të mirë. Ndërsa, në vitin 2006 ka marrë çmimin kombëtar "Azem Shkreli", për librin më të mirë të botuar brenda vitit në të gjitha zhanret (Shekulli i letërsisë shqipe). Ka botuar librat poetikë: Mërzi e zezë (1998), Bukuria e zemërimit (1999), Vjeshta e shpirtit (2000), Sagë (2004). Po ashtu, ka botuar këta libra diskursivë: Shenjat e tekstit (1999), Lasgushi i përjetshëm (1999), Poezia e Bilal Xhaferrit (2001), Shinimet e Fishtës (2002), Vox-i i Anton Pashkut (2002), Kujtesa e tekstit (2003), Fishta përballë Fishtës (2004), Vepra e vetmisë (2005), Miniatura (2005), Pro/Classica (2005), Kuteli i pa/zbuluar (2006), Shekulli i letërsisë shqipe (2006), Expo (2007), Elipsa (2007), Rugova meditans - Kritika letrare e Ibrahim Rugovës (2008), si dhe Letërsia e vjetër dhe e Mesjetës (2002, me Kujtim Rrahmanin).

SAGË

(GJYSHI)

Ai mbylli të gjitha rrëfimet

Sh'pia që ndërtoi s'është më

Pema e dashtun lëshon hije
në tjetër vendStinët janë ngatërruar
në oborrin e Gjyshit
Unë hyj nga një derë tjetërGjyshi
me Babën nuk takohet
Baba derën tjetër s'e diGjyshja ka zgjedhur kujtimet
harron se Gjyshi është aty

Nana ndryshe më flet për shenjat e vjetra

Atëherë kujtohem ta marr sopatën
e të dal në mal
por Gjyshi s'është aty
Unë kam harruar paktin me malinNana ndryshe më flet për shenjat e vjetra
Ulem në mes të oborrit

Gjyshi ka mbyllur derën tjetër

(GJYSHJA)

Gjyshja ruan frymën
shiun e vjetruar keq
e ndien aromën e barit të kositur kaherë
kujton degët e pemëve
në kopsht
pemët s'janë mëAjo
s'don me folë
për degët e huja

(BABA)

Baba e fsheh dashuninë

Nana rri në prag të derës
buzë pleqërisë

Së bashku
nën hijen e kumbullës

Vendlindja është tjetër
për të gjithë
as si në kujtimet e Babës
as si në ëndrrën e Nanës
as si në rrëfimet e Gjyshes

Unë pres të më thotë Baba sa më do
ai e fsheh dashuninë

Baba rri në kujtimet e veta
në vendlindjen e bërë fir

Vendlindja është tjetër dhe ndryshe
s'e di pse s'je ndryshe ti Babë i dashtun

Dashunia e tij s'ka fund
as kujtimet
Unë jam në dashuni e në kujtime
mjaft që ta prek degën e tharë

(NANA)

Nana di të presë gjatë
një fill ëndrre
përplot bar

Ajo s'e do vjeshtën time
as dimnin e Babës

Me Gjyshen bisedon gjatë
mirë e kupton mjegullën e ligjërimin të saj
e Gjyshja e njëjtë edhe n'sh'pinë e re

E dashtun Nanë
si s'flet kurrë për degën e tharë
kur vjeshta është e përjetshme
e dimni shpëtim

(UNË)

Nën degën e tharë jam ma i dashtun
 për Babën
 Nana këlthet sa më sheh
 Gjyshes s'i bëjnë sytë dritë aq larg
 Unë jam i lumtun aty

Kumbulla e Gjyshit ruan hijen me mall
 pemët e reja rrinë kokulura
 i lumtun jam aty

Gjyshja të gjitha rrëfimet i ka me kumbullën e sh'pisë

Sa për mua
 Ajo nuk flet
 se dashuninë s'do ta mbysë në kujtime

Kujtimin tim për Gjyshin
 e mbush dita e tij e fundit

Gjyshja s'do t'i flasë për atë ditë

Baba hesht
 bëhet fëmijë

Nana qan
 sa herë flas Unë

Dega e tharë pushton
 brengë

(TI)

Ti je kthyer në vendlindje
 e më pret e mbytur në vjeshtë

Tash e di sa janë zvogëluar dritaret
 e shtëpisë
 sa është plakur Gjyshja

Pemët s'i njeh mirë
 as rrëfimet për Gjyshin
 oborri luan me shpirtra të tjerë

Ti s'më sheh nën degën e tharë

(NE)

Dy frymë në Një

Në dy duar të vogla vendlindja shtrihet

Unë kollitem kujdesshëm muzgjeve
Provoi dashuninë e babës

Gjyshja numëron brezat me nge
Unë e Ti numërojmë gishtrinjtë
për ta shumëzuar frymën

Qielli ftoh ditët
Ti frikësohesh
pa u kujtuar
se frymën e ke tjetërkund

Buza më shkon në gaz





Haxhi SHABAN

(Mali i Zi)

Haxhi Shabani u lind, më 9 qershor 1963 në Anë të Malit-Ulqin. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Ulqin. Fakultetin Filozofik, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e kreu në Prishtinë. Me krijimtari letrare filloi të merret qysh në shkollë të mesme. Botoi dy përmbledhje me poezi: "Të kërkoj" (1987) dhe "Natë

e portokalltë" (1998). Është përfshirë në përzgjedhjen e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi, "Dritaren lëre hapur", botuar nga Art Club, (1998). Është përfshirë po ashtu në vëllimin poetik përzgjedhës në shqip e anglisht "MLN Ditët e Naimit 2000". Në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit", Tetovë, në vitin 2001 shpërblehet me çmimin "Qiriu i Naimit".

Interesimin për punën shkencore e filloi gjatë viteve të fundit të studimeve (1986/87), duke botuar artikuj gjuhësorë në "Bota jonë" e "Zëri i rinisë". Diplomoi në vitin 1987 me temën "E folmja e Anës së Malit në sistemin fonetik e morfologjik". Pas përfundimit të studimeve botoi leksikon e frazelogjinë gjuhësore nga Ana e Malit dhe Ulqini si dhe artikuj gjuhësorë për bilinguizmin në Ulqin dhe Tuz në revistat "Gjuha jonë", "Studime albanologjike", "Rilindja", "Fati", "Shkodra ndër shekuj" etj. Gjithashtu analizoi nga aspekti dialektologjiko-gjuhësor tekstet e shkrimtarëve bejtexhinj nga Ulqini: Ali Riza Ulqinaku dhe Hysejn Bushati. Mori pjesë në takime të ndryshme shkencore si në Prishtinë, Ulqin, Shkodër etj. Që nga themelimi i Degës së Mësisë në gjuhën shqipe në Univeristetin e Malit të Zi është asistent i lëndëve fonetikë dhe morfologji. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Prishtinës në vitin 2006, duke mbrojtur temën e magjistraturës shkencore me titullin "Dyngjuhësia te shqiptarët e Ulqinit" te akademik Rexhep Ismajli. Këtë studim e botoi në shtëpinë botuese "Toena" në Tiranë me titullin "Rrezikimi i gjuhës shqipe" në vitin 2007.

I PADUKSHËM PËR TË PADUKSHMIT

(Poetit Lasgush Poradeci)

Duhet të jesh mërziur,
Tmerrësisht duhet të jesh mërziur
Në qetësinë e liqenit
Në plotëninë dhe zbrastinë e tij.

Nuk kam parë liqe me faqe aq të qeta.

Unë në qytetin tënd të lindjes
Të kërkoj,
Por ata që i pyes,
ty shtëpinë saktësisht nuk ta dinë.
Thonë atje dikund
Duhet të jetë
Duke u rindërtuar është.

Duhet të jesh shastisur
Nga ajo platitje e paqëllimtë
E sipërfaqes së liqenit.

Nuk kam parë liqe pa valë.

Ti, prandaj hije je bërë
I padukshëm për të padukshmit
Kur ishe gjallë.

Kur ike nga të gjallët.
Hyre thellë në liqenin me tre emra.
I Ohrit, i Pogradecit, i Strugës.

Pasi kishe bërë luftën tënde
Me peshqit mishngrënës të tokës,

Atje në botën nënujore.
Sa më thellë zhyteshe
Aq më shumë të kërkonte toka
Uji për vete.

Thellësitë janë të thella,
Nuk gjenden në cektinë.

Prandaj mos u mërzi
që në qytetin tënd shumica
shtëpinë s'ta dinë.

Duhet t'u jesh dukur tepricë
Kur buzë liqenit ke kaluar
pranë atyre plepave të kotë
Që veç trupin e gjatë e kanë.

Ti për të rëndomtit
vetëm skelet je shfaqur,
ooo ju kallje datën atyre.

Kështu ke fituar luftën
Me përbindshat
Thellë, shumë thellë,
je zhytur.
Në liqenin me tre emra.

Prandaj mos e nxej kokën
Që në qytetin tënd
Shtëpinë nuk ta dinë
Thonë atje tej dikund gjendet.
Është duke u rindërtuar.

A thua vërtetë është duke u rindërtuar?

Në Pogradec, maj 2007

JA SESI JE TI

E keni parë ndonjëherë
Apo s'e keni parë
Para një rrebeshi shiu
Në një natë sterrë
Nuk dihet nga ç'reaksion
Vetëtimia kur vetëtin.
Dhe me shpejtësi,
oh shpejtësia e dritës s' është gjë
Rend jo drejt tokës, po në mua
Më dërmon zemrën
Më thërmon eshtërat
Më trupzon trupin
Valë i tëri valohem.

Asnjë gjë të teprët
Asnjë gjë të pakët
Nuk ke.

Ja sesi je.

Ata sy
Që hapen e mbyllen
Që puqen e puqen
Më zgjojnë
Nga ëndërra më e llahtarshme.
Që s'është parë në këtë botë.
Ajo ngjyrë e syve
E gjelbërt dhe e kaltërt bashkë
Në liqenin tënd det
Mbytem.
Ato qepalla
Të cilat pipëtijnë e pipëtijnë
Më krehin e më krehin
Më vënë në gjumë
për të parë ëndërrën më të bukur
që s' është parë në këtë botë.

Asnjë gjë të tepërt
Asnjë gjë të pakët
Nuk ke.

Ja e tillë je.

Mua ma bëre këtë gjëmë.

Më fal se të dua,
Të faleminderimit që më bëre
Të të dashuroj.

Asnjë gjë të tepërt,
Asnjë gjë të pakët
Nuk ke.

31 korrik 2007

BUZËQSHJA E ILIT DHE KULLA E AJFELIT

(Ilit, që s' ka si ajo tjetër)

Nuk kishe sesi të mos kishe dhëmbje koke
Përpara lumit të qetë të Senës
Që ngjallet e del nga shtrati vetëm çdo njëqind
vjetë.
Ti që ke qeshjen më të bukur në këtë botë.

Nuk kishe sesi të mos mërziteshe
Përpara Kullës së lartë të Ajfelit
Në të cilën po të dojë gjithsecili mund te ngjitet.
Ti buzagazi më i bukur në këtë botë.

Nuk kishte sesi të të buzëqeshte buza
Brenda asaj mjegulle të mjegullt të Parisit
Ti qershibuza më e lëngshme në këtë tokë.

Nuk kishe sesi të mos përpëlitje sytë
përpara gjerësisë së asaj kulle
së cilës edhe po të dojë
askush s'mund t'ia rrethojë belin
Ti e hollta në mes
Po t'i vëja duart aty
Kam frikë se jo vetëm do të të rrethoj,
Por gishtat do të më teprojnë.

Heq dorë nga ngjitja në majën e Kullës së Ajfelit
Atë kullë gjithsecili po të dojë mund ta ngjisë.
Si të ngjitem në kullën tënde.
Ti që ke buzëqeshjen më të bukur në këtë botë.
Ti që ke buzëqeshjen më drithëruese në këtë tokë.





Salih Zeki TOMBAK (TURQI)

Salih Zeki Tombak u lind më vitin 1955. Botoi poezitë e tij të para në revistën "Yarın". Vëllimi i tij i parë "Hüzüdüür İlk Kelimesi" (Melankolia është fjala e parë) u shpërblye më 1983 me çmimin "Akademi Kitabevi", njërin prej çmimeve të atëhershme më domëthënëse për poetë të rinj. Më 1984 ishte bashkëredaktori i

revistës "Yeryüzü Konukları" (Mysafirë në Tokë). Me pas botoi vëllimin "Uzak Karlı Bir Ülkeden" (Nga një vend i largët me dëborë), 1988. Për botimin e poezive të tij përdorte pseudonimin "Serhan Özdemir". Më në fund, në vitin 1990, ribotoi të dy librat e tij të parë në një vëllim të vetëm nën emrin e tij. Edicioni i tretë erdhi më 2008. Vazhdoi të botonte poezitë e tij në revista letrare si "Düşler" (Ëndrra) dhe revista politiko-intelektuale si "Fabrika" (Fabrikë). Punoi si kryeredaktor i revistave "İktidar Yolu" ("Rruga për pushtet") dhe "Fabrika". Eshte njëri nga autorët e enciklopedisë "Socializmi dhe luftëra sociale". Tombak është autori i shumë artikujve dhe i dy librave për Islamin politik dhe fashizmin në fillimin e viteve të 90-ta.

Momentalisht është drejtori i Festivalit të Poezisë ŞiİRİSTANBUL në Stamboll.

MËSOVA QË ËSHTË E LEHTË TA THUASH

gjithmonë prej lartësive niset uji
në udhëtim drejt ujërave të mëdhenj
nganjëherë nga thellësia e maleve, nga skaji i
rrafshit nganjëherë

shpejtësia dhe tërbimi janë fëmijët
e shtratit të lumit dhe pjerrësisë
dhe jo të turmave.

a po sheh, pranë detit në rrafshet e mëdha
rrjedha gjarpëruese dhe endëse e një lumi
nuk është dobësia e tij.

pra e di që nganjëherë nuk ka mënyrë për të thënë
se ku mbaron lumi dhe fillon deti.

kripa e detit në lumë, ngjyra e lumit në det.

udhët që fillojnë nga lartësitë
nganjëherë nuk zbresin deri në ultësiat
ndërsa pjerrësia vazhdon të zvogëlohet
dhe është shkëmbor
shtrati, i ngushtë
udhëtimi, i shkurtër
dhe çasti i takimit me ujërat e mëdhenj është një
shkëmb.

të uroja udhëtime të gjata
dhe paqe të madhe dhe durim mjeshtëror
për të jetuar dhe për të ndarë
por edhe thosha, bëhu gati për shkëmbinjtë...

mësova që është e lehtë ta thuash
duke dëgjuar poteren dërrmuese që le
kur vesa më ngritet në fytyrë
mjegulla nga ujvara futet brenda meje

E QETË ISHE, NJË VARG I VETMUAR

e qetë ishe, një varg i vetmuar që përmban zërin e
vet
mund të të përshkruajë me fjalë të përhirta

ardhja ime e vrenjtur me shqetësimin tim
vija duke supozuar një thirrje fjalë dhe gjeste
munguese.

kishte ditë kur ngushëllohesha me thesarë modernë
në kopshte të dëshpëruara dhe të shteruara
me brenga prej plastiku, cefla të ngjyrosura shtëpish
të vjetra
dhe cianik besimesh ngushëlluese.
me një shpresë të kotë kapja autobusin për në
periferitë
emrat e të cilave qyteti ende nuk i dinte.

gjurmët e mia të gishtërinjve ziheshin nga bojë e
zezë
miqësohesha me lumenjtë.

dhe ende në këtë orë të vonshme
kthehem nga brigjet e mia duke besuar në librat
dhe me një fytyrë që harxhova në stina me borë
të dashkam,
po zgjedh një zile për derën time

për t'u përzier me zhurmën e erës mbi guriçkat
dhe me rërën e imtë të hedhur pas vdekjeve të
parakohshme.

tani me një zemër fluturuese
jam zbuluesi i një vendi që tregohet në çdo hartë
vija niveli që mbyllen në vetveten
dhe lumenj të shënuar në të kaltër.

JEMI UDHËTARË NË KOHËT E DRITAVE TË ZBEHURA

ky det,
me zogjtë, barkat dhe rrymat nënujore;
dhe ky qytet të cilin e lashë për t'u kthyer,
me detin e tij
është dashnori im, që mban letrat e mia mërgimi
midis letrave të tjera të trishtuara
të pamundësisë së harrimit

eci drejt kaltërsisë së thellë të netëve
vetëm, por pa ankim, kjo është puna ime.

erdhi tashmë koha e banjos pastruese rëre,
zgërdheshje e gëzuar
tifoze të rinj xhazi
që gjejnë thertoren e kazlicesmes
shumë kinematografike.

erërat janë të favorshme, kohë për të ikur për të
mbledhur dhembje të rastit
bakri kalitet dhe çeliku
përmirësohet me ndarjet.

në fjalorin e grave që dëgjojnë letrat e tyre
të lexuara nga fëmijët e fqinjit
emri im ka kuptim të mirë. u fshi
në listën e turneve në uzinën e
petëzimit
kur braktis klasën time të parë në fakultet
është në listën e të kërkuarve në
lajmet e orës një

jemi udhëtarë në kohët e dritave të zbehura
milje kalojnë nëpër sytë e mi duke lënë një gjurmë
të përgjakur
dhe nëpër gjoksin tim lumi i dashurisë për ty

më jepen përralla të një deti të lashtë
si ngushëllim
i thava në libra të ngrënë nga përdorimi
dhe u kthyen në kohën
kur gjithçka që të premtohet është vetëm
një pjesë e vogël dheu nga një këngë shtatori

ti je jeta ime, prite shtatorin
por mos prit ditë të tepërta
dhe mos rri e heshtur duke dëgjuar veten
imazhi ynë le të shfaqet me një buzëqeshje të
patronditur
në pasqyrën e liqeneve pa ujë



Agron TUFA (SHQIPERI)

Agron Tufta u lind me 1 prill 1967 në Dibër. Ka studiuar në fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës, i ka thelluar studimet në Institutin e Letërsisë "A.M. Gorki" të Moskës (1994 -1999). Studimet pasuniversitare i ka mbaruar në Institutin e Kulturave Europiane IEK (1999 – 2001) me gradën "master" për filozofi arti. Është

professor i Letërsisë së huaj të shekullit XX; Kryetar i Këshillit Drejtues të Radio-televizionit Publik Shqiptar, Kryetar i Institutit të Kontakteve Kulturore.

Ka botuar vëllimet me poezi: "Aty te Portat Skee" ("Onufri" 1996); "Rrethinat e Atlantidës" ("Aleph" 2002); "Avangardë engjëjsh" ("Ideart" 2005); "Fryma mbi ujëra" ("Fjala" 2007). Ka botuar romanet "Dueli" 1998, 2002; "Fabula rasa" 2004; "Mërkuna e zezë" 2005. Eseiistika e tij është përmbledhur në vëllimin "Janusi qindfytyrësh" 2004.

Ka përkthyer poetë e prozatorë rusë si Josif Brodsksy, Anna Achmatova, Osip Mandelstam, Danil Harms, por edhe studiues e teoricienë si Yuri Lotman, Vladimir Propp, Mihail Bahtin, Boris Ejhenbaum, etc.

Jeton dhe punon në Tiranë, Shqipëri.

ORIGJINA E MENDIMIT

A ka vallë një të drejtë për mendimin? Domethënë,
// a del dikush (njeri a trajtë arsytuese) ta përligjë?
// Kur u shfaq për së pari, çfarë ishte para çastit të dhënë

mendimi i zhveshur, me kuptim për të gjithë...? //
Mendimi-ndjenjë, mendimi-ide, mendimi-ekzistencë
- // ai, që përbën të Vërtetat e Epërme, që dikë
gëzon, tremb,

ai që vëzhgon, survejon, udhëheq, bën shkencë
- // mendimi i lakuar ndër identitete, mendimi që
dhemb? // Si u shfaq? Nga erdh? Me çqëllim? Si
mbahet gjallë? // Si dhe çfarë do të ishin qeniet
pa mendim? Cila vallë // është ajo shigjetë që çan
eterin neutral të Hiçit // me trajektoren e vet për t'u
ngulur në Qëllim?

Cili është harku vetë? Kush e tendosi? Midis
"Diçit" // dhe "Hiçit" - trajektorja e lëshuar! Me
çparamendim? // Çfarë kushtesh lyp mendimi?
Çfarë synimi? // si do të mishërohej ai, nëse nuk

do të kishte bartës të gjallë? // Mos është mendimi pjekje e energjisë dhe evolucion mbi kushtet, // përshtatja, ruajtja dhe transformimi i drejtpeshimit mbi to? // Mos është thjesht, përvojë, sintezë përvojash, pushtet? // Mos është varësi? Kompromis për të zgjatur kushtet? Jo! Jo! Jo! // Mendime ka ngado! Mendimi bun në bartës! // Sa janë të një mendjeje? A nuk vdes dhe mendimi tok me ta? // Domethënë, mendimi-shpëtimtar, mendimi-vrasës? // Sa vdesin vallë duke e varrosur edhe mendimin? // ç'bën mendimi në varr? Si ta mishërojë pa mish mishërimin? // A zhduket mendimi? Duket: është më i fortë se biologjia! // Mendimi ia ha xhanin njeriut, e detyron ta nxjerrë // pjesë-pjesë, para se ky të vdesë... Dhe ndjehet si te Shtëpia // e Përjetshme: gojdhana, rrëfenja, në letër - i pa bjerrë... // Mendimi bredh - si kurvë ta dredh: aty është, aty zhduket // dhe ti, vret mendjen që s'e ke: ai kukafshehthi struket // e nganjëherë të lë, siç lë burri gruan e tij, të ndarë; // në fakt shkon të lërë dikë tjetër me barrë, ndërsa ty - të marrë! // Por ndodh shpesh që mendimit t'i hyjë të ftohtët, ankthi, frika - // mendimi shkëpurdhet konvulsesh, nuk e zë kurmi që e ndryn:

këto, rëndom, i quajmë "mendime të liga", // dhe vijmë mendime të tjera ku mendimi mendimin shtyn // gjersa ta asgjësojë fare. Shpesh mendimi për mendimin është ujk. // Mendimi riprodhon vetveten, siç riprodhon një vreshtar a një bujk // varietete të reja me shermente të vjetra. Atëherë merr turr // mendimi i papritur, i panjohur, mendimi-kentaur // që lidh skajet e kundërta dhe mbi rregullat merr hak - // mendimi-tranvestit, mendimi-hermafrodit, mendimi-afrodiziak. // Mandej vjen më i tmerrshmi - mendimi në shmang, mendimi-asket:

kur rrugën i zënë, ai si akrep ngre thumbin dhe vetveten vret. // ...Ja se si ikën mendimi! Herë firas, herë mësyn - tërmet. // Ti e ndjek i bindur. Pse? Sepse mendimi është vullnet? // çfarë është mendimi? Kush e tendosi Harkun? E kujt është Shigjeta? // Pse i duhet mendimit gjuha? Pse nuk i mjafton as ajo // me gjithë simbolet, analogjitë, metaforat, alegoritë? Ku qëndron e Vërteta? // Kush fshihet prapa Harkut? Cila Domosdo? // Dhe nëse s'do të kishte Bartës që mendimin ta bartin // në legjenda, memorie, letër (siç po bëj dhe unë), // cili do të ishte fati i tij, me cakun, progresin, afatin? // Dhe kush do të ishte në gjendje ta shuante? Cila dhunë? // Po unë, një Bartës që falë tij i shkruaj

këto radhë, // që falë tij i hap udhë njëfarë kuptimi
me mendimin-pandehmë, // edhe këto pak pyetje
i bëj falë një rastësie plus-minus njëzetë gradë,
// ndryshe, falë Atij pas Harkut që mund të mos
lëshonte asnjë shigjetë...

STANCË MALORE

Ndoshta s'ka me qenë as herët, as vonë
kur timpanin tonë ta rrahë një kumbonë
me na galdue mes agut, mes pragut,
se një mal u bâ babagysh n'jetën tonë.
Shestime të shkathëta do turren përjashta,
apatitë do shkulen vështrimesh të flashkëta -
Ndër gryka e rrahe do derdhet qindfish
rrëfimi i malit që u bâ babagysh.

Atëherë do vikasim në rrëzë e në majë,
me barrët e brengave do qajmë në pllajë,
do ngjitemi me klithmën si zhiva në parzëm
drejt Majës që duket e zhduket – fantazëm -
do hymë djersitun prej ankthit, prej mundit
ndër angrrat ku mali fsheh p'rrallën e fundit.

Të mençur do jemi nën dritën e saj...

Përqafe me malin-babagysh, pastaj
botën përposh ta kqyrim një grimë -
ç'prej majës që shtjelllet kulm e greminë.

Vallë ka me qenë vështrimi ynë ma i qetë,
solidar, i përunjur si luzma me bletë?
A mos hobé gurësh do derdhet rrëmbim
orteqesh idhnakë, shpatinë më shpatinë,
dhe ura të thyejë, dhe gropa të hapë
se s'don babagyshin me e braktisun prapë?

Eh, gjer atëherë kur kumbona bije,
koha do shtrojë mullarë me hije;
tingujt do shuhën dhe dylli viskoz
ka me na topitë dëgjimin, nëmos
ka me na kallë në një had monologu
ku trupat dhe shpirtnat dhe zanet, së toku,
mes përpëlitjesh, delirit tonë,
praptaz, gaforre, do sillen gjithmonë

dhe kush s'ka me ndie asnji kumbonë...

BUKË TË RRUMBULLTA KUJTESE

Piquni, piquni ju bukë të rrumbullta kujtese!
 Rekrut i mobilizuar përgjatë kësaj linje muzikore,
 si kallëza të pjekura mbledh brenga të bëra finjë.
 Çapëlehen e përgollen gojët e sendeve n'për
 dhomë e, një personalitet grykës shpërpushtet ndër
 to. Më bëhet se e njoh këso libidoje: më bëhet se e
 shoh.

Piquni, piquni ju bukë të rrumbullta kujtese!
 Si një kokërr drithi bjer, bjer në mulli, o ti, kafshë,
 barishte, mrekulli – shtatzanë, shpirtkë, o ti shtaza
 ime shtatpakët. Le të bjerë, le të shkrijë si fjollë bore
 e vërteta për ty! Ç'gatesë e trishtë do të dalë, turtull
 o mëllenjë? Ç'mit? Ç'rrëfenjë? Dhe në vend që të
 kruhem, shkruaj, - o kafsha ime stërnaze – bluaj.
 Piquni, piquni ju bukë të rrumbullta kujtese!

FANTAZMAT

Ditë për ditë pa gjak në plazmë
 Mbruhet nga një fantazmë –
 E pak nga pak ti nis t'vrposh,
 Mbas saj të hiqesh osh.

Fantazma di të prijë mirë,
 Dhe ti, e ndjek me ëndje:
 Të merr të gjallë që pa gdhirë -
 Të kthen kufomë në mbrëmje.

Ti zbret në gjumë si vozë me musht –
 Qilarit - merimanga.
 Përbrenda teje ziejnë flamuj.
 Asnjë i bardhë: fantazma!

FORMULË ADEPTËSH

Ngadalë e mundimshëm si toka kur çlirët/ rroposur
 nga rrënjët e një rrapi të moçëm/ prej rrënjësh/ që
 si ventuza të verbra oktapodi stërmadh/ mbërthyer
 kanë një kafkë viktime/ prajshëm si toka që rënkon
 dhera e gurë/ si toka nën rrënjë rrapesh e rrahesh
 dhe si kafka/ - si kafka e viktimsë kapë ventuzash të

verbra të një oktapodi stërmadh/ - o tokë, o kafkë,
o torfë e angësht e trurit - ti çliresh.../ shkulet teje
e shkuara, sprapset: tash ejani t'i shihni/ – golle,
zgavra, vrima të zeza, tunele e labirinthe ku të
pashpresë e fillhumbur/ bredhin n'jermi turrma
tezéjsh harrakatë.../ përposh uturin nëntoka; veç
hadi i zyrtë në hyrje mirëpret/ dhe gëlltit saora
lakuriqët e vet/ pasi ua çarmatos hijen: nëntoka
sa s'vithiset nga tektonika e refrenit/ "Fatprêmja
Ariadnë, fillsosuna Ariadnë...!"/ Si toka kur çliret
(prej rrënjësh kur çliret/ dhemb si dhëmballë), ke
mbetur ti tash zgafellë, tunel/ (me tezë e tantalë)/
ashtu kujtesa e shkuar nuk shkulet e dhemb/ dhe
zien një had zërash herë këngë e herë nëmë:/

Atë nëmë që ma dhe – merrel!
Atë këngë që ke nxënë – shterrel!
Atë gjëmë që ta lashë – ktheje!
Atë dash flijimlashtë – there!
Vetëm salikimi mes meje e teje!

Po toka po ftohet, se ka dhe mëngjes/ kur mitologjia
vdes:/ zvetënohet gjithçka përthellë në terrina/
(labirinthe shemben dhe korja zë dregzë me rrjeta
gjembaçe murrizesh)/, me mijëra milionë tonelata
dritë derdh dielli mbi tezë e tantalë/ shndërruar në
minj e urithë gjirizesh/...





Neşe YAŞIN (QIPRO)

Neşe Yaşın (1959) është poete dhe shkrimtare e lexuar në të dyja anët e Qipros së ndarë. Ka botuar gjashtë libra me poezi: "Hiacinti dhe Narcisi" (1979), "Lotë lufte" (1980), "Dyer" (1992), "Hëna përbëhet nga dashuria" (2000), "Dhoma kujtimi" (2005), Poezi të zgjedhura (2008) dhe një roman, "Historia sekrete e vajzave të trishtuara" (2002). Poezia e saj është përkthyer gjerësisht dhe ajo ka marrë pjesë në festivale poezie dhe recitime nëpër gjithë botën. Mes tjerash ka marrë Çmimin "Anthias Pierides" në vitin 1998.

DYER

Dikur kishte trokitje në dyer
dhe zakonisht gra i hapnin
jeta zakonisht kalonte
e lustruar dhe me pluhurin e fshirë çdo ditë

Ata që
i merrte malli për dashuri të madhe
për të shikuar bukurinë e vetë
nëpër shekujt
të ngriheshin si pikturë ishte dëshira e tyre

Nga vajza të vogla
rriteshin si fidane të dëgjuar
dhe mbanin unaza xixëlluese martese në gishtërinjtë
hynin në burgje
si pëllumba të bardhë

Dikush jepte pas rrugëve
as nuk bëheshin nëna
disa bëheshin yje që binin dhe zhdukeshin
disa vareshin në një shkurrë trëndafili
duke pritur jetën pa pyetje fare

Dritarja shkëlqente
larja hekurosej
por kurrë një trokitje në derë
burri që do të dashuronte çmendurisht
nuk erdhi kurrë

Bota ishte një karrocë kuajsh
dhe gratë e tërhiqnin me shpejtësi të lartë
si mundet që nuk kuptonin
që një grua ishte më e fortë
dhe fjala liri
ishte si festa e vitit të ri në qiell
kurrë s'do të gjenin fustanin e mirë
kurrë s'mund të dilnin

Vetëm ishin të befasuar
me rrobat ushtarake të burrave
dhe për orët e mesnatës
thurnin pulovra
për t'u veshur fshehtas nën uniforma

Jeta e thurur nga dhembja me gjilpëra të holla
e plagosur nga vrima plumbi
falat e tyre të shkelura pa mëshirë
çdo herë që burri masakronte burrin
humbnin më të dashurit bashkëshortët dhe bijtë
Lotë dhe vetmi të djegura në qiri
djegës temjani lëshonin tym
në dhoma të ftohta vejushash

Fotografitë e tyre ishin mbi muret
bijtë, bashkëshortët e tyre me pushka në dorë
vetullat e trashë, pamjet e forta, mustaqet e trasha
sundonin shtëpitë e tyre

Ndërhynin në çdo gjë nga ishin
nga trokitësi i derës deri në gjellë në tigan
thirrjet e tyre ende kumbonin kudo
kurse fëmijë si kotele fshiheshin prapa fundit të
nënave të tyre

Luteshin dhe luteshin
dhe mbanin degë mërsine
në varret në çdo ditë feste
malli jetohej me dhembje të padukshme
që zbriste në heshtje
nga zemra në ijë

Dikur kishte trokitje në dyer
dhe gra i hapnin
jeta zakonisht kalonte
e lustruar dhe me pluhurin e fshirë çdo ditë.

(1986)

DRITA QË NGRIHET BRENDA MEJE

Kush e di, ndoshta
ndërsa ti qëlloje nga barrikatadat
që vranë shtëpinë tonë
unë zbutësja në trishtim fëmijëror
kur vdekje kalonin nëpër ofshamat e mia të thella

Atëherë e dija
ndonjë ditë do të vidhje shpirtin tim

Kurse u arratisa në hapësirat midis shkallëve
duke qarë për vrasje në familje
pëshpëriti ëndrra për të ardhmen
dritën që ngrihet brenda meje

Tre engjëj u shfaqën
njëri solli një lulekuqe
tjetri një puthje të butë prej teje
i treti i kishte duart boshe
më shikoi në fytyrë i sikletosur

Dhe pastaj fantazmat e dëshmorëve
më gjuajtën në rrobat e tyre të qullura me gjak
mësuesi im i historisë
lexon gënjeshtër me zë të lartë në portat e Qiellit

të kam pritur për një kohë aq të gjatë
në kullat e shkreta babilonike

Hiqi rrobat e tua ushtari
dhe afrohu më shumë
jepmë tri foshnje nga shpirtrat e të vdekurve
Njëren që të harroj gjithë dhembjen
tjetrën për ta ngushëlluar tokën
të tretën për t'u endur natën nëpër qytetin
dhe për të mbajtur dorën e nënave që qajnë

Dy ekstrakte nga poezia "LETRA TË PADËRGUARA"

More zërin tënd dhe ike
dhe unë u mbeta me sy të ngulitur në vendin tënd
bosh
gjurmët e tua nuk u zhdukën
në rrugët e dashurisë

Vetminë verbuese e le prapa
edhe pse pohon “nuk je e vetme”

duhet ende të rritem jam foshnje dashurie
ëndrrat e mia ato të një adoleshenteje
do të vijë këmbëzbathur kur të gjithë flenë gjumë

Në të njëjtin qytet
mure të prera nëpër udhën time
prit në anën tjetër të vraposh dhe përqafosh
sepse dashuria është zog

Po ti?

Si mund të dashurojë një burrë
duke tejkaluar të gjitha detyrimet
a do të binte kokë e këmbë në dashuri

Nuk ka hyrje
edhe pse e fillon udhëtimin
(E pamundur pa urdhra nga komandanti)

Doja të thosha mos duaj një poete
zjarri yt më ka vënë në heshtje
dashuria është tradhtar kombëtar

Po të mund të të kapja
a je atje?
Mbi një ishull në Mesdhe

Dashuria do të shfaqej po ta ndaje dashurinë
Nuk e dua as të pavarur federal

Në dy qeliza të ndara

të duash në heshtje
(Kjo është tradhëti
e brezit rebel)

X

Pa leje kalimi
në të vërtetë janë gjurmët e shpresës që zhduken
ditë të kaluara në mall janë kthyer në pikëllim
Mos më prit
në qelizën tjetër të brengës

Pa hyrje për dashuri
(Ushtria jonë është siguria jonë më e madhe)

Sonte i shikoja yjet
duke shpresuar që edhe ti i shikon

Mesazhi yt për një takim më ka ardhur
në një vend tjetër
në një kohë tjetër

Por nuk pres dot
gjarpri i verdhë i quajtur kohë
përdridhet tutje brenda meje

Kam rënë në mall të pavonueshëm
Duhet të të shoh sot

Do t'u tregoj të gjithëve që të dashuroj
edhe policit në pikën e kontrollit
Do t'u tregoj të gjithëve emrin tënd të ndaluar

Pastaj do të kaloj
e veshur si mace

Pritmë
përqafo më
do të të them "mjau" në turqisht

*Përkthyer në anglisht nga Aydın Mehmet Ali, nga
anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach*





Jean-Luc WAUTHIER (BELGJIKË)

Jean-Luc Wauthier u lind në vitin 1950 në Charleroi. Ligjëron letërsi në Ecole normale (Shkolla e lartë pedagogjike) Nivelles (Haute Ecole PH Spaak). Prej vitit 2001 është kryetar i Qendrës belge të Shoqatës Ndërkombëtare të Kritikës letrare, dhe prej 2004 është zëvendëskryetar i Qendrës ndërkombëtare.

Ka botuar 17 përmbledhje me poezi, lajme, ese – dhe një roman, “Le Royaume” (Mbretëria), në Editions de l’Age d’Homme, ku më 1999 u botua “La soif et l’oubli” (Etja dhe harresa). Më 1998 mori Çmimin ndërkombëtar “Lucian Blaga” nga Qendra kulturore rumune për gjithë veprën e tij poetike, si dhe më 1987 Çmimin “Polak” (nga Akademia), më 1993 Çmimin ndërkombëtar “René Lyret” dhe më 2001 Çmimin ndërkombëtar “Gachez-Philippot”.

Në dhjetor 2003, shtëpia botuese “Editions de l’Arbre à paroles” (Amay, Belgjikë) ka ribotuar gjithë veprën e tij poetike të botuar midis 1976 dhe 1993 nën titullin “Fruits de l’ombre” (Frytet e hijes).

Si kryeredaktor i revistës “Journal des Poètes” (Gazeta e poetëve) prej vitit 1991 ilustron dhe mbron poezinë e gjithë botës. Është edhe administrator i Bienales Ndërkombëtare të Poezisë.

SUITA RUMUNE

Horia Badescut

I

Ai që qëndron pranë dyerve të natës
dhe që i lë ditës mundësinë për t’u çuar
nuk kupton gjithmonë
kuptimin e një vetmie të ushqyer
nën rrethin e zjarrit
Larg, gjithmonë në mungesë, vdekja
dhe fjalët e saj të papërfunduara
Më afër, në një udhë të harruar,

zogu i cili nuk dëgjohet
i ofron qiellit lotët e heshtjes

II

Pallto të mëdha heshtjeje

thahen në erë

Kalimtarë të mbështetur mbi yjet
vonohen në zemrën e hijeve të tyre

Ujqërit

humben shijen e gjakut

Kjo qetësi, momentalisht,
qetësi frikësuese
e shembur mbi rërën
e ngatërruar me natën
Kjo qetësi,
pas stuhive të zemrës
tragjike si vdekja
dhe që të mbikëqyr,
bën që pengohesh
nuk të lë vetëm
kur ngriten përgjithmonë
mjegullat e vjetra të agimit.

III

Përgjithmonë

maskat -

Një lumë i gjatë zhvat hapësirën

ku këndojnë zogjtë e natës

Ja fushat ku kanë rënë

të vdekurit,

të shtrirë përgjithmonë në hije

të një qiellit që ua ka kthyer shpinën.



**Violeta TANÇEVA -
ZLATEVA**
(MAQEDONI)

E lindur më 25.04.1968 në f. Borievë, Strumicë. Diplomoi në Fakultetin Filologjik, grupi Letërsia jugosllave, në Shkup. Punon në Shtëpinë Botuese "Gjurgja", redaktore dhe redaktore përgjegjëse në Shkup. Që nga viti 2000 është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë.

Shkruan poezi dhe prozë. Boton në shtypin periodik: (Razgledi, Sovremenost, Rast, Stremezh, LK, Akt, Stozher, Portal). Katër herë ka marrë pjesë në Konkursin anonim për tregim të shkurtër në "Ditët e kulturës të Andriqit" (1986, 1987, 1988 dhe 1989), në Travnik, ku ka fituar dy shpërblime të dyta dhe dy të treta.

Ka botuar këto libra:

- Libri për ëndrrën, Shpërblimin e parë për prozë në konkursin anonim të Botimeve të pavarura "Gjurgja", 1991.*
- Kthimi, tregime, "Makedonska kniga", 1993.*
- Pikasoja im, poezi, me përkthim krahasues në anglisht, SH.B. "Gjurgja", 2007, Shkup.*
- Letrat e larme, tregime për fëmijë, Sh.B. "Gjurgja", 2008, Shkup.*

TË NJËTË NË DALLIM

Bineqët
vetëm një vijë i ndanë –
e hollë
vetëm pak më e theksuar
se autenticiteti i tyre.
Të njëjtë dhe aq të ndryshëm!
Dhe të dy sikur shkelin
syrin e djathtë
mbi të cilin në mënyrë cinike - pyetëse
kanë ngritur vetullën.
Hunda pak më e gjatë
e(dhe) kaçurrela pak më e shkurtër
nuk do të thotë gjë –
ata janë bineq.

FJALA E MBYLLUR

Njeri – djall me dy palë brirë
(njëra në rregull, mes balli
tjetra rezervë apo zbukuruese
anësh e levarur si kollare)
nën një çudi mbërthysash
nën peshën e të cilave janë përkulur këmbët e
dobëta
dhe me karrotë të shtrembëraur në kokë –
mu si i humburi
i këngëve të pashkruara të Rembos.
Duke ditur se mund të (na) rrëfejë
shumë për të
Poeti ia ka mbyllur gojën
me diçka për të cilën nuk ka çelës
në të sotmen –
për ca ardhmëri të shumzhuilluara
apo civilizime të paprekshme
mund vetëm të shpresojë
nga e mavijosura e syve të zgjatur.
Prandaj enigmë do të ngel
hieroglifi i mbështjellur
ku si jargë i rrjedh
nga qoshi i gojës.

SKUTINË

I shtrënguar në skutinë
që nga lindja
hapëron nëpër vite
duke u habitur si t'u ikësh
paragjykimeve.
Edhe pse nuk i shohish
me syrin tënd të kufizuar
ato janë beter skutinës.
T'i kanë lidhur duart
mos mund të lëvritësh
këmbët t'i kanë kap
mos lëvizësh më shumë
seç duhet.
Hall është se ato vetë caktojnë
çka prej cilës nevojitet.
Tani të ngel ta rrahësh kokën
që t'i çlirosh mendimet
dhe zemrën e skllavëruar.
Dhe duke xhuhatur kështu në jetë

duke i humbur betejat si dhe flokët
duke u shkukur sit tel i endur nga e kaluara
kur do të shikosh – ç'të shohish:
të kanë ikur vitet
ndërsa skutina të ka ngelur në shpirt.

*Përktheu nga origjinali:
Adem Abdullahu*

Përmbajtja

Abdellatif LAÂBI	11
FRUTET E TRUPIT	
LE TË HAPIM SYRIN E ZEMRËSI	
LIBRI I RI	
FATKEQËSITË E NJË ËNDËRRUESI TË NGARKUAR	
VAKSINË	
KATËR VJET	
FJALIM MBI KODRËN ARABE (1985)	
TEPËR I NDJESHMI (1986)	
GJUHA E NËNËS SIME	
DY ORË ME TREN	
SHKURTIM PËRJETËSIE	
Trine ANDERSEN	25
CHINATOËN 2	
BENAJARAFE	
VENDLINDJA	
Ayman AGBARIA	29
VETËM	
VETMI	
HERA-HERË	
ZOTI DHE ZEMRA IME	
Mario BELLIZZI	33
TRE TRËNDAFILA	
KËTU HISTORIA ËSHTË TRANS	
HIJE	
BUKA ËSHTË DJERSË	
DHIMITRI I RERES DHE KALI I SKËNDERBEUT	
VOREJA	
Xhavit BEQIRI	37
TRISHTIM	
ËNDRRA PËR IKJE	
E VETMJA UDHË	
Silke Liria BLUMBACH	41
NJËRA NGA BRESHKAT E NEMUNA	
BULQIZA II	
SHPELLAT DHE BOSHTET	
Ango BOJANOV	45
MANDOLINA	
MANDOLINA	
QETËSIM	
POETËT E LASHTË	
SHKALLA	
AKT	
Adisa BASHIC - CECO	49
DREKË FAMILJARE	
POETE NË TROLEJBUS	
SPASTRIM ETNIK	
DITË E ZAKONSHME LUFTE	
Khaled Ahmad DARWISH	51
DHJETË POEZI	
Shqip EMERLLAHU	55
BREZI IM	
NJË DITË	
MOLLËT E TETOVËS	
ÇELJA E KUJTIMIT	
MAJAT E BARDHA	
LULEPLUMBASH ÇELTE QIELLI	

Biba ISMAIL	59
NORDIA	
LETËR TË DASHURIT TIM, DIELLIT	
MISTERI I BUZËVE MBI STAMBOLL	
TRAMONTANA	
OSTEND	
Viktoria IVANOVA	67

MODUS VIVENDI	
ZEMËR	
Ledia DUSHI	71
Indrek HIRV	75
Sabit GECAJ	79
SHKUPI	
PEMA IME	
TREGIM FANTASTIK	
Kristian GUTTESEN	83
KRIMI NUMËR NËNTË	
ESSE EST PERCIPI	
NJËBRIRËSHI	
Margus LATTIK MATHURA	87
NOSTALGJI	
GJIRI I BARDHË I DETIT	
Mohd MIGDADY	91
Vehbi MIFTARI	93
SPROVA E PARË E ARTISTIT	
NË TEATËR	
SHKALLËT E SHTËPISË FSHEHIN DIÇKA NGA UNË	
LIGJËRATË PARA FËMIJËVE GJAKOVARË	
Esteban MOORE	99
ENGJËJ TË RËNË	
MINIMA NATURAE 1-5	
Giuseppe NAPOLITANO	107
SA LEHTË RRJEDHIN FJALËT!	
PËRGJIGJA, BIJA IME	
QË E NESËRMJA TË MOS E DIJË	
PËR TË NESËRMEN	
Iskra PENEVA	111
DJALOSHI DHE DIELLI	
GRUAJA VDEKJE	
ZHJËNDRRA	
DY HIJE	
Viktor RADONJIQ	115
THJESHTËSI BRUTALE	
PAK GISHTËRINJ	
DREJTSHKRIMI PËR TITUJT	
Diti RONEN	119
ÇEREKU I TRETË: NGRËNIA E HËNËS	
ORA POLICORE, VARIACIONI NR. 5	
RËNIA, VARIACIONI NR. 6	
Françoise ROY	123
ARMËPUSHIM	
KRIJIM PEJSAZHI	
NIÇE DHE PLATONI DUKE U SHËTITUR	
NËPËR PARKUN KOMBËTAR MAURICIE	
Remzi SALIHU	129
ME NJË SHKËNDIJË MALLI	
NËNAT E DËSHMORËVE	

BESIMI KOPSHTI I BABAIT NË GRAVURË	
Salajdin SALIHU	133
IKJA NGA MËKATI ËSHTË GËNJESHTËR NDEZ CIGARET REND SI ZHAK PREVERI DHOMA E POETIT AQ SA PREKET E PUSHTOHET TYMI SËRISH SHFAQESH NË KËTË QYTET	
Rami SAARI	137
KOSTANDINI I NISËT RRUGËS LISA MIDIS VERMONTIT DHE LINIT TUALETA NË SHKRETËTIRË	
Indrit SINANAJ	141
ASGJË TJETËR ATDHEU ËSHTË FJALË INTIME LEDDA THOTË	
Anni Sumari	145
ZOTËRIU I SIPANIT	
Kujtim M. SHALA	151
SAGË	
Haxhi SHABAN	157
I PADUKSHËM PËR TË PADUKSHMIT JA SESI JE TI BUZËQSHJA E ILIT DHE KULLA E AJFELIT	
Salih Zeki TOMBAK	163
MËSOVA QË ËSHTË E LEHTË TA THUASH E QETË ISHE, NJË VARG I VETMUAR JEMI UDHËTARË NË KOHËT E DRITAVE TË ZBEHURA	
Agron TUFA	167
ORIGJINA E MENDIMIT STANCË MALORE BUKË TË RRUMBULLTA KUJTESE FANTAZMAT FORMULË ADEPTËSH	
Nese YAŞIN	173
DYER DRITA QË NGRIHET BRENDA MEJE DY EKSTRAKTE NGA POEZIA "LETRA TË PADËRGUARA" X	
Jean-Luc WAUTHIER	179
SUITA RUMUNE	
Violeta TANÇEVA - ZLATEVA	181
TË NËJTË NË DALLIM FJALA E MBYLLUR SKUTINË	

Boton
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
"Ditët e Naimit"

Drejtor
Shaip EMËRLLAHU

www.ditetenaimit.org

Radhitja kompjuterike dhe shtypi
"Tringa Design" - Tetovë

CIP - Katalogizimi në publikim Biblioteka popullore dhe universitare
"Sv. Kliment Ohridski", Shkup

821-1(082.2)

SIMFONIA E QËNDRESËS / [përgatiti: Shaip Emërllahu; përktheu: Silke Liria Blumbach] - Tetovë : Manifestimi letrar ndërkombëtar "Ditët e Naimit", 2008. 170 fq. ilustr. 23 cm.
(Biblioteka "Meridiane poetike")

ISBN 978-9989-2617-6-3
1. Emërllahu, Shaip

COBISS.MK-ID 74257162

